

Prill 2018
Numri: 121
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



“

...ATA, ME TË VËRTETË. U BËNË
MENDJEMËDHENJ
DHE KALUAN ÇDO KUFİ
NË ARROGANCË DHE PADREJTËSI.

KURAN, 25:21

”



revistaetika



progresibotime

TË
RINJ

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*


Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Prill 2018

VITI: XII

NUMRI: 121

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardan Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Maqedonija

Mob: +389 7042 8245

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VIJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Që kur shejtani i mallkuar e ka nisur rrugën si "armiku i njeriut" dhe që kur e ka parë se mund ta përdorë kundër njeriut një potencial që gjendet brenda këtij të fundit, ai vazhdon të jetë i preokupuar me të. Për këtë arsye, përpiket ta pengojë njeriun që dëshiron të shkojë drejt e te Zoti (xh.sh.). Për ta arritur këtë qëllim, mundohet t'i zbrazë sjelljet apo veprat e njeriut nga sineriteti ndaj Zotit (xh.sh.) dhe t'i mbushë me shkatërrimin e tij. Shejtani është preokupuar me njeriun e parë. Ai ia bëri të mundur njeriut të parë kundërshtimin ndaj Zotit. Kështu që ia doli mbanë që ta zbriste atë nga Xheneti. Për këtë arsye, Shejtani dhe mundësia e tij për ta përdorur potencialin e brendshëm të njeriut, vazhdimisht do të jetë tema kryesore e të gjitha kohërave.

Le t'i hedhim një sy Kuranit Fisnik:

Me të vërtetë, "fusha e veprimit" të shejtanit është shumë e gjerë dhe shkatërruese. Për shembull, atij i jepet mundësia për ta mashtruar atë që mundet dhe për ta devijuar në ligësi. (Shik. Isra, 64) Në të njëjtën mënyrë, atij i është dhënë potenciali për t'u bërë ortak në pasuritë dhe fëmijët e njerëzve. (I njëjti ajet)

Njeriu nuk mund ta shikojë shejtanin, por shejtani mund ta shikojë njeriun. Shejtani mund t'i afrohet njeriut nga ana e djathtë, nga ana e majtë, nga përpara dhe nga mbrapa. Në këtë mënyrë, përpiket ta zvarrisë diku njeriun. Këtu bëhet fjalë për një qenie të padukshme dhe për vesveset e pazëshme që ndoshta njeriu pandeh se i vijnë nga bota e tij e brendshme...

Sipas informacionit që na jep Kurani Fisnik, shejtani i mallkuar e ka mundësinë t'i sulmojë njerëzit duke e mbledhur forcën me luftëtarët dhe kalorësit e tij. Domethënë, pasuesit e shejtanit mund të bëhen një fuqi e tmerrshme. Kjo është një fuqi që mund t'i bëjë ushtarë edhe fëmijët dhe pasuritë e njerëzve...

Shejtani ka pasuesit e tij. Shejtani ka thirrësit (median) e tij. Shejtani formon ushtri të posaçme për vete. Shejtani ka vëllezër dhe miq. Ai është një qenie që nxit dhe që provokon. Shejtani u thotë miqve të tij që të luftojnë me ata që nuk devijojnë nga rruga e Allahut. (Shik. Surja En'am, 121.)

Shejtani i mallkuar i zbukuron gjërat e këqija dhe i bën të pranueshme, duke i shfaqur si të bukura. Domethënë, këto vepra të shëmtuara i shfaq në një mënyrë të përshtatshme me shpresat dhe këndvështrimet e njerëzve... Pra, u bën makijazh atyre... Nganjëherë i shtyn njerëzit që të bëjnë vepra të shëmtuara si vrasjen e fëmijëve në mitrën e nënës duke i frikësuar me varfëri. (Shik. Surja Bekare, 268.) Kjo do të thotë se shejtani e kupton psikologjinë e njeriut dhe se ka zhvilluar metoda mashtruese sipas çdo njeriu.

Shejtani nganjëherë futet te njeriu si shok... (Shik. Surja Zuhruf, 36.)

Shejtani nganjëherë i tërheq njerëzit drejt premtimeve boshe, u jep fjalën dhe i bën të shpresojnë të këto premtime. (Shik. Surja Nisa, 119-120.)

Ecuria e shejtanit në mënyrë djallëzore ka filluar me diskutimin dhe kundërshtimin e urdhrit të Allahut Teala. Nisur nga kjo, ndjeshmëria më primare e besimtarit duhet të jetë bindja dhe zbatimi i urdhrave të Allahut Teala me një nënshtrim shpirtëror.

Ne duhet t'i kërkojmë mbrojtje Allahut (xh.sh.), kundrejt çdo lloj hileje të shejtanit...

Atëherë, le të fillojmë:

Eudhu bil-lahi mine'sh-shejtani'rr-rraxhim!.. I kërkoj mbrojtje Allahut prej shejtanit të mallkuar!..

Përmbajtja



Te ngrënë dhe të pirët
sipas rregullave të Islamit
Xhafer Durmush

24



Çështja e kohës, vendit
dhe mundësisë në edukimin e nefsit
Dr. Adem Ergyl

8



Shkolla e Universit
Osman Nuri Topbash

34



22



Poezia si dëshmi për atë që kemi humbur
Edison Çeraj

44

- 5 Edukimi i vetes në këtë kohë
Ahmet Tashgetiren
- 11 Drejt klimës së përsosmërisë
Prof. dr. Irfan Gyndyz
- 14 Marrja e vetes në llogari
Osman Alltash
- 16 Mobilizimi me durim
Ibrahim Bozbeshpamak
- 18 Robërit e Allahut dhe cilësitë e tyre
Ali Riza Temel
- 21 Investimi i vërtetë
Nuredin Jëlldëz
- 22 Koxha Sinan Pasha
Dr. Ardian Muhaj
- 25 Konaku
Urtësi
- 28 Klonimi i fshehtë dhe...
Xhihan Tashtan



56

- Si të bëhesh astronom amator në tre hapa? 29
Muaz Erdem
- Një Ajet 30
- Një Hadith 32

- Er-Rezzak 40
Ilir Hoxha
- Refleksione -2 42
Nuredin Nazarko
- Akil ibn Ebi Talib 46
Mustafa Erish
- Muhamedi shëmbëlltë për njerëzimin 51
Merva Capo
- Dashuria 54
Elif Menxhet
- Cili është prioriteti juaj? 55
Seher Ajdën
- Shija e jetës 56
Nezhla Bash

48



Një këshillë prej zemre
Ferit Piku



Mungesa e vetëbesimit të fëmijët
Betyl Balltaxhe

52



Edukimi i vetes

— Ahmet Tashgetiren —

Që kur shejtani i mallkuar e ka nisur rrugën si “armiku i njeriut” dhe që kur e ka parë se mund ta përdorë kundër njeriut një potencial që gjendet brenda këtij të fundit, ai vazhdon të jetë i preokupuar me të. Për këtë arsye, përpiket ta pengojë njeriun që dëshiron të shkojë drejt e te Zoti (xh.sh.). Për ta arritur këtë qëllim, mundohet t’i zbrazë sjelljet apo veprat e njeriut nga sineriteti ndaj Zotit (xh.sh.) dhe t’i mbushë me shkatërrimin e tij. Shejtani është preokupuar me njeriun e parë. Ai ia bëri të mundur njeriut të parë kundërshtimin ndaj Zotit. Kështu që ia doli mbanë që ta zbriste atë nga Xheneti. Për këtë arsye, Shejtani dhe mundësia e tij për ta përdorur potencialin e brendshëm të njeriut, vazhdimisht do të jetë tema kryesore e të gjitha kohërave.

Le t’i hedhim një sy Kuranit Fisnik:

Me të vërtetë, “fusha e veprimit” të shejtanit është shumë e gjerë dhe shkatërruese. Për shembull, atij i jepet mundësia për ta mashtruar atë që mundet dhe për ta devijuar në ligësi. (Shik. Isra, 64) Në të njëjtën mënyrë, atij i është dhënë potenciali për t’u bërë ortak në pasuritë dhe fëmijët e njerëzve. (I njëjti ajet)

Njeriu nuk mund ta shikojë shejtanin, por shejtani

mund ta shikojë njeriun. Shejtani mund t’i afrohet njeriut nga ana e djathtë, nga ana e majtë, nga përpara dhe nga mbrapa. Në këtë mënyrë, përpiket ta zvarrisë diku njeriun. Këtu bëhet fjalë për një genie të padukshme dhe për vesveset e pazëshme që ndoshta njeriu pandeh se i vijnë nga bota e tij e brendshme...

Sipas informacionit që na jep Kurani Fisnik, shejtani i mallkuar e ka mundësinë t’i sulmojë njerëzit duke e mbledhur forcën me luftëtarët dhe kalorësit e tij. Domethënë, pasuesit e shejtanit mund të bëhen një fuqi e tmerrshme. Kjo është një fuqi që mund t’i bëjë ushtarë edhe fëmijët dhe pasuritë e njerëzve...

Shejtani ka pasuesit e tij. Shejtani ka thirrësit (median) e tij. Shejtani formon ushtri të posaçme për vete. Shejtani ka vëllezër dhe miq. Ai është një genie që nxit dhe që provokon. Shejtani u thotë miqve të tij që të luftojnë me ata që nuk devijojnë nga rruga e Allahut. (Shik. Surja En’am, 121.)

Shejtani i mallkuar i zbukuron gjërat e këqija dhe i bën të pranueshme, duke i shfaqur si të bukura. Domethënë, këto vepra të shëmtuara i shfaq në një mënyrë të përshtatshme me shpresat dhe

këndvështrimet e njerëzve... Pra, u bën makijazh atyre... Nganjëherë i shtyn njerëzit që të bëjnë vepra të shëmtuara si vrasjen e fëmijëve në mitrën e nënës duke i frikësuar me varfëri. (Shik. Surja Bekare, 268.) Kjo do të thotë se shejtani e kupton psikologjinë e njeriut dhe se ka zhvilluar metoda mashtruese sipas çdo njeriu.

Shejtani nganjëherë futet te njeriu si shok... (Shik. Surja Zuhruf, 36.)

Shejtani nganjëherë i tërheq njerëzit drejt premtimeve boshe, u jep fjalën dhe i bën të shpresojnë të këto premtime. (Shik. Surja Nisa, 119-120.)

Shejtani e ka nisur rrugën me pohimin për t'i shtyrë njerëzit në gjëra që nuk i pranon mendja dhe thotë: "Unë do t'i urdhëroj dhe ata do ta ndryshojnë krijimin e Allahut." (Shik. Surja A'raf, 119.)

Më sipër thamë se shejtani i përdor potencialet që ka brenda njeriu për ta zbatuar në jetë të gjithë projektin shkatërrues. Cilat janë këto potenciale? Pasioni seksual, pasioni për pasuri, dëshira për pushtet, dashuria e thellë kundrejt fëmijës, dëshira për të jetuar përgjithmonë... Këto janë edhe fushat jetike të njeriut, edhe potencialet që shejtani të hyjë brenda njeriut. Siç e thamë, këto janë potencialet tona që kanë ardhur në ekzistencë bashkë me njeriun.

Shejtani ia doli mbanë për t'i shtyrë Ademin dhe Havanë në mëkat dhe arriti t'i bënte ta hanin frutin e ndaluar. Jusufi, (a.s.), u gjend në një pozicion të vështirë nga aspekti i pasionit seksual, me të cilin njerëzit do të përballen gjithmonë. Ai u strehua te mirësia hyjnore, duke mundur veten e kaloi me sukses sprovën.

Karuni u bë simboli i tërbimit nga pasioni për pasuri. Faraoni u bë simboli i dëshirës së tepërt për pushtet, e cila mund ta zvarrisë njeriun deri aty ku ai mund të pohojë se është zot.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), na njofton se shejtani qarkullon nëpër damarët e njeriut, si një mikrob i ndonjë lloji sëmundjeje vdekjeprurëse. Këto lloje sëmundjesh potenciale, gjithmonë gjenden te njeriu dhe vetëm kur struktura e tij i humbet mundësitë për t'u mbrojtur, gjë e cila cilësohet si dobësim i sistemit imunitar, dalin në pah dhe e rrëzojnë njeriun përtokë. Kjo është e njëjtë për njerëzit e të gjitha kohërave. Edhe në kohën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), gjendej shejtani i mallkuar dhe potenciali i brendshëm i njeriut që ia jepte atij këtë mundësi. Shejtani ia vuri zinxhirin në hundë Ebu Xhehlit dhe e mori me vete. Ai luajti edhe me zemrat e besimtarëve. Disa i rrëzoi përtokë, por prapë se prapë ata e mblodhën veten duke u penduar përsëri. Disa të tjerë i hodhi në fatkeqësinë e hipokrizisë.

Sahabët e nderuar u edukuan pikërisht nga vetë i Dërguari i Allahut (a.s.). U kapën me dorën e tij, e panë, e dëgjuan dhe zemrat e tyre rrihnin për zemrën e tij. Por prapë se prapë, dikujt i rrëshqiti këmba në luftë, dikush kundërshtoi në ndarjen e plaçkës së luftës, dikush rrëshqiti në sprovën e imo-

ralitetit, këtu le të mendojmë për sahabin që i tha: Kam bërë zina, andaj më pastro!, dikush kështu e dikush ashtu... Sprova e njeriut nuk do të mbarojë përderisa ai të jetë mbi këtë tokë. Mirë, por kjo koha jonë, çfarë kohe është? Si do të jetë disiplina për ta mbrojtur botën tonë të brendshme nga shejtani në këtë kohë? A ka ndonjë ndryshim kjo kohë, për shembull në fushën e imoralitetit, nga koha kur ka jetuar Hazreti Jusufi? A thua vallë njeriu i kësaj kohe është më i dobët se në periudhën e Faraonit kundrejt dëshirës së zjarrtë për pushtet? Mos vallë njeriu i kohës së sotshme e ka më të zjarrtë dëshirën ndaj pasurisë, familjes dhe fëmijëve se njeriu para një mijë vjetësh?

Si përgjigje ndaj kësaj pyetjeje mund të themi: "Sistemi është i njëjti sistem, por kanë ndryshuar mjetet." Si thotë Mevlana: "Brenda njeriut gjendet edhe Musai, edhe Faraoni." Domethënë se cilitdo që t'ia hapim rrugën, ai do ta marrë pushtetin në qenien tonë. Mjedisi i imoralitetit që e servir shejtani në formën: "I kam përgatitur të gjitha. I kam mbyllur dyert... Eja pra, çfarë po pret!", është "mjedisi më i fuqishëm" për t'i mashtruar njerëzit në të gjitha kohërat. Kështu ka qenë edhe para tri-pesë mijë vjetësh, kështu është edhe sot.

Mund të thuhet se "në këtë kohë" shejtani ka arritur një fuqi të madhe, e rrethon nga çdo anë njeriun, sikur po e mbyt. Ushtarët e tij që i ka formuar nga lloji i njerëzve, janë të preokupuar për t'i dhënë sa më shumë mundësi atij. Për shkak të kësaj, shejtani jo vetëm që qarkullon nëpër damarë, por edhe të gjithë atmosferës ku marrim frymë pothuajse i ka hedhur pluhurin e shkatërrimit të tij. Në këtë mënyrë, njeriu është i rrethuar prej shejtanit nga ana e djathtë, nga ana e majtë, nga përpara, nga mbrapa, nga lart dhe nga poshtë.

A nuk mund ta kuptojmë këtë hadith fisnik si një paralajmërim të të Dërguarit të Allahut (a.s.), për një "kohë të ndryshme"?

"Për ata që kapen pas Sunetit tim në një kohë kur umeti do të shkatërrohet, do të ketë sevape sa një-qind dëshmorë." (Taberani, "el-Evsat"; vëll. 2, fq. 31.) Përsëri i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, thotë:

"Do të vijë një kohë që për ta zbatuar Islamin do të jetë si të mbash prush në dorë." I Dërguari i Allahut (a.s.), ato ditë i cilëson si ditë të durimit. "Kapja pas Sunetit" mund të kuptohet si të kapurit pas Islamit që e ka zbatuar/përjetuar i Dërguari i Allahut, pasim i të Dërguarit të Allahut, kapja për dore e tij, ecja në gjurmët e tij dhe të qenët bashkë me atë.

Në të vërtetë, siç mund të ketë mjedise shthurjeje në periudha të ndryshme të kohës, mund të ketë edhe për formimin e vendeve për t'u mbrojtur. E fshehta e kësaj pune është që njeriu të mos e humbasë dhe të mos e harrojë pikën më të lartë të tij. Kjo pikë e lartë është lidhja që njeriu ka me Zotin. Pra, e gjithë çështja është nëse e harrojmë apo nuk

e harrojmë këtë.

Ja çfarë thuhet në dy ajetet fisnike të mëposhtme:

“Ata i ka vënë poshtë djalli dhe i ka bërë që të harrojnë përmendjen e Allahut. Ata janë pala e djallit; në të vërtetë, pala e djallit janë humbësit.” (Muxhadele, 19)

“Atij që shmanget nga Këshilla e të Gjithëmëshirshmit (Kurani), Ne do t’ia caktojmë një djall, që do t’i bëhet shok i pandashëm.” (Zuhruf, 36)

Ai që e harron Allahun, bëhet pjesëtar i pasuesve të shejtanit. Ai që e harron Allahun, bëhet palë e shejtanit. Më së fundi, bëhet mik i tij. Atëherë, çfarë duhet të bëjmë? Nuk duhet ta harrojmë Allahun dhe duhet të marrim edukatën: “Kudo që të jemi, Ai është me ne.” Nuk duhet ta nënvlerësojmë luftën që shejtani vazhdon ta bëjë kundrejt njeriut dhe duhet të përgatitemi kundër fushave të ndërhyrjes së tij siç përmenden në Kuratin Fisnik. A nuk mund ta kuptojmë ajetin e mëposhtëm brenda korvizës së luftës kundër shejtanit, të cilin Zoti (xh.sh.), e cilëson si “armiku i njeriut”.

“Përgatisni kundër tyre kuaj dhe forcë për luftë sa të mundni, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë, përveç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por që Allahu i njih. Çfarëdo që të shpenzoni në rrugën e Allahut, do t’ju shpërblehet dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi.” (Enfal, 60)

Ne duhet të jemi të përgatitur kundër luftës. Atë ditë i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “Fuqia është gjuajtja.” Atë kohë gjuajtja bëhej me shigjetë. Ndërsa sot gjuajtja ka me mijëra forma. Gjuajtja e fjalës, gjuajtja e pamjes, gjuajtja e mesazhit, gjuajtja e raketës, etj. Për këtë arsye, ne duhet ta kuptojmë ndotjen e ajrit që e thithim dhe duhet të prodhojmë filtra shpirtërore kundrejt kësaj ndotjeje. Gjithashtu, nuk duhet të gjendemi në mjedisë ku sundon shejtani. Pra, duhet të zhvillojmë mjedisin tonë. “Kur të shohim ndonjë të keqe, të paktën duhet ta urrejmë me zemër dhe të rezistojmë kundër saj nëse janë konsumuar të gjitha mundësitë për ta ndaluar si ndërhyrja me dorë apo me gjuhë.”

Ne duhet ta dimë se lufta kundër bashkëpunimit të shejtanit me nefsin është një luftë shumë e vështirë, prandaj duhet të marrim ndihmë nga udhëzuesi i kësaj rruge. Vite më parë, patëm nënvizuar marrjen e këtyre masave:

-Njeriu, për t’u mbrojtur nga shejtani, duhet t’i kuptojë mirë ndjenjat që i vijnë nga brenda dhe t’i ndjejë “frymëzimet e djallit”.

-Shtëpitë kanë nevojë për një ndjeshmëri të veçantë, në mënyrë që të mbrohen nga shejtani. Çfarëdo që të jetë e nevojshme, duhet ta bëjmë, në mënyrë që të mos biem në fatkeqësinë për ta pranuar si mysafir shejtanin në shtëpinë tonë. Shtëpitë është kusht që të pastrohen nga gjurmët e shejtanit.

-Kurrë nuk duhet t’ia japim mundësinë shejtanit që të ketë një bazë as te vetja jonë dhe as te fëmijët.

-Kur shejtanët ta mbledhin të gjithë fuqinë e tyre dhe të na sulmojnë, ne duhet t’i kemi rrugët e hapura për t’u strehuar te Allahu Teala. Pra, nuk duhet t’i kemi humbur këto rrugë.

-Asnjëherë nuk duhet ta humbasim vullnetin për t’u bërë prej njerëzve që nuk dalin nga rruga e Zotit (xh.sh.), kundrejt armiqësisë së tmerrshme të shejtanit.

-Kurani Fisnik pasi i konsideron disa vepra si vepra të “injurancës”, ndër të cilat mund të përmendim alkoolin, bixhozin, adhurimin e idhujve dhe shigjetat e fallit, i cilëson ato si “punë të shejtanit” dhe “punë të ndyra”. (Shik. Surja Maide, 90.) Atëherë, duart, sytë, veshët dhe zemrën nuk duhet t’i fusim në punët e shejtanit dhe nuk duhet t’i lejojmë të përlxyhen me to.

-Ne duhet të shfaqim një ndjeshmëri të jashtëzakonshme, në mënyrë që asnjë vepër apo sjellje e jonë të mos hyjë në statusin e “luftës në rrugë të shejtanit”. (Shik. Surja Nisa, 76.)

-Ai që na prin, duhet ta përvetësojë lidhjen me Allahun e Madhëruar. Asnjëherë nuk duhet të kemi një stil jete që mund të cilësohet si “pasim i hapave të shejtanit”. (Shik. Surja

Bekare, 168, 208.)

-Mënyra devijuese më interesante e shejtanit është “paturpësia” dhe pastaj të gjitha ligësitë e tjera. (Shik. Surja Nur, 21.) Paturpësia dhe të gjitha ligësitë e tjera për ne duhet të jenë një zjarr përvëlues sikur kapja e shejtanit për dore.

-Ecuria e shejtanit në mënyrë djallëzore ka filluar me diskutimin dhe kundërshtimin e urdhrit të Allahut Teala. Nisur nga kjo, ndjeshmëria më primare e besimtarit duhet të jetë bindja dhe zbatimi i urdhrave të Allahut Teala me një nënshtrim shpirtëror.

-Dhe e fundit: Ne duhet t’i kërkojmë mbrojtje Allahut (xh.sh.), kundrejt çdo lloj hileje të shejtanit...

Atëherë, le të fillojmë:

Eudhu bil-lahi mine’sh-shejtani’rr-raxhim!.. I kërkoj mbrojtje Allahut prej shejtanit të mallkuar!..



Ai që e harron Allahun, bëhet pjesëtar i pasuesve të shejtanit. Ai që e harron Allahun, bëhet palë e shejtanit. Më së fundi, bëhet mik i tij. Atëherë, çfarë duhet të bëjmë?



Çështja e kohës, vendit dhe mundësisë në edukimin e nefsit

— Dr. Adem Ergyl —

Nefsi është emri i të vërtetës së njeriut. Domethënë është personaliteti ynë. Ndërsa edukimi i nefsit është pastrim i personalitetit nga mbetjet që nuk përputhen me cilësinë e të qenit njeri. Me një shprehje tjetër, ky është procesi i shndërrimit të njeriut të papjekur e të paedukuar në njeri të përsosur. Ky proces ka qenë për të gjithë njerëzit që nga Ademi (a.s.) dhe do të vazhdojë të jetë për të gjithë ata që do të vijnë deri në Ditën e Kiametit.

Çdo religjion dhe kulturë është përpjekur të formojë një sistem edukimi, në mënyrë që të ndërtojë njeriun e vet. Edhe civilizimi islam përgjatë gjithë historisë ka themeluar shumë institucione në lidhje me këtë çështje dhe ka akumuluar shumë përvojë për këtë. Urtësia e ekzistencës së mejtepeve, medreseve, teqeve dhe institucioneve të tjera të ngjashme me këto është për të nxjerrë në pah cilësinë njerëzore të kërkuar brenda kornizës së vlerave.

Në të vërtetë, edukimi i personalitetit arrihet nga bashkimi i shumë faktorëve që duken sikur kanë lidhje apo sikur nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin. Edukimi fillon që me ekzistencën e njeriut në barkun e nënës. Me mënyrën se si ajo e rrit të voglin e saj, si i drejtohet fëmijës... Edhe roli i babait

ka një dimension që kurrë nuk mund të shpërfilllet. Ambienti i shtëpisë në të cilën rritet fëmija, lagja, shkolla ku mëson, mësuesi dhe shoqëria kanë shumë ndikim. Në të njëjtën mënyrë mund të themi se edhe puna, partneri dhe mjedisi social nuk mund të neglizhohen në formimin e personalitetit. Këtyre duhet t'u shtojmë edhe ndikimin e vendit gjeografik, të mundësive materialo-shpirtërore, të xhemateve, të popujve dhe të shteteve në të cilat gjendet apo jeton njeriu. Të gjitha këto që i radhitëm absolutisht kanë një rol të rëndësishëm në formimin e personalitetit edhe pse roli i tyre mund të jetë i ndryshëm. Për këtë arsye është thënë: "Njeriu është si rrethi i tij social." Para, përgjatë dhe në fund të këtyre gjendet edhe një vullnet sublim të cilit në planin njerëzor nuk ia kemi zgjidhur dot fshehtësinë. Ai është vullneti i Zotit (xh.sh.). Në lidhje me këtë fushë e cila është gajb për ne (jashtë perceptimit tonë), nuk bëhet fjalë që të kemi ndonjë informacion më të shumtë që mund të thuhet përtej besimit. Rezultatit e edukimit të personalitetit duke i pasur parasysh këto të vërteta është e lehtë ta lidhësh me ndonjë person apo institucion, por në të njëjtën kohë kjo është edhe afrim ndaj çështjes me një këndvështrim

jo gjithëpërfshirës.

Vullneti dhe zgjedhjet tona janë jashtëzakonisht të rëndësishme në edukimin e personalitetit. Madje, në lidhje me këtë është thënë: “Njeriu është përmbledhja e zgjedhjeve të tij.” Po, edhe pse çdo gjë nuk përbëhet nga zgjedhjet tona, ndikimi që kanë ato te personaliteti ynë është aq i madh sa asnjëherë nuk duhet të nënvlerësohet. Edhe pse nuk mund t’i zgjedhim prindërit, mund t’i zgjedhim lagjen, shkollën, mësuesin, hoxhën, shokun/shoqen, bashkëshortin/ten, punën, mjedisin social, ata që i duam, librin që do ta lexojmë, programin që do ta ndjekim, rrugën që do të pasojmë, besimin, veprat dhe shumë gjëra të tjera, me lejen e Allahut. Në të vërtetë, ajo që kërkohet dhe pritet prej nesh është që të zgjedhim të drejtën, të bukurën dhe të mirën në fushat që janë lënë në dorë të vullnetit tonë. Një konceptim i tillë do të na bëjë të meritojmë edhe mëshirën hyjnore dhe inshallah do të na shpjerë drejt shpëtimit.

Nëse e lëmë veten dhe pasardhësit tanë në rrjedhën e rrëkesë kundrejt këtyre shumë dimensioneve të edukimit të personalitetit, atëherë do të thotë që kemi humbur që në fillim. Ajo që duhet të bëjmë është që të fitojmë mëshirën hyjnore dhe të arrijmë në bregun e paqes me një zgjuars, largpamësi dhe mjeshtëri të madhe pa e humbur drejtimin nga kushtet vendore dhe globale që na rrethojnë. Ndiham hyjnore do t’u shkojë atyre që e japin një përpjekje të tillë dhe rrugët do t’u hapen. Allahu Teala na njofton si më poshtë në lidhje me këtë sihariq:

“Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t’i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirët!” (Ankebut, 69)

Çdo njeri ka përgjegjësinë për të bërë kërkimin më të mirë në emër të edukimit të personalitetit në vendin e kohën ku jeton dhe me mundësitë që e rrethojnë. Ndërkohë që përgjatë këtij procesi edukimi përgjegjësia bie më shumë mbi familjen, mjedisin dhe shtetin deri në moshën e pubertetit dhe pjekurisë (12-17 vjeç), në periudhat e mëvonshme më së shumti bie mbi vetë personin. Përmirësimi, islamizimi dhe zhvillimi në formën më të bukur të çdo hallke që ka ndikim në emër të edukimit dhe pastrimit është një përgjegjësi për të gjithë myslimanët sipas mundësisë së tyre duke filluar nga individët e deri te shoqëria.

Asnjë hap në emër të edukimit nuk mund të përçmohet, sepse shkalla e fortësisë së një zinxhiri është sa hallka më e dobët e tij. Meqë edukimi është një proces, atëherë, çdo fazë e këtij procesi detyrimisht duhet të jetë e shëndoshë. Historia ka treguar se gjithmonë këmbët kanë mundësinë të rrëshqasin në ndonjë fazë të këtij procesi. Puna është serioze dhe e rëndësishme saqë nuk mund të lihet në mëshirë të fatit. Të mbështetesh tek Zoti pa i kryer shkaqet që i ka vendosur Ai, nuk është një

veprim i drejtë. Nisur nga këto që thamë, çfarë rruge duhet të ndjekim për vete dhe për pasardhësit tanë në shekullin tonë, që bota është shndërruar në një fshat të vogël dhe komunikimi është në kulmin e tij? Sigurisht se secili prej nesh është i detyruar t’ia japë përgjigjen kësaj pyetjeje sipas kushteve në të cilat ndodhet. Por sidoqoftë, në çdo vend dhe kohë ka gjëra themelore ndaj të cilave duhet të kemi kujdes. Sigurisht që këtyre duhet t’u shtojmë edhe gjërat e domosdoshme të shekullit tonë.

Disa çështje që mund t’i shndërrojmë në synime dhe aktivitete në emër të edukimit të personalitetit në kohën tonë janë:

1) Së pari duhet t’i jepet rëndësi ushqimit hallall, sepse bindja e përbashkët e të gjithë edukuesve dhe udhëzuesve është kjo: Edhe pse ushqimi ushqen trupin, ai ka një detyrë esenciale në formimin e personalitetit. Nëse dëshirojmë që ai të prodhojë energji pozitive, patjetër duhet ta fitojmë me hallallek dhe me një zemër të vigjilente (që nuk e harron Allahun Teala).

2) Shembulli i prindërve përbën themelet e edukimit të personalitetit. Fëmija është amaneti i Allahut. Ne jemi përgjegjës që ta edukojmë atë sipas rregullave të Zotit (xh.sh.). Vatra familjare përbën shtyllën kurrizore të edukimit në formimin e besimit, adhurimit, sjelljes dhe moralit. Nisur nga këto, vatra familjare që në fillim nuk duhet të formohet duke pasur në qendër dëshirat dhe interesat, por vlerat. Edhe pasi të formohet, ajo duhet të shndërrohet në një vatër edukimi me begatinë e dijes, edukatës dhe shërbimit.

3) Ne jemi të detyruar ta zgjedhim mjedisin dhe pallatin ku do të banojmë. Njeriu është një krijesë që formon lidhje dhe miqësi. Formimi i rezistencës kundrejt mjedisit nuk është i lehtë. Prandaj duhet të veprojmë me zgjuars e largpamësi dhe duhet të zgjedhim një vend sa më të favorshëm.

4) Ne duhet të shfaqim kujdes në zgjedhjen e shkollës dhe të mësuesit, sepse shkolla/medreseja, sipas kushteve të sotme, zgjat sa një e treta e jetës së njeriut. Këto vatra edukimi janë mekanizmat e shndërrimit dhe edukimit të njeriut për formimin e personalitetit dhe drejtimin e njeriut në jetë. Nisur nga kjo, myslimanët janë të obliguar të hapin shkollat e tyre në bazë të këtyre vlerave të edukimit islam dhe ta marrim seriozisht edukimin. Në të kundërt, procesi i formimit të një personaliteti me të cilin është i kënaqur Allahu Teala nuk mund të realizohet në shkallën e dëshiruar.

5) Kultura e Kuranit Fisnik, jeta dhe morali shembullor i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe vetëdija në lidhje me historinë e civilizimin, duhet të mundësojnë një bazë serioze informacioni. Nëse nuk arrijmë t’ua japim njerëzve një informacion të tillë, atëherë është e pamundur ta edukojmë dhe ta mbrojmë tipin e njeriut që mendon dhe jeton

sipas Islamit në botën e sotme që po globalizohet. Sepse, për t'u mbrojtur kundrejt rrymave të huaja domosdoshmërisht kemi nevojë për një bazë të fuqishme.

6) Shumë e rëndësishme është që vlerat islame të jenë përcaktuese në zgjedhjen e punës dhe të partnerit, sepse zgjedhjet e gabuara në këto dy çështje kanë një ndikim të jashtëzakonshëm në degjenerimin dhe devijimin e njeriut. Në lidhje me këtë çështje të gjithë kanë mundësinë të dëshmojnë shembuj të pafund rreth e rrotull tyre.

7) Sado që njeriu të jetë i informuar në ditët tona kur mjetet e komunikimit dhe media ka rrethuar çdo fushë të jetës, prapë se prapë e ka të vështirë ta ruajë i vetëm rrugën e drejtë. Njeriu tashmë është vetmuar. Ndërkohë vetmia është dobësi. Nisur nga këto që thamë, tashmë është bërë e domosdoshme që një grup i shëndetshëm duhet të gjendet brenda një shoqërie që formohet nga njerëz të devotshëm dhe të singërtë. Urdhri hyjnor në formën: “Ndiqmojeni njëri-tjetrin në mirësi dhe devotshmëri!”, tregon se për të qenë e për të ngelur të mirë dhe të devotshëm, duhet ta ndiqmojmë njëri-tjetrin.

8) Shekulli ynë është shndërruar në një shekull ku nefsi është bërë faraon, prijës dhe sundimtar. Sot po inkurajohet brezi që di të thotë vetëm “unë” dhe egos së njeriut po i jepet përparësi. Në një situatë të tillë kur njeriu gjendet nën udhëheqjen e “nefsi emmares”, e cila urdhëron të keqen me të gjithë mundësinë që ka, sigurisht se vlerat njerëzore do të shkojnë drejt esfelit safilin (në gjendjen më të ulët). Për ta ndaluar këtë poshtërim dhe për t'i drejtuar njerëzit drejt gjendjes “ahseni takvimi” (në trajtën më të përkryer), duhet t'i hapim përsëri mejtepet e dijes së civilizimit tonë.

9) Shoqëritë që nuk kanë dijetarë të devotshëm, të përsosur dhe të urtë, me kalimin e kohës do të shpëputen nga vlerat dhe përshpirtja, do të shndërrohen në njerëz të materializmit dhe së fundi do ta humbasin humanizmin e tyre. Po, dje ka pasur nevojë për dijetarë të përsosur dhe të devotshëm. Ndërsa sot kjo nevojë është shumë më e madhe. Kultura dhe zakonet që po përjetojnë kanë nxjerrë në pah një brez që jeton në mënyrë të pavendosur dhe vetëm për të sotshmen. Njerëzit që kanë vullnet, durim dhe vendosmëri të fortë me të cilat mund të qëndrojnë vetë në këmbë janë pakësuar ndjeshëm. Ja, pikërisht në këtë periudhë ka nevojë të jashtëzakonshme për disiplinën e mistikës islame. Udhërrëfimi i murshidëve të përsosur që tregojnë rrugën është bërë i domosdoshëm. Për momentin e kemi të vështirë të themi se numri i dijetarëve tanë të vërtetë është i mjaftueshëm. Të qenët shkencëtar pa vepra dhe pa përshpirtje është përvetësuar si një profesion. Le ta shprehim me keqardhje edhe të vërtetën se vatrë që mund ta vazhdojnë procesin e përsosmërisë mistike në mënyrë të shëndetshme po pakësohen dhe po shuhen nga dita në ditë. Vatrë

e tasavufit, apo siç e shprehim me gjuhën e kësaj kohe, vatrë e sejri sulukut, për shkak se janë të privuara nga njerëzit e pjekur dhe edukues, janë të detyruara të japin një edukim pothuajse me metodën e fakultetit me korrespondencë. Kjo është një situatë e rëndë për të cilën umeti islam patjetër duhet të marrë masa, sepse edukimi nuk është një proces që merret dhe përfundohet për një kohë të shkurtër. Edukimi duhet të jetë i vazhdueshëm. Vatrë që mund ta realizojnë më së miri këtë organizim janë vatrë e shëndetshme të dijes. Këto institucione me evradet, dhikret, ligjëratat dhe shërbimet e tyre e kanë kryer në mënyrë më të mirë këtë mision përgjatë gjithë historisë. Përsosmëria e këtyre vatrave duhet të jetë prej çështjeve më primare të njeriut të sotshëm në emër të edukimit dhe pastrimit.

10) Njeriu e sotshëm është e pamundur ta mbash në vend të mbyllur për një kohë të gjatë, në mënyrë që ta edukosh. Për këtë arsye, duhet të kërkohen mundësitë për ta edukuar atë brenda gjallërisë së jetës. Për ta arritur këtë ka nevojë për një edukim serioz të vullnetit. Gjithashtu duhet të kërkohen dhe të zhvillohen rrugët e metodat për të përfutur në mënyrë të mjaftueshme dhe të shëndetshme nga mjetet e komunikimit. Ne duhet t'i zhvillojmë aftësitë për t'u organizuar dhe duhet të formojmë mjedise të përshtatshme sipas moshës, shkallës dhe mundësisë së çdo njeriu.

11) Edukimi i personalitetit nuk duhet të kufizohet vetëm me marrjen e dijes. Marrja pjesë në shërbimet fetare në mënyrë aktive dhe bërja e projekteve bashkë me njerëz të ndershëm e cilësorë është mundësia më produktive për ta arritur përsosmërinë duke vepruar dhe duke parë. Nisur nga këto që thamë, organizatat vullnetare duhet të shtohen në numër dhe të përsosen nga aspekti i cilësisë.

Përfundimisht mund të themi se pastrimi i neftsit (edukimi i personalitetit) në kohën e sotme është shumë më i vështirë. Por prapë se prapë nuk duhet të harrojmë se mëshira e Zotit, i Cili është Mëshirues dhe Mëshirëbërës, është e mjaftueshme për të gjitha periudhat. Dobësia nuk i ka hije myslimanit. Asnjëherë nuk duhet të harrohet e vërteta se në çdo vështirësi mund të gjendet një rrugëdalje. Në momentin kur të gjendet kjo rrugëdalje, menjëherë duhet të hyhet në të me ndihmën e Zotit.



Drejt klimës së përsosmërisë

Prof. dr. Irfan Gyndyz

Rexhepi, Shabani dhe Ramazani emërtohen si “tre muajt” në traditën tonë. Ne po shkojmë përsëri drejt një klime përsosmërie në ditët dhe netët e bekuara të këtyre muajve. Këta muaj, në të cilët lutjet që bëhen shkojnë dallgë-dallgë te Allahu Teala dhe në të cilët lotët që derdhen i fshijnë mëkatet, janë zhurma e këmbëve të Ramazanit dhe Bajramit. Ky është një shans për njeriun, i cili ka aftësi engjëjllore po aq sa edhe djallëzore, në mënyrë që të pastrohet nga mëkatet dhe ta arrijë pjekurinë e përsosur në adhurim ndaj Allahut Teala.

Kohët dhe vendet e marrin vlerën dhe shenjtërinë e tyre nga Kurani Fisnik. Mendimi se pas çdo zakoni gjendet një ajet, nga kjo buron. Mbi të gjitha, ngjarjet që realizohen në këta muaj dhe ndodhitë që i mbushin ato vende, i japin vlerë kohës dhe vendit në të cilin gjenden. Këta muaj, ditë dhe net të bekuara, të cilave u është vërtetuar shenjtëria e tyre me ajete dhe hadithe fisnike dhe të cilat besimtarët i festojnë që prej qindra vitesh, janë periodha rehabilitimi të shpërndara përgjatë vitit.

Ndërmjet shkaqeve që u japin vlerë këtyre muajve janë edhe 4 prej pesë netëve të mira që gjenden në to. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka dhënë lajme përgëzuese për këta muaj. Njëri prej tyre është siç vijon: “Rexhepi është muaji i Allahut, Shabani është muaji im dhe Ramazani është muaji i umetit.” Argumenti më i bukur për t’i vlerësuar këta muaj është lutja e tij (a.s.), në të cilën thotë: “O Allah! Na e bëj të begatë Rexhepin e Shabanin dhe na bëj ta arrijmë Ramazanin!”

Muajt Rexhep dhe Shaban vijnë para muajit Ramazan. Kjo është shumë e rëndësishme nga aspekti i përgatitjes për muajin e Ramazanit. Vlerësimi i këtyre muajve për t’u pastruar nga mëkatet, për të marrë sa më shumë sevape dhe për të shpëtuar nga gabimet duke bërë llogarinë e të kaluarës, shndërron në një shans për të hapur një faqe të re në jetën tonë.

Këta muaj kanë një rol të madh te njeriu, në mënyrë që ai të arrijë pjekurinë në cilësitë njerëzore dhe në marrjen nën kontroll të vullnetit. Këta tre muaj duhet të na kujtojnë detyrat dhe përgjegjësitë që kemi kundrejt Krijuesit, familjes, fëmijëve, popullit dhe të gjithë njerëzimit. Ata duhet të jenë shkak që t'i lëmë gabimet e mangësitë dhe të zgjohemi nga gjumi i shkujdesjes. Ata duhet t'i largojnë grindjet, ndarjet, kontradiktat, hesapet e interesave personale dhe ndryshimet e vogla në mendime ndërmjet nesh. Ata duhet të na forcojnë vëllazërinë, unitetin dhe bashkimin për të cilët kemi nevojë më shumë se kurrë dhe të cilët feja jonë sublime i kërkon me këmbëngulje. Gjithashtu, duhet të na mundësojnë rigjallërimin e cilësive humano-morale.

Në këta muaj duhet t'i vendosim rregull vetes, duhet të përparojmë nga dita në ditë, duhet të kalojmë me vetëdije të plotë fetare nga Shabani në Ramazan dhe më së fundi duhet të arrijmë te Bajrami i vërtetë nga aspekti material dhe shpirtëror. Në këta muaj duhet të kemi kujdes ndaj këshillës së Mevlanës, i cili ka thënë: “Bëje stomakun që të heqë dorë nga bari dhe elbi! Fillo dhe ushqej me aromë të mirë dhe trëndafilat! Stomaku i trupit e tërheq njeriun drejt vendit ku grumbullohet kashta, ndërsa stomaku i zemrës e tërheq atë drejt përshpirtjes. Ai që ha bar dhe elb, bëhet kurban. Ndërsa ai që ushqehet me dritën e Allahut, bëhet Kuran.”

“Përsosmëria nuk mund të arrihet me mjete të këqija.” Perdja e madhe që është vënë ndërmjet robit dhe Allahut Teala nuk janë qiejt dhe toka. Dëshirat epshore e djallëzore dhe pasionet vetjake janë kyçe që u janë vënë zemrave të atyre që kanë rënë robër të dashurisë së kësaj bote. Në këta muaj duhet t'i thyejmë këta kyçe dhe të shpëtojmë nga pasionet që na tërheqin drejt kësaj bote. Nëse shkojmë pas shpirtit dhe ndjenjave shpirtërore, do të arrijmë sublimen. Nëse zvarritemi pas trupit dhe epsheve të tij, do të poshtërohemi. “Në këtë botë ka shkallë që një nga një arrijnë deri në qiell.” Andaj, ti lartësohu duke hipur në këto shkallë!

Atmosfera e veçantë e këtyre tre muajve, i ndan ata nga muajt e tjerë. Ndërkohë që mirësia e çdo

muaji përjetohet në botën tonë të jashtme, këta tre muaj të shenjtë përjetohen në botën tonë të brendshme me zemër dhe meditim. Njerëzit që i drejtohen pasqyrës së shpirtit dhe të zemrës në këta muaj, shohin planin e pasmë dhe të vërtetën e gjërave.

Në këta muaj koha ngjyrosset me ngjyrat e Ahiretit. Nata e mirë Regaib, e cila për herë të parë i zgjon ndjenjat tona të etura për t'u rregulluar në këto ditë të bekuara, është një stacion që na drejton për te Allahu Teala. Ndjenja e pafundësisë dhe cilësia engjëllore na përfshijnë dhe na tërheqin shpirtrat tanë drejt qiejve.

Nata e madhe e Miraxhit, e cila vjen pas saj, vjen me një fllad që na i gjallëron zemrat. Nata e mirë Beraat, u thërret me sihariqin e shpëtimit atyre që kanë bërë kujdes ndaj këtyre paralajmërimeve. Nata e Kadrit i rrethon ata me një frymëzim dhe begati që mund të fitohet me një përpjekje një mijë mujore dhe i përqafton me butësinë e faljes nga Zoti (xh.sh.).

Ndërgjegjja përgjatë Ramazanit, i cili është një muaj i ngrohtë, i butë dhe i mbushur plot mëshirë, kalon në gatishmëri, zemrat zgjohen dhe të gjitha ndjenjat shfaqin një grafik lartësimi që shkon drejt pejgamberëve dhe engjëjve. Mund të thuhet se muaji i Ramazanit përfshin ditët më të ndritura, më ndikuese dhe më të mira të vitit. Gjithashtu, në ditët e tij jeta jonë shpirtërore bëhet më e thellë dhe ndriçohet pasqyra e zemrës sonë. Në çdo zë përgjatë Ramazanit gjendet premtimi për një fillimi të ri dhe në çdo frymë shikohet shpresa për shpëtim. Jeta është aq e thellë dhe domethënëse në muajin e Ramazanit sa që çdo fjalë që flitet dhe çdo zë që dëgjohej, njeriut i duket si një poezi që shpërthen nga zemra.

Në çdo yftar dhe imsak, njeriu ndjen se i është hapur një derë e re për t'u takuar me Zotin (xh.sh.). Engjëjt pastrojnë zemrat tona me prekjet e tyre si të pambukta.

Nata e Kadrit është nata kur Kurani Fisnik ka zbritur i gjithi në qiellin e kësaj bote nga Levhi Mahfudh. Xhebraili (a.s.), këtë natë ia ka sjellë shpalljen Pejgamberit për herë të parë. Nata e Kadrit do të thotë nata e caktimit. Nata e Kadrit është gjendja e lutjes së pranuar që i Dërguari i Allahut (a.s.), ka bërë për umetin.



Siç e ka fshehur Allahu Teala exhelin brenda jetës, robërit e tij të dashur ndërmjet njerëzve dhe emrin më të madh të Tij ndërmjet emrave të tjerë të bukur, në të njëjtën mënyrë ka fshehur edhe kohën e pranimit të lutjes në ditën e Xhuma, namazin e mesëm ndërmjet pesë kohëve të namazeve, kënaqësinë hyjnore brenda të gjitha ibadeteve, Kiametin brenda kohës, vdekjen brenda jetës dhe natën e Kadrit brenda muajit të Ramazanit. Këtë e ka bërë në mënyrë që çdo natë të gjallërohet me ibadet sikur të ishte nata e Kadrit dhe çdo njeri që vjen të nderohet si të jetë Hizri.

Tre muajt janë kohë të shenjta në të cilat njeriu mund të jetë më afër se kurdoherë me Allahun (xh. sh.), mund të meritojë më shumë se kurdoherë mëshirën e gjerë të Zotit, mund të pastrohet nga mëkatet më shumë se kurdoherë dhe mund të shëtisë më shumë se kurdoherë në horizontin e zemrës dhe të shpirtit. Padyshim se njeriu në këto kohëra të bekuara më së pari duhet të meditojë seriozisht, në mënyrë që të zhvishet nga barra e trupit dhe e nefsit, të lartësohet në një horizont të caktuar dhe të arrijë një gradë të lartë. Kur të përpiqet për ta bërë këtë, ai vazhdimisht duhet ta mbajë të hapur zemrën dhe shpirtin e tij ndaj përshpirtjes.

Për t'i ndjerë në kuptimin e përsosur dhe për t'i shijuar mirësitë e veçanta të këtyre kohëve të begata dhe kënaqësitë që ata reflektojnë në zemrën e njeriut, duhet të dihet se këto periudha kohore janë nga një shans dhe pasuri siç e thamë që në krye dhe duhet të vlerësohen në mënyrë serioze duke mos humbur asnjë sekondë prej netëve dhe ditëve të tyre. Po, për t'i ndjerë mirësitë që këto ditë dhe net të bekuara i dhurojnë me bollëk për ne, para së gjithash duhet t'u besojmë dhe t'i drejtohem Zotit me lutje në lidhje me to.

Nëse nuk i drejtoheni përshpirtjes së këtyre muajve, edhe ata nuk ua hapin dyert e tyre, sepse aq sa ka vlerë një fjalë që thuhet, aq është i rëndësishëm edhe këndvështrimi, qëllimi dhe perceptimi i njerëzve ndaj kësaj çështjeje. Nisur nga kjo, njeriu duhet të preokupohet jashtë mase me këta muaj, në mënyrë që ta ndjejë se çfarë i thonë këta muaj shpirtit të tij. Përndryshe, përderisa të mos shpëtojmë nga sipërfaqësia/cektësia e gjërave dhe të mos kërkojmë për të vërtetën e këtyre muajve, edhe fjalët më të bukura që thuhet në lidhje me këta muaj do të na hyjnë në njërin vesh dhe do të na dalin nga veshi tjetër. Njerëzit që nuk përpiqen për ta rinovuar veten dhe që nuk janë seriozë në sjelljet dhe veprimet e tyre përgjatë një periudhe të tillë e cila nuk është gjë tjetër përveçse mirësi, e kanë të pamundur të përfitojnë prej këtyre muajve. Ndërkohë mund të themi se është e vërtetë që në kohët e sotme shoqëria jonë në një masë të konsiderueshme po e njeh vlerën dhe begatinë e këtyre muajve, po i drejtohet

xhamive dhe po i përgjërohet Allahut të Madhëruar. Ja pra, kjo situatë duhet të vlerësohet si një mundësi e vyer për t'u dhënë shpirtit të njerëzve mesazhe të caktuara nëpërmjet programeve dhe aktiviteteve të ndryshme. Në këtë mënyrë, mund të themi se këto net të begata i kemi vlerësuar siç duhet për t'i afuar njerëzit të Allahu Teala dhe për t'i njoftuar zemrat me të vërtetat e fesë islame. Siç mund t'i njoftojmë me disa të vërteta të tilla zemrat e njerëzve që vijnë në xhami, mund të organizojmë edhe mbledhje, bisedime dhe ligjërata fetare në vende të tjera. Në këtë mënyrë, do t'i kemi vlerësuar siç duhet shpresat dhe pritshmëritë e njerëzve që besojnë se këta muaj shprehin diçka të rëndësishme për ta.

Qëllimi ynë në të gjitha aktivitetet që mund t'i bëjmë në këta muaj duhet të jetë që t'i afrojmë njerëzit qoftë edhe një hap më afër Allahut Teala. Në një periudhë kohe të tillë plot begati kur qiejt janë të mbushur me dritë dhe toka stoliset me sofrat qiellore, njerëzit gjithmonë duhet t'i drejtojmë për t'u thelluar në jetën e tyre shpirtërore dhe çdo punë që do ta bëjmë, gjithmonë duhet ta lidhim me qëllime sublime dhe këndvështrime të gjera. Në këtë çështje duhet të përparojmë aq shumë sa që çdo herë duhet t'u injektojmë një kuptim dhe shpirt të ri zemrave të njerëzve me të cilët flasim. Atyre duhet t'u drejtojmë velat drejt pafundësisë së përshpirtjes.

Për ta realizuar këtë, në çdo aktivitet që organizojmë absolutisht duhet të nxisim ndjenjën e ahiretit të njerëzit duke ua shprehur këto kuptime qoftë duke kënduar ilahi që janë trashëguar nga e kaluara, apo qoftë duke kompozuar ilahi të reja. Në zemrat e tyre duhet të zgjojmë mallëngjimin për të fituar lumturinë e përhershme dhe duhet t'i bëjmë ato që të veprojnë duke u shqetësuar nga humbja. Përfundimisht, njerëzit me të cilët flasim duhet të përpiqemi t'i drejtojmë drejt shpirtit të fesë.

Siç e ka fshehur Allahu Teala exhelin brenda jetës, robërit e tij të dashur ndërmjet njerëzve dhe emrin më të madh të Tij ndërmjet emrave të tjerë të bukur, në të njëjtën mënyrë ka fshehur edhe kohën e pranimit të lutjes në ditën e Xhuma, namazin e mesëm ndërmjet pesë kohëve të namazeve, kënaqësinë hyjnore brenda të gjitha ibadeteve, Kiametin brenda kohës, vdekjen brenda jetës dhe natën e Kadrit brenda muajit të Ramazanit.

MARRJA E VETES NË LLOGARI

— Osman Alltash —

1. Dëgjo, o nefsi im!.. Ti i përket Allahut Teala. Ti je robi i Allahut. Një rob i vërtetë asnjëherë nuk bën mëkate kundrejt Allahut.

2. Dëgjo, o nefsi im!.. Dikur nuk ke ekzistuar. Ndërsa tani po ekziston. Vullneti që ka fuqinë për të të sjellë në ekzistencë nga asgjëja, ka edhe fuqinë të të shkatërrojë në një moment. Madje, përpara teje ka vënë një adresë të tmerrshme si Xhehenemi. Andaj, bëj kujdes kundrejt këtij vullneti! Mos u mburr duke ia atribuuar vetes ekzistencën tënde! Mos guxo të mos shfaqësh respekt kundrejt vullnetit absolut!

3. Dëgjo, o nefsi im!.. Ti nuk ke asnjë rol në ardhjen tënde në këtë botë, në caktimin e gjinisë, në caktimin e racës, ngjyrës, formës dhe të prindërve, në caktimin e kohës dhe vendit të ardhjes. Ti ke ardhur në këtë botë plotësisht me vullnetin dhe caktimin e Allahut të Madhëruar. Andaj njihe cakun kundrejt forcës dhe fuqisë e cila të ka krijuar pa u konsultuar me ty dhe pa të marrë mendimin tënd. Edhe një herë pra, sillu me edukatë dhe mos e kalo cakun!

4. Dëgjo, o nefsi im!.. Në ajetin e 16, 17 dhe 18 të sures Kaf, thuhet: **“Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë ç’i pëshpërit atij shpirti i vet. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet. Dy engjëj i rrinë atij nga e djathhta dhe e majta, dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm** (për ta shënuar atë).” Në këtë mënyrë, njoftohemi se të gjitha fjalët që dalin nga goja, regjistrohen pa asnjë mangësi prej engjëjve. Kështu që nuk ka asnjë fjalë që të mos regjistrohet nga engjëjt në të djathtë apo nga engjëjt në të majtë. Mos pandeh se ndonjë fjalë do të mbetet pa u shkruar. Ki kujdes dhe mos ua prish rehatinë engjëjve që ke në të majtë. Nëse ua prish rehatinë atyre, ata do të mbajnë shënime kundër teje. Kjo do të ishte një tragjedi për ty, Allahu na ruajt! Çdo gjë që e thua, forma në të cilën e thua, çdo gjë që bën dhe çdo sjellje që shfaq regjistrohet nga kamera hyjnore. Çdo gjë që ta thotë zemra, edhe nëse e bën, edhe nëse nuk e bën, Allahu e di atë. Andaj mos e kalo cakun e Atij që të njeh ty më mirë seç e njeh ti veten tënde! Mos i kërko në vend tjetër fatkeqësitë që të ndodhin!..

5. Dëgjo, o nefsi im! Allahu e di çdo gjë që bën, e shikon çdo gjë që bën, lajmërohet më parë se ti për atë që të thotë zemra, madje, e regjistron çdo gjë që del nga goja. Andaj bëj kujdes dhe mos shfaq sjellje të keqe kundrejt Atij duke e kaluar cakun!..

6. Dëgjo, o nefsi im!.. Sot je i udhëzuar, por për nesër nuk ke garanci. Edhe në frymën e fundit nuk ke garanci se do të shpërngulesh me besim nga kjo botë. Ki kujdes dhe mos u mburr duke pandehur se e ke nga vetja jote mirësinë që ke bërë!.. Ti dhe çdo gjë që duket si e jotja, në fakt jeni të Allahut Teala. Mos gabo duke e ngritur kokën kundër Zotit (xh.sh.), duke e pandehur çdo gjë sikur të ishte e jotja!..

7. Dëgjo, o nefsi im!.. Ibadetet që bën, në të vërtetë të kanë hije. Ki kujdes dhe mos bëj shirk!.. Ti nuk mund t’i bësh në asnjë lloj mënyre ibadetet që i kanë hije Allahut Teala.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “O Zoti im! Unë nuk mund të të lavdëroj ashtu siç e meriton Ti.” Atëherë, çfarë mund të thuash ti!..

8. Dëgjo, o nefsi im! Tëspihet që i bën, mos i bëj sikur të jenë ndonjë marifet i madh!.. Brengosu vazhdimisht ngaqë nuk ke mundësi të bësh ibadet siç e meriton Zoti (xh.sh.) dhe pendohu përsëri për pendimet që ke bërë!.. Në të kundërt, mjerë për ty nëse teatrin që e luan nuk e pëlqen Ai që po e ndjek... Nesër do të të përplasen në fytyrë... Aman bëj kujdes!..

9. Dëgjo, o nefsi im! Allahu ka robër të atillë që asnjë moment nuk janë të shkujdesur nga dhikri... Shko pranë atyre dhe matu me ta!.. Gjëja e parë që duhet të bësh është që të besosh përsëri. Pastaj t'i kërkosha mbrojtje Allahut Teala nga vetja jote, nga ato që ke bërë dhe nga ato që do të bësh. Andaj, ule kokën dhe ec me modesti!..

10. Dëgjo, o nefsi im!.. Nëse Allahu (xh.sh.), të ka dhënë një gjuhë për ta përkujtuar dhe një zemër për t'i bërë dhikër, do të thotë se me të vërtetë të ka dhënë një mirësi të madhe. Si do ta shlyesh borxhin e falënderimit për këtë? Ulu, bjer në sexhde dhe qaj!.. Robërit e dashur të Allahut kështu veprojnë. Ti shiko gjendjen tënde...

11. Dëgjo, o nefsi im! Nëse Allahu i Lartësuar të ka mbrojtur nga kufri, do të thotë se do të të japë Xhenetin. Prandaj dija vlerën kësaj! Nëse Allahu Teala të ka dhënë mirësinë për ta përmendur Atë me një nijet të singertë, me të vërtetë që të ka dhënë një mirësi të madhe. Dije se shpërblimi i dhikrit është Allahu. Kjo do të thotë se Allahu të do ty. Ki kujdes, sepse kjo është e rëndësishme për ty. Ti nuk mund ta paguash kundërvlerën e kësaj mirësie. Të paktën bëje nijet vazhdimisht për ta paguar dhe jeto me gjendjen shpirtërore të të varfërve që nuk kanë mundësi për ta paguar borxhin e tyre...

12. Dëgjo, o nefsi im!.. Ti e përmend Allahun, por edhe kjo mirësi krejtësisht është nga Allahu (xh.sh.). Nëse Allahu Teala nuk të kujton dhe nëse nuk të jep leje për këtë, qoftë edhe një herë nuk mund të thuash “Allah”. Allahun, i Cili ta ka mundësuar të thuash “Allah”, duhet ta falënderosh çdo ditë sa numri i elektroneve, neutroneve dhe protoneve të gjithësisë. Dije se Ai të do. Andaj ki kujdes dhe mos tento ta përdorësh për keq dashurinë e Atij që të do!..

13. Dëgjo, o nefsi im!.. Kurani Fisnik është i Allahut Teala. Ai ta ka dhënë ty Librin e Vet... Kurani Fisnik nuk u ka zbritur të tjerëve. Sa mirësi e madhe! Andaj dije se Ai të do dhe duaje Atë që të do!..

14. Dëgjo, o nefsi im!.. Çdo gjë është e Allahut të Lartësuar. Zotëruesi i çdo gjëje është Allahu (xh.sh.). Çdo njeri është robi i Allahut. Poseduesi i të gjitha këtyre krijesave që nuk i pëlqen është Allahu. Andaj, mos e zemëro Krijuesin duke mos i pëlqyer

krijesat. Përndryshe, nëse Ai zemërohet, asgjë nuk mund t'i dalë përpara zemërimit të Tij. Shikoje një herë veten me shikimin e Atij. Sa i dobët që je!..

15. Dëgjo, o nefsi im!.. Ki kujdes dhe mos e kundërshtoj Allahun Teala duke i dashur armiqet e Tij, duke i konsideruar të mirë ata që Ai i konsideron të këqij dhe duke i konsideruar të këqij ata që Ai i konsideron të mirë! Dorëzoju Allahut! Ngjarjet dhe vepruesit e tyre lëri në dorë të sheriatit! Çfarëdo që thotë Ai, absolutisht është e vërtetë.

16. Dëgjo, o nefsi im! Muhamedi, (a.s.), nuk është një njeri i zakonshëm. Ai është shumë i bukur dhe i veçantë. Ai është i dashuri i Allahut. Kur dëgjohej emri i tij në një vend, është vaxhib që t'i çohen salavate dhe të nderohet. Prandaj mos shfaq mangësi në respektin ndaj tij! Ai që nuk e respekton atë dhe që del nga rruga e tij, del edhe nga rruga e Allahut Teala. Kërkoji mbrojtje Allahut nga rënia në një humbje të tillë. Dije këtë, sepse kjo të mjafton.

17. Dëgjo, o nefsi im!.. Në namaz qëndron para Allahut të Lartësuar. Pranimi yt në atë audiencë është një mirësi në kuptimin e vërtetë të fjalës. Andaj dija vlerën mirësisë që të ka dhënë Allahu Teala! Frikë-respekti në namaz është shumë i rëndësishëm. Kuptojë këtë, sepse kjo të mjafton.

18. Dëgjo, o nefsi im!.. Në ajetin e 16-të të sures Kaf, Allahu (xh.sh.), thotë: “**Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë ç’i pëshpërit atij shpirti i vet. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.**” Përse i qëndron larg Allahut ndërkohë që Allahu është më afër teje se sa ti?..

19. Dëgjo, o nefsi im! Dhikri është faktori më ndikues që të afron me Allahun e Lartësuar. A e ke bërë nijetin për të thënë “Allah”? A ke kohë dhe energji për të thënë “Allah”? Nëse nuk i kë këto, atëherë do të thotë se kjo botë po të mashtron. Andaj bëj kujdes dhe mos u mashtro!..

20. Dëgjo, o nefsi im!.. Personaliteti shembullor i pashoq në Islam është Krenaria e Gjithësisë, i Dërguari i Allahut (a.s.). Ti je umeti i tij. Gjendjen tënde shpirtërore mund ta matësh kështu: Njeriu që e njeh dhe e pranon Islamin së pari ndan të njëjtin mendim me të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Kësaj gjendjeje shkurtimisht i thuhet përputhje në mendime. Pastaj fillon procesi për t’u bërë si i Dërguari i Allahut (a.s.). Në këtë mënyrë fillon të ndjejë të njëjtën gjë me Pejgamberin. Pasi e arrin përsosmërinë në këtë çështje, përpiket ta imitojë të Dërguarin e Allahut (a.s.), në gjendje, sjellje, veprime dhe drejtim. Pa shikoje veten një herë me shikimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.)! Sa ke prej atyre gjendjeve që ngjasojnë me gjendjet e të Dërguarit të Allahut (a.s.)?..



Mobilizimi me durim

— Ibrahim Bozbeshparmak —

“Pasha kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.” (Surja Asr)

Muaji i Ramazanit është një muaj durimi. Pra, një muaj në të cilin mësohet durimi... Madje, ai e realizon këtë mësim me gjërat për të cilat njeriu duron më së paku dhe nxiton më së shumti. Pra, e bën me të ngrënët, të pirët, me dëshirat epushore etj. Ai mbart një apel për durim në vetvete për kohën tonë, në të cilën shpejtësia dhe të dhënët krejtësisht pas kënaqësisë po njihen si vlera. Ai u injekton durim zemrave dhe mendjeve.

Ejani dhe të organizojmë një apel për durim në këtë muaj të Ramazanit. Le të shkojmë shtëpi më shtëpi, katedër më katedër dhe konferencë më konferencë!.. Le t'u japim lajmërim radiove, gazetave dhe revistave! Le të shpërndajmë njoftime! Le të nxjerrim lajmëtarë në të katër anët, të cilët mbartin në xhepat e tyre ftesa dhe apele për durim! Në këtë mënyrë, le të fillojë mobilizimi i njerëzve me durim nën prijesin tonë! Kur të pimë çaj në kuvendin e ndonjë miku, tema e bisedës sonë le të jetë durimi! Le të shkojmë në çdo anë dhe t'i ftojme të përvuajturit për të bërë durim dhe t'i përgëzojmë ata që bëjnë durim! Për shembull, le të shpërndajmë broshura të Xhenetit nëpër dhomat e spitalit, përpara hyrjes në reanimacion, në dalje të morgut dhe në çadra të ngushëllimit! Le t'ua kujtojmë të ardhmen e mrekullueshme që i pret ata që bëjnë durim!

Ose të rrimë, ose të veprojmë “me durim”

Le të dalim nëpër male e kodra dhe të kërkojmë që durimi të bie në formë reshjesh në zemrat tona të thata, në zemërimet tona të mëdha, në nervat tona të tensionuara, në padurimin dhe në nxehjen tonë! Le të lutemi si Taluti dhe ushtarët e tij apo si magjistarët që i besuan Musait (a.s.):

“O Zoti ynë! Lësho durim mbi ne! Na forco në fenë tënde! O Zoti ynë! Lësho durim mbi ne dhe na e merr shpirtin si myslimanë!”

Le t'i ndalojmë ata që vrapojnë vazhdimisht duke ua hapur krahët, le t'i kapim për dore dhe t'ua shpjegojmë durimin me të gjithë mundësinë që ka gjuha jonë! Le t'u themi:

“Duroni, o vëllezër!.. Profesioni i profetit ka qenë durimi. Duroni në besimin tuaj! Në kurrizin tuaj nuk do të fishkëllejnë kërbacët dhe lëkura juaj nuk do të rripet me kanxha prej hekuri. Nuk do të priteni me sharrë. Nuk do t'ju bëhen tortura dhe nuk do t'ju derdhen papastërti nga koka deri te këmbët. Rugët nuk do t'ju shtrohen me gjemba. Atëherë, le të mos dalin fjalët nga goja juaj që e kundërshtojnë Zotin dhe rezistoni kundrejt belave e fatkeqësive! Bëni durim kundrejt sëmundjes, dhimbjes dhe vuajtjes suaj! Sëmundjen tuaj konsiderojeni shkallë të Xhenetit. Bëni durim kundrejt vdekjes dhe ngushëllojeni zemrën tuaj duke thënë: “Inna lil-lahi ve inna ilejhi rraixhion / të Allahut jemi dhe te Ai do të kthehemi”. Mendojeni vdekjen një herë si momentin kur do të ngelin mangët gëzimet, argëtimet dhe dëfrimet tuaja! Mendojeni vdekjen një herë si kalim nga kjo botë, të cilës nuk i dihet e nesërmja dhe e cila

i ka ditët e numëruara, për te bota e takimeve ku nuk do të ketë ndarje asnjëherë dhe gëzimet e dëfrimet do të jenë të përhershme! Duro ndaj humbjes së pasurisë, parave, pronave e posteve! Mos u mposhtni lehtë duke e gëzuar shejtanin e mallkuar! Bëni një durim si Jakubi (a.s.) dhe ankesat groposini në zemrën tuaj! Nëse e njihni Zotin (xh.sh.), kjo ju mjafton. Shtrëngojini dhëmbët dhe mos bëni lëshime në besimin tuaj! Bëhuni bashkë me Asijen, As'habu'l-Uhdudi, Nexharin e dashur, me pejgamberët që kanë qenë gurët themelorë të durimit dhe me sahabët e nderuar të të Dërguarit të Allahut (a.s.)!

Ji durimtar në adhurimet e tua, o njeri! Pra, ji i durueshëm në namazin, agjërimin dhe në dhikrin tënd! Dyzet ditë, dyzet muaj, dyzet vjet!.. Bëhu durimtar si dervishët! Ji i përpiktë në durimin tënd si Junusi që për vite me radhë mblodhi dru të drejta për teqenë ngaqë nuk e shikonte të përshtatshme të çonte dru të shtrembra aty! Ji durimtar edhe në lutjen tënde! Mos u zemëro, sepse vonimi i pranimit është që ti të përgjërohesh edhe më shumë. Dije se askush nuk kthehet duarbosh! Andaj ngriji duart lart dhe këmbëngul në lutjen tënde!

Bëj durim në thirrjen për tek Zoti (xh.sh.), o mysliman! Asnjëherë mos e nxirr nga mendja Nuhun (a.s.), i cili i thirri njerëzit në shpëtim duke shkuar derë më derë për një mijë vjet! Kujtoji ata që u përzunë, u përjashtuan dhe u gurëzuan, por që prapë se prapë duruan dhe nuk hoqën dorë! Askush nuk është më pak meritör se Ebu Xhehli për t'i shkuar te dera e shtëpisë dhe për ta ftuar në Islam me këmbëngulje. Prandaj duro me shpresën e Pejgamberit (a.s.), i cili shpesh shkoi te dera e Ebu Xhehlit për ta ftuar në Islam. Mos bjer në pesimizëm qoftë edhe për një çast dhe t'i vendosësh vizë vëllait tënd, por qëndro me këmbëngulje në derën e tij!

Duro në hallall! Edhe nëse je në vështirësi zgjidh atë që është e mirë! Duro kundrejt harameve! Mos të të shkasë syri, mos të të flasë gjuha gjëra që s'duhën dhe mos të të zgjatet dora te gjërat e gabuara! Shkatërroje zemërimin dhe bëhu trim i vërtetë! Hape grushtin dhe ulë dorën!

Duro kundrejt shokut tënd që mendon se e ka tepruar me ty! Zbukuroje jetën sociale me durim, o vëlla! Nëse je drejtor, pronar apo punëdhënës, duro ndaj personelit që bën ndonjë gabim, ndaj atij që e derdh çajin gabimisht dhe ndaj asistentit që harron të trokasë në derë! Nëse je marangoz, duro ndaj dërrasës me nyje! Nëse je hekurpunues, duro ndaj fortësisë së hekurit! Nëse je shitës, bëj durim ndaj klientit! Nëse je bujk, bëj durim ndaj pemës që nuk jep frute! Bëj durim ndaj kafshës që shfaq ndonjë huq! Mos ofendo, mos godit dhe mos i thyej zemrat! Mos e zmadho grumbullin e mëkateve të tua me një zemërim të çastit!

Bëj durim kundrejt fqinjit! Nëse është i sëmurë, duro ndaj rënkimeve të tij! Nëse ka foshnje, duro ndaj të qarave të tij! Nëse je nënë apo baba, duro kundrejt fëmijës tënd me aftësi të kufizuara!

Mos i bërtit, mos e rrih dhe mos ia lëndo zemrën fëmijës së vogël nëse e derdh ushqimin apo nëse bën me bojë divanin!

Nëse je bashkëshort, bëj durim ndaj bashkëshortes dhe mos ia nëpërkëmb të drejtat shoqes së jetës nëse nuk i ka hedhur kripë sa duhet ushqimit të mbrëmjes apo nëse e ka hekurosur me dy vija këmishën!

Bëj durim në trafikun e gjatë që s'di të mbarojë! Mos i bjer vazhdimisht borisë, mos e nxirr kokën jashtë nga dritarja e makinës dhe bëhu si një kala apo një monument me durimin tënd!

Mbylli sytë dhe bëj sikur nuk e pe, mbaje gjuhën e mos fol, përshpejtoji hapat dhe largohu nga aty pa dëgjuar gjë!

Ulu në gjunjë, o njeri dhe duro si gruri që duron nën borën e dimrit të gjatë! Merr mësim nga rrapet qindravjeçarë, nga krimbi i mëndafshit që e thur dalëngadalë fshikëzën e mëndafshit dhe nga foshnja që merr formë dalëngadalë në barkun e nënës! Shiko që çdo gjë bën durim përveç teje! Shiko se çdo gjë bëhet dhe jep fryte me durim!

Mëso të durosh!..

Mëso ta jetosh durimin!..

Përhape durimin!..

Duro, o njeri, sepse Allahu është me ata që durojnë.



*"O Zoti ynë!
Lësho durim mbi
ne! Na forco në fenë
tënde! O Zoti ynë!
Lësho durim mbi ne
dhe na e merr shpirtin
si myslimanë!"*



Robërit e Allahut **DHE CILËSITË E TYRE**

— Ali Riza Temel —

Në të vërtetë, duam apo nuk duam, të gjithë jemi robër të Allahut, i Cili është Mëshirues, Mëshirëbërës. E gjithë çështja është që ta perceptojmë detyrën si robër dhe ta kryejmë atë me dëshirë. Këtë e quajmë zbatim i kësaj detyre me gjithë zemër dhe vetëdije.

Në shumë ajete dhe hadithe fisnike, përmenden cilësitë e robërve të devotshëm të Zotit (xh.sh.). Ndërsa në pjesën e fundit të sures Furkan, këto cilësi përmenden të gjitha së bashku. Në këtë shkrim do t'i shtjellojmë këto cilësi, në mënyrë që si besimtarë ta dimë se sa i mbartim këto dhe të përpiqemi të bëhemi robërit e devotshëm të Allahut Teala sa më shumë të jetë e mundur.

Tani, shkurtimisht le t'u hedhim një sy ajeteve 63-74 të sures Furkan:

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që

ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!” Për shkak se këta robër kanë fituar mëshirën dhe dashurinë e Allahut Teala, përmenden si “Ibadu’rr-Rahman / robërit e të Gjithëmëshirshmit”. Edhe haxhilerëve u thuhet “Dujufu’rr-Rahman / miqtë e të Gjithëmëshirshmit”, sepse edhe ata janë njerëz që e kanë merituar mëshirën dhe dashurinë e Allahut të Lartësuar. Cilësia e parë e robërve të Allahut është se ata ecin me modesti dhe dinjitet nëpër tokë. Ata nuk janë njerëz mendjemëdhenj, mburraveçë, të pasjellshëm, të ashpër dhe të paedukatë, por përkundrazi, ata janë njerëz modestë, të edukuar, të sjellshëm, njerëz që nuk i shqetësojnë të tjerët dhe që fitojnë respekt me sjelljet e tyre të pjekura. Ata shfaqin një shembull karakteri të lartë. Ata janë modestë jo për shkak të dobësisë, por për shkak të dinji-

tetit. Ata shfaqin një sjellje që u ka hije kundrejt njerëzve të paditur e injorantë që i sulmojnë me fjalë. Ata nuk bëjnë zënka për gjëra të kota. Të keqen e largojnë me të mirë.

“...Natën e kalojnë duke iu falur Zotit të tyre në sexhde dhe në këmbë...” Siç sillen ditën me pjekuri kundrejt robërve, edhe natën e kalojnë me ibadet dhe bindje ndaj Zotit (xh.sh.). Në këtë mënyrë, të gjithë kohën e kalojnë me produktivitet.

“Ata thonë: “O Zoti ynë, largoje prej nesh ndëshkimin e Xhehenemit, sepse, me të vërtetë, dënimi i tij është i përjetshëm.” Ata i drejtohen Zotit (xh.sh.), me sexhde dhe kijam. Gjithashtu strehohen te Zoti (xh.sh.) dhe i kërkojnë mbrojtje Atij nga ndëshkimi i Xhehenemit, i cili është i përhershëm dhe i tmerrshëm.

“Kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen të mesmes.” Ekonomi do të thotë të vepron në mënyrë të ekuilibruar. Harxhimi i tepër dhe koprracia janë ifrat dhe tefrit. Islami është feja e ekuilibrit. Edhe myslimani është një njeri që vepron në mënyrë të ekuilibruar në të gjitha punët dhe çështjet e tij. Zoti (xh.sh.), na ka cilësuar si “ummetu’l-vasat / umet i të mesmes”. Edhe pse israfi është teprim në çdo gjë, në përgjithësi prej tij nënkuptohet teprimi në shpenzime. Shpenzimi bëhet për një gjë jetike, apo për një nevojë, apo për ndonjë mirësi. Individët dhe shoqëritë kanë një kufi harxhimi sipas fitimeve të tyre. Ndërsa shpenzimet që nuk bëhen për ndonjë gjë jetike, për ndonjë nevojë apo për ndonjë mirësi, janë shpenzime të padobishme që bëhen jashtë kornizës së ligjshmërisë. Këto shpenzime quhen israf. Allahu Teala nuk i do ata që bëjnë israf. Siç shprehet edhe Kurani Fisnik, “ata që bëjnë israf janë vëllezërit e shejtanit”. (Shik. Surja Isra, 27.) Paratë që shpenzohen për gjëra haram dhe të padobishme, edhe nëse janë pak, konsiderohen israf. Ndërsa paratë që harxhohen për gjëra hallall dhe të dobishme, edhe nëse janë shumë, nuk konsiderohen israf. Për këtë arsye, thuhet: “Nuk ka mirësi në israf dhe nuk ka israf në mirësi.” Edhe i Dërguari i Allahut,

(a.s.), ka thënë: “*Ai që kursen, nuk varfërohet.*” (Përkthimi i Tedrixhit, 4/135.) Besimtari duhet të jetë i kujdesshëm në shpenzimet e tij. Një fjalë e urtë popullore thotë kështu: “Shtriji këmbët sa ke jorganin.” Edhe koprracia, e cila është e kundërta e Israfit, nuk i ka hije besimtarit. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “*Dy cilësi nuk mund të gjenden kurrë te besimtari. Koprracia dhe morali i ulët.*” (Tirmidhi, Birr 41.)

“...Ata nuk adhurojnë zot tjetër përveç Allahut...” Shirku ndaj Allahut është prej mëkateve të pafalshme. Baza e Islamit është tevhidi / njësimi i Allahut në çdo gjë. Çdo gjë është e Allahut Teala. Askush nuk mund të jetë ortak me Atë në gjithçka që ka krijuar. Çdo gjë është e përkohshme. Ndërsa i përhershëm është vetëm Allahu (xh.sh.).

“...Ata nuk vrasin njeri, gjë që e ka ndaluar Allahu, përveçse me të drejtë...” Mëkati më i madh pas kufrit dhe shirkut është vrasja. Siç shprehet edhe Kurani Fisnik, vrasja e një njeriu në mënyrë të padrejtë është si vrasja e të gjithë njerëzve. Vepra më e vlefshme e Zotit (xh.sh.), mëkëmbësi i Tij në tokë dhe esenca e gjithësisë është njeriu.

“...Ata nuk bëjnë imoralitet...” Besimtarët janë të ndershëm. Imoraliteti e degjeneron familjen. Imoraliteti është një paturpësi e hapur. Imoraliteti e shkatërron dinjitetin e njeriut.

“...Ata nuk dëshmojnë në mënyrë të gënjeshtërt dhe kur kalojnë pranë kotësive, kalojnë me dinjitet.” Besimtarët janë dëshmitarët e Allahut për të vërtetën në këtë botë. Besimi dhe gënjeshtria nuk mund të qëndrojnë bashkë. Ndershmëria, të qenët i dobishëm për të tjerët dhe qëndrimi larg gjërave të padobishme janë prej shenjave të besimtarëve. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “*Braktisja e kotësive tregon besimin e individit.*” (Tirmidhi, Zuhd, 11.)

“Kur ata paralajmërohen nga shpalljet e Zotit të tyre, nuk sillen as si të shurdhër, as si të verbër.” Besimtarët veprojnë me ndjeshmëri kundrejt fjalës së Allahut Teala. Ato i dëgjojnë me shumë vëmendje e përkushtim dhe përpiqen t'i kuptojnë urtësitë e tyre. Gjithashtu përpiqen



*Ata nuk janë njerëz
mendjemëdhenj,
mburraveçë, të
pasjellshëm, të ashpër
dhe të paedukatë, por
përkundrazi, ata janë
njerëz modestë, të
edukuar, të sjellshëm...*

të punojnë sipas urdhrave që shprehin ato. Ata nuk e dëgjojnë Kuranin Fisnik sikur të ishte një poezi, por si një mesazh që u është dërguar nga Allahu i Madhëruar. Kurani Fisnik është harta e rrugës dhe projekti i jetës së tyre.

“Ata thonë: O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prehje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!” Kjo është një lutje e rëndësishme, sepse fati më i madh i njeriut është që bashkëshorten dhe fëmijët t’i ketë burim lumturie për të. Bashkëshortja dhe fëmijët e mirë bëhen shkak për përhapjen e mirësisë. Edhe të Dërguarit të Allahut (a.s.), tri gjëra i ishin bërë të dashura nga kjo botë. Njëra prej këtyre ishte bashkëshortja e devotshme. Fëmijët e edukuar mirë janë garancia e të ardhmes. Fëmijët e mirë, siç janë burim gëzimi e lumturie në këtë botë për prindërit e tyre, janë edhe shkak që këta prindër të kujtohen me mirësi dhe lutje.

Njëra prej veprave më të mëdha të besimtarit është që të bëhet prijës dhe shembull për të mirët. Fjala “imam” që përmendet në ajetin fisnik do të thotë “prijës”. Qëllimi i myslimanit nuk është vetëm të bëhet i devotshëm, por në të njëjtën kohë, të bëhet edhe prijës i të devotshmëve. Sa dëshirë dhe shpresë e bukur që është kjo. Prijësia është një mision që Allahu (xh.sh.), ia ka dhënë besimtarit. Për fat të keq, myslimanët e sotshëm janë larg nga ky mision. Ndërkohë Allahu Teala thotë: **“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju...”** (Bakara, 143) Njerëzimi pret që ky umet të vijë në vete, ta kujtojë misionin e tij dhe të bëhet udhërrëfyes, sepse nuk ka asnjë shoqëri tjetër që mund ta marrë përsipër këtë mision.

Këto cilësi që u përkasin robërve të devotshëm të Allahut Teala, fitohen me mund dhe përpjekje. Ndërsa ata që i fitojnë këto cilësi, do të jenë fatlumë edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër. Ata do të jenë njerëz prijës në këtë botë dhe të nderuar në Ahiret. Allahu i Lartësuar jep këtë sihariq për këto cilësi që fitohen me durim: **“Nje-**

rëz të tillë do të shpërblehen me Xhenet të lartë për durimin e tyre dhe do të mirëpreiten e do të gjejnë paqe.” (Furkan, 75)

Në lidhje me cilësitë e besimtarëve të vërtetë, në Kuranin Fisnik dhe hadithet e të Dërguarit të Allahut (a.s.), janë përmendur edhe cilësi të tjera. Urdhërimi për të mirë, ndalimi nga e keqja, lufta në rrugën e Zotit, dhënia e lëmoshës, mbajtja e amanetit, mbajtja e fjalës, pajtimi i të tjerëve, largimi nga të gjitha haramet, pendimi te Zoti, sjellja me drejtësi, kalimi mirë me të tjerët, etj. Mbartja e të gjitha këtyre cilësive të bukura që u përmenden dhe qëndrimi larg nga cilësitë e këqija, krahas se është ideale, është e pamundur realisht, sepse njeriu nuk është engjell. Njeriu sprovohet me nefsën, shejtanin dhe me ndjenjat

e mira e të këqija. Kjo sprovë nuk është e lehtë. Këtu është e mundur edhe ta fitosh këtë sprovë dhe të bëhesh prej robërve të devotshëm të Zotit (xh.sh), edhe ta humbasësh dhe të bëhesh prej robërve të shejtanit. Për këtë arsye, thuhet: “Xheneti nuk është i lirë. Edhe Xhehenemi nuk është i padobishëm.”

Në këtë botë, e cila është si mejdani i luftës ndërmjet të mirës e të keqes, ndërmjet të mirëve e të këqijve, çdokush është i detyruar ta përcaktojë rreshtin e tij. Sigurisht që do të ketë mangësi dhe gabime. E rëndësishme është që, siç e shprehëm edhe në fillim, të zgjedhim adhurimin ndaj Rrah-

manit me zemër e vetëdije dhe të përpiqemi për t’u bërë prej robërve të devotshëm të Tij. Shenjat për të qenë rob i Allahut Teala apo i shejtanit të mallkuar janë të caktuara.

Së fundi, le t’ia vëmë veshin këtij paralajmërimi të Allahut të Madhëruar: **“Vallë, a nuk ju kam urdhëruar, o bijtë e Ademit, që të mos e adhuroni djallin, se ai është vërtet armik i hapët i juaji, por të më adhuroni vetëm Mua?! Kjo është rruga e drejtë.”** (Jasin, 60-61) Allahu i Lartësuar na bëftë të gjithëve robër të devotshëm ndaj Tij në kuptim të vërtetë dhe umet i denjë ndaj të Dashurit të Tij! Amin!



“Vallë, a nuk ju kam urdhëruar, o bijtë e Ademit, që të mos e adhuroni djallin, se ai është vërtet armik i hapët i juaji, por të më adhuroni vetëm Mua?! Kjo është rruga e drejtë.”

(Jasin, 60-61)

INVESTIMI I VËRTETË

— Nuredin Jëlldëz —

Nuk e dimë saktësisht se sa njerëz kanë jetuar në të kaluarën. Ndërsa sot kemi arritur miliarda. Numri ynë vazhdimisht do të rritet deri në momentin e fundit.

Pastaj, duke filluar që nga njeriu i parë e deri te njeriu i fundit, të gjithë do të mblidhemi në një vend. Aty do të jetë vendi i tubimit. Aty do të ringjallemi dhe do të mblidhemi. Aty do të jetë vendi i grumbullimit për të gjithë. Nga aty do të dalim në audiencën e Atij që na ka krijuar.

Ne po shkojmë drejt atij vendi ku do të mblidhemi. I gjithë njerëzimi, burra e gra, do të gjenden aty. Ky është një rregull i vlefshëm në të njëjtën mënyrë edhe për të mirët, edhe për të këqijtë. Ne e besojmë këtë si një e vërtetë e padiskutueshme.

Në ditën e tubimit do të dalim në audiencën e Allahut Teala, i Cili na ka krijuar si njerëz dhe na e ka mundësuar të ekzistojmë në jetën e kësaj bote. Një nga një do të dalim në audiencën e Zotit (xh. sh.) dhe do të përballemi me çdo detaj të jetës sonë. Të mirët dhe të këqijtë, të bardhët dhe të zinjët, burrat dhe gratë, të udhëhequrit dhe udhëheqësit, të pasurit dhe të varfrit... Të gjithë njerëzit do të nxirren në audiencën e Allahut Teala. Aty do të jetë një vend në të cilin do të heshtin gjuhët dhe do të flasin organet e tjera. Do të flasin duart, do të flasin këmbët, do të flasin sytë...

E vërteta që na bën të mendojmë për atë ditë që tani, është fakti se aty do të gjendemi vetëm. Ata që sot i duam, që shpresojmë prej tyre dhe që u besojmë, aty nuk do të gjenden pranë nesh për të na mbështetur. Aty do të jemi ballë për ballë dhe vetëm më atë që do të na marrë në llogari. Do të na bëhen pyetjet dhe do të përgjigjemi. Kjo është e vërteta e madhe. Logjika e jetës është e bazuar në këtë. Kjo është një e vërtetë prej të cilës nuk mund të shpëtojmë duke harruar apo duke e hedhur pas shpine. Do të jemi të vetëm dhe ballë për ballë me Atë që do të na marrë në llogari. Gjithashtu do të jemi ballë për ballë me të gjithë jetën tonë dhe të gjitha veprat që kemi bërë.

Të jesh besimtar mbi këtë tokë do të thotë të jesh tosh duke e njohur dhe perceptuar atë ditë. Ky është ndryshimi ndërmjet nesh dhe kafshëve. Gjithashtu, ky është ndryshimi ndërmjet nesh dhe atyre që janë më kafshë se kafshët. Kur ta harrojmë se atë ditë do të jemi të vetëm, do ta humbasim edhe kodin e ekzistencës sonë.

Vetëm njohja e kësaj të vërtete nuk do të jetë e mjaftueshme. Dije e vërtetë është dija me të cilën punohet. Siç nuk mund ta ndalojë djegien dija se Xhehenemi është djegës, edhe dija se do të merremi në llogari një nga një nuk do të na shpëtojë dot nga llogaria.

Nëse të gjitha gjërat që duhet t'i bëjmë në këtë botë do t'i bëjmë duke pasur parasysh atë ditë, atëherë do të thotë se kemi bërë investimin më të mirë për atë ditë. Kur bëjmë një punë për njerëzimin, në të vërtetë kemi bërë një investim për veten tonë. Nëse ndihmojmë një të varfër, në fakt kemi ndihmuar veten tonë. Nëse ndihmojmë ndonjë të sëmur, në fakt kemi ndihmuar veten tonë. Edhe nëse jemi të vetëm, në të vërtetë nuk jemi një person, por një pjesë e umetit. Fakti që ne gjendemi aty, është investim për umetin tonë. Meqë umeti është umeti ynë, atëherë edhe investimi për të është investim për veten tonë. Ne kështu duhet të mendojmë dhe kështu duhet të jetojmë.

Dy gabime të kundërta me njëra-tjetrën si nënçmimi i vetes dhe të shpresuarit nga të tjerët, janë të papranueshme për ne. Nëse është gjallërimi i umetit ai që pritet, atëherë mund të mendojmë: "Unë jam ai që duhet të përpiqem për këtë gjallërim. Ngaqë jam një pjesë e umetit, do të thotë se umeti po gjallërohet." Ne duhet t'i shohim gabimet tona. Gjithashtu, duhet të bëjmë një plan që të na përgatisë për atë ditë. Besimi ndaj Ahiretit e bën të detyrueshme këtë. Ky është rezultati i singëritetit në fe. Zgjuarsia kundrejt dredhive të ndryshme të shejtanit mund të arrihet me një kuptim dhe praktikë të tillë. Ndërsa e kundërta, do të ishte fjalë shumë e punë pak.





KOXHA SINAN PASHA

KRYEMINISTËR I PESËFISHTË I PERANDORISË OSMANE
DHE THEMELUESI I LOBIT SHQIPTAR NË OBORRIN E SULLTANËVE

— Dr. Ardian Muhaj —

Koxha Sinan Pasha apo Sinan Pashë Topojani, i biri i Ali Begut është lindur në vitin 1506 në Topojan të Lumës dhe ka vdekur më 3 prill 1596. Ka qenë një nga kryeministrat më të rëndësishëm dhe që kanë lënë më shumë gjurmë në politikën e shtetit osman, por njëkohësisht edhe një nga burrështetasit me rëndësi botërore që ka lënë gjurmë të pashlyeshme dhe që ka ndikuar shumë edhe për historinë e trojeve shqiptare dhe të shqiptarëve si popull. Është për t'u theksuar se Sinan Pasha ashtu si edhe shqiptarët e tjerë që kishin mbërritur majat më të larta të pushtetit në Ballkan dhe në Mesdhe, nuk jetonin të izoluar nga mjedisi shqiptar prej nga vinin, por përkundrazi, në një kontakt të vazhdueshëm e të pandarë me njerëzit e vendin e tyre. Madje është dëshmuar se këta shqiptarë që kishin marrë në dorë drejtimin e perandorisë më të madhe të kohës, anonin në zgjedhjet e tyre politike jo vetëm

nga vendlindja, por edhe nga komshinjtë, siç është rasti i venedikasve.¹ As madhështia e jetës së tyre në kryeqytetin e zhurmshtëm të perandorisë, as atmosfera e ndryshme e jetës aty nuk ua dobësonte dashurinë dhe lidhjen me vendlindjen.

1. Natyrisht miqësinë dhe marrdhëniet e mira me Venedikun këta shqiptarë të fuqishëm e konceptonin nga një pozitë e qartë superioriteti siç e dëshmon edhe ky dokument në të cilin Koxha Sinan Pasha njofton Dohën e Venedikut Paskuale Cicogna mbi rezultatet e arritura prej tij në fushatën e Hungarisë kundër Habsburgëve dhe njëkohësisht duke e paralajmëruar që të mos ndërmarë veprime armiqësore në det përndryshe do të ndëshkohet rëndë: "Sinan pascià al doge [Pasquale Cicogna]. Il pascià esorta il doge a osservare i patti ammonendolo con l'esempio del "re di Vienna" che ha scontato la sua caparbieta perdendo {Yanik}, Papa, Tata, Veszprém, Palota, Szent Márton, Tihany, {«C[e]ſ[e]dk», Vasvár}. Il pascià afferma che se il doge persisterà nella sua ostilità sarà ancora più gravemente punito." I "documenti turchi" dell' Archivio di Stato di Venezia: inventario della miscellanea. A cura di Maria Pia Pedani Fabris, Venezia, Ministero per i Beni Culturali e Ambientali, 1994, dok. nr. 1076, dhjetëditëshi i parë i Rebijulevvel 1003 (14-23 nëntor 1594).

Studiues të ndryshëm kanë supozuar se Sinan Pasha kishte dalë nga radhët e fëmijëve të devshirmesë, por kjo hidhet poshtë nga dokumentacioni i bollshëm i kohës. Fakti që Sinan Pasha të atin e kish-te mysliman dëshmon se ai nuk ishte kontingjent i devshirmesë. Nga faktet që argumentojnë qartazi se ai ishte edukuar në vendlindje, pranë gjirit të familjes janë dokumentet e ambasadorëve venecianë në Stamboll, të cilët pohojnë me habi se Sinan Pasha edhe kur ishte bërë kryeministër i shtetit osman e fliste me shumë vështirësi turqishten.² Kjo është më se e kuptueshme edhe pse duket e habitshme. Pikësëpari Sinan Pasha ishte rritur e edukuar në Shqipëri dhe më pas karrierën e tij ushtarake përpara se të bëhej kryeministër në dekadën e fundit të jetës, e kishte zhvilluar në flotën e Mesdheut, si kryeadmiral apo kapudan Pasha (Kapdeni derja) dhe si guvernator në provincat arabishtfolëse të shtetit osman, konkretisht në Egjipt, Jemen, Siri, Tunizi.

Sinan Pasha gjatë karrierës së tij të jashtëzakonshme ka mbajtur funksione të larta në shtetin osman. Në vitin 1569 u emërua guvernator i Egjiptit prej ku ndërmoi me shumë sukses vendosjen e sundimit osman në Jemen. Pas Jemenit të cilin e mori dhe e inkadroi në shtetin Osman u kthye drejt perëndimit dhe më 1574 udhëhoqi me sukses fushatën për marrjen e Tunizit të cilin e mbanin spanjollët. Pak vite më vonë u rikthye drejt lindjes ku më 1580 udhëhoqi ushtrinë osmane kundër safavidëve të Persisë në kuadër të luftës osmano-safavide të viteve 1578-1590. Meritat e tij bënë që të emërohej kryeministër nga Sulltan Murati III. Një vit më vonë për shkak të dështimit të zëvendësit të tij Mehmed Pasha në fushatën e Gjeorgjisë u caktua guvernator i Damaskut. Më 1589 për të qetësuar revoltën e madhe të jeniçerëve u caktua kryeministër për herë të dytë. Gjatë kësaj periudhe ai u përpoq të ndikojë në politikën rumune në kuadër të rivalitetit për fronin e principatës së Vllahisë mes Mihnea Turcitul dhe Petru Cercel, duke ia dalë me sukses që të vendosë në postet kyçe në shtetin vasal të Vllahisë bashkëpunorët e tij të ngushtë nga familja Bruti me origjinë nga Ulqini. Nga kjo familje, përveç Bartolomeos i cili në sajë të dashamirësisë dhe mbështetjes që kishte nga shqiptari Sinan Pasha, kryeministër i Perandorisë, arriti të bëhej ministër i parë i principatës së Moldavisë edhe të tjerë anëtarë arrijnë që të përfitojnë nga mbështetja e lobit shqiptar në oborrin perandorak osman duke zënë poste të larta në provincat e principatat e krishtera ballkanike që ishin vasale të Portës së Lartë. Personazhe të tjera të rëndësishme të kësaj familjeje në Moldavi, përmenden edhe Kristoforo, Xhakomo, Bernardo

2. Sinan Pasha përshkruhet, më 1590 nga bajliu Lorenzo Bernardo duke thënë se “nuk dinte as të lexonte turqisht” (*si che vien detto, che non sappia legger turco*). E. Albèri, *Relazioni degli Ambasciatori veneti al Senato*, serie III, vol. 2, Firenze, 1844, f. 353.

e Benedeto Bruti. Ky i fundit kishte arritur që në sajë të mbështetjes nga Sinan Pasha të ketë fuqi të tillë në këtë principatë sa që më 1593 të synojë të rivendosë në fronin moldav, Petru Cercel.³

Një revoltë tjetër e jeniçerëve solli shkarkimin e tij nga posti i sadrazamit por pa kaluar shumë më 1593 erdhi në atë post për herë të tretë. Menjëherë udhëhoqi ushtrinë osmane në luftën me Habsburgët ku megjithë vështirësitë e frontit dhe sukseset e vazhdueshme të tij u shkarkua sërish në shkurt të vitit 1595, si pasojë e ardhjes në fron të sulltanit të ri Mehmetit III. Por nuk vonoi dhe Sulltani i ri e thirri sërish në ndihmë dhe e emëroi për herë të katërt sadrazam apo kryeministër të shtetit më të fuqishëm të kohës. Periudha nga emërimi i tij e deri tek shkarkimi në nëntor të po atij viti ishte e mbushur me përballje ushtarake principatën e Vllahisë, kundër uzurpatorit Mihal. Mirëpo, vetëm tre ditë mbas shkarkimit, u emërua sërish për të pestën herë si sadrazam, detyrë të cilën e mbajti deri sa vdiq në 3 prill të vitit 1596. Përveç pasurisë së madhe (e vlerësuar në rreth 500 mijë dukate ari) dhe veprave të shumta të bamirësisë, la pas edhe një sërë arritjesh e veprash që ndikuan për shumë kohë në historinë e shek. XVII osman dhe në historinë e popullit shqiptar për shekujt në vazhdim. Përveç shumë veprave të bamirësisë në Stamboll ka lënë edhe kompleksin e xhamisë që mban emrin e tij në Damask si edhe një sërë veprash bamirësie me rëndësi në trojet shqiptare me të cilat mbajti lidhje gjatë gjithë jetës pavarësisht karrierës së tij të lavdishme dhe rolit të tij të spikatur në historinë botërore. Shquhet në këtë aspekt kompleksi i xhamisë që mban emrin e tij në Kaçanik. Qytetit i Kaçanikut ia detyron themelimin e vet, pikërisht vakëfit të lënë nga vetë Koxha Sinan Pasha në vitin 1594, ku përveç xhamisë, ka lënë vakëf edhe një pazar, shkollë për mësim-besim, dhe për shërbime përkatëse mirëmbajtëse. Vakëfnameja e lënë nga i biri Mehmet Pashë Kaçaniku më 1608 është një nga dokumentet më të rëndësishëm dhe më të hershëm osmanisht në Arkivin e Kosovës. Në këtë vakëfname i biri shkruan se po lë në vakëf krejt pasurinë e trashëguar nga im atë Sinan Pasha në Topojan së bashku me një xhami (mesxhid). Po ashtu në Prishtinë ka ndërtuar dhe lënë vakëf një kompleks hamami, ndërsa në Shkup dhjetra dyqane. Nga ana tjetër ai la vakëfe dhe vepra bamirësie edhe në qytetet bregdetare si Vlorë e Delvinë dhe Ulqin, me të cilat i mbante lidhjet gjatë kohës që ishte

3. Drejtuesit kryesorë të politikës polake, duke dëshiruar që t'i jepnin fund gjendjes së luftës ndërmjet mbretërisë dhe Perandorisë Osmane, gjendje e shkaktuar si pasojë fushatave të vazhdueshme të kozakëve kërkojnë ndërmjetësimin e Brutit. A. Pippidi pohon lidhur me këtë rast: “N’etaut-il pas naturel qu’ils pensassent a Bruti don’t chacun savait le credit aupres de Sinan”. Andrei Pippidi, *Hommes et idées du Sud-est européen à l’aube de l’âge moderne*, Bukuresht : Editura Academiei Republicii Socialiste România, 1980, f. 141.

admiral i flotës osmane në Mesdhe.⁴ Themelimi i Kaçanikut dhe vakëfet që Koxha Sinan Pasha la në dobi publike në qytetet shqiptare janë pothuajse të gjitha të lidhura me vitin 1594. Kjo sepse në këtë vit Sinan Pasha tashmë kryeministër i shtetit më të fuqishëm të kohës rikthehet në vendlindje, mbas shumë vitesh të kaluara në flotën e Mesdheut dhe në Lindjen e Mesme. Është pikërisht zëvendësi i tij, edhe ai shqiptar dhe mik i tij, Ferhat Pasha që përshkruan fushatën e Sinan Pashës atë vit dhe njëkohësisht që vërteton se veprat bamirëse të lëna si vakëf nga Sinan Pasha, ishin lënë pikërisht gjatë kohës që ai vetë ndodhej në trojet shqiptare. Po në këtë rast shqiptari i madh Sinan Pasha ndërmerr një akt të qartë proshqiptar, me pasoja afatgjata për historinë e shqiptarëve në Kosovë, duke suprimuar patriarkën e Pejës të rithemeluar nga rivali i tij Mehmet Sokoloviç dhe madje shkon më tej duke zhbërë edhe simbolikën e asaj patriarkane sllavizuese të shqiptarëve, duke i hedhur reliket e Shën Savës në Danub.⁵

Këta sundimtarë të mëdhenj të shtetit osman jo vetëm mbanin lidhjet me familjet e tyre, por ishin treguar vazhdimisht si mbështetësit dhe bamirësit më të mëdhenj të shqiptarëve që mbërrinin në kryeqytetin osman, pavarësisht fesë. Këtë e ilustron më së miri ndihma e madhe që Sinan Pasha i dha gjatë gjithë jetës vëllezërve Bruti me origjinë nga Ulqini.⁶ Bartolomeu, njëri nga vëllezërit Bruti për shkak të intrigave të një rivali të tij në Konstantinopojë, Giovanni Marigliano, u burgos në korrik 1579.

4. Hasan Kaleshi, *Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na ara - skom jeziku*, Prishtinë 1972.

5. Constantinopoli. Ferhad pascià al doge [Pasquale Cicogna] e alla Signoria. Il gran visir Sinan conquistò Veszprém e Palota con pochi soldati della guardia senza attendere gli aiuti dei beylerbeyi e sangiacchi di Anatolia, Caramania, Aleppo, Marash e Sivas, destinati a quella campagna di guerra intrapresa per atti di ostilità del "re di Vienna" ai confini di Bosnia; egli fornì quelle due fortezze di presidi, munizioni e viveri e tomò poi a Belgrado. Approfittando però del fatto che le truppe ottomane si trovavano a svemare, il nemico si impadronì di alcune località nei dintorni di Füleke e radunò truppe presso Yanik, ricevendo soccorsi in uomini e denaro dai re di Polonia, Spagna e Inghilterra e dal duca di Firenze... Sono giunte le lettere inviate dalla Signoria al sultano e allo scrivente, nelle quali si conferma la leale amicizia della Repubblica. Essa mentenne effettivamente sempre buoni rapporti con la Porta che, da parte sua, non fece mai nulla che potesse turbarli e protestasse sempre i veneziani. Il pascià avverte la Signoria che se quei preparativi furono provocati da sospetti per armamenti turchi, questi in realtà non sono diretti contro di lei, a meno che non compia atti ostili... Lo scrivente chiede quindi spiegazioni sul perché Venezia si armi, così da poter fornire chiarimenti al sultano. Il pascià, sollecito nei riguardi della felicità dei sudditi e degli amici del sultano e amante della pace, si è sempre adoperato a favore di Venezia e ciò continuerà a fare sinché quella sarà fedele nell'amicizia. Sollecita intanto una pronta risposta. "I "documenti turchi" dell' Archivio di Stato di Venezia, op. cit., dok. nr. 1056. 3 rexeheb 1002/ 21 prill 1594.

6. "Entre ces renegats douse et ambitieux et leurs freres de race convectis, eux, au catholicisme, le contact demeurait facile, immediate, parfois amical. Attestees par nombreux temoignages contemporains, les relations intimes de l'Albanais Sinan-pacha avec les Bruti, originaires de Dulcigno mais pourvus d'un titre de noblesse venitien, permettront d'imaginer un lien de parente entre eux"; Andrei Pippidi, *Hommes et idées du Sud-est européen à l'aube de l'âge moderne*, op.cit., f. 135-136.

Ndëshkimi i tij pritej të ishte varja ose të dërgohej në galera si remëtar, por ndërhyrja dashamirëse e Sinan Pashës e shpëton. Ndërkohë që Sokoloviç tashmë e kishte denoncuar me akuza false tek Sulltani dhe pritej varja e Brutit, Sinan Pasha hartoi me shpejtësi një 'arz për Sulltanin duke sqaruar se Sokoli po përpiquej ta ndëshkonte Brutin sepse ai vetë ishte i përfshirë në politikë përçarëse. Ndërkohë në Stamboll ekuilibrat e pushtetit kishin ndryshuar në favour të lobit shqiptar të kryesuar nga Sinan Pasha. Lobi sllav ishte shkërmoqur me vrasjen e Mehmet Sokolit më 11 tetor 1579 dhe sapo mori vesh për arrestimin e Brutit, e motra e Sinan Pashës, një rast i rrallë por i rëndësishëm ky i pushtetit të një gruaje, kishte dërguar urgjent 25 njerëz besnikë të saj drejt Lezhës për ta liruar Brutin dhe për ta kthyer në Stamboll. Jo vetëm kaq, por Bruti i sigurtë për mbështetjen e mëtejshme të bashkëatdhetarit të tij, sa që ofrohet si ndërmjetës tek Sinan Pasha për çështje të ndryshme.⁷ Kështu anëtarët familjes Bruti, arrijnë që të kapin majat e lavdisë pikërisht në sajë të bashkëpunimit të ngushtë me shqiptarët me influencë në oborrin osman, qoftë në rolin e tyre si dragomanë (nga arabishtja: terxhiman) ashtu edhe si ndërmjetës të privilegjuar në lidhjet mes vendeve evropiane dhe perandorisë osmane.⁸

Duke folur për sulmin osman kundër Korfuzit më 1537, kronisti venecian, L. Soranzo, thotë se inspirues i atij aksioni u bë Sinani, një shqiptar nga fshati Topoian i sanxhakut të Prizrenit.⁹ Sipas Antonio Tiepolo-s, bajli në Kostandinopojë që e njohu mirë personalisht "Veziri i Madh Sinan Pasha, ishte me kombësi shqiptare dhe kishte lindur në një fshat dy ditë larg Shkodrës. Ishte trupmadh, me një vështrim të egër që nuk dinte të zbutej kurrë. Bënte plane madhështore, që kapërcenin çdo masë. Si ushtarak, dallohej për një guxim të çartur e të papërmbajtur (*soldato temerario e impetuoso*). Më 1590 bajliu Lorenzo Bernardo po ashtu thotë se Sinan Pasha "e qeveris sot Perandorinë Osmane, i ndihmuar nga fati dhe nga gruaje e Sulltanit, e cila është shqiptare si ai".¹⁰

7. "Bruti si offerse loro di trattare con Sinan Bassa questa pratica". Al. Cioranescu, *Documente privitoare la istoria românilor culese din arhivele din Simancas*, Bukuresht, 1940, f. 76.

8. Historia e lidhjeve që Bruti kishte në politikën evropiane të kohës dhe që e gjenin mbështetjen tek Sinan Pasha dhe shqiptarët në oborrin e Stambollit përshkruhet nga Noel Malcolm, *Agents of Empire: Knights, Corsairs, Jesuits and Spies in the Sixteenth Century Mediterranean World*, Oxford: Oxford University Press, 2015.

9. "Sinan"Albanese da Topoiano villa del Sangiaccato di Preseremo" L. Soranzo, *L'Ottomano*, della potenza del presente Signor de'Turchi Mehemetto III, Napoli, bot. C. Vitale, 1600, parte seconda, LVI, f. 87; *Dokumente*, përg. Injac Zamputi, vëllimi II, Tiranë, 1990, f. 228.

10. *Da un tal uomo è governato l'imperio del Turco, fomentato e sostnuto dalla sua buona fortuna e dal favore della moglie del Gran Signore, per esser ancor ella Albanese*", E. Albèri, *Le relazioni degli Ambasciatori veneti al Senato*, serie III, vol. 2, Firenze, Società Editrice Fiorentina, 1844, f. 241.



Sulltani i Belhit, Ibrahim ibn Et'hemi, mbledhi në saraj vezirët, dijetarët, komandantët dhe njerëz të popullit. Të gjithë ishin prezentë. Në një moment, dikush filloi të fliste nga kallaballëku. Me çdo fjalë të tij ia shponte zemrën sulltanit. Ibrahim ibn Et'hemi e pyeti:

-Kush je ti? Nuk po më bie në sy për mirë.

-Unë jam një njeri pa punë, i dobët, pa shtëpi dhe pa katandi. Buaj në çdo vend ku të rastis. Tani kam ardhur të bëhem mysafiri yt.

Ibrahim ibn Et'hemi u nxeh dhe i tha atij se ai vend nga ku udhëhiqte nuk ishte një han apo konak. Burri tha:

-A nuk është han ky vend?

-Ky vend është saraji i Ibrahim ibn Et'hemit...

-Kush ka qenë para teje këtu?

-Babai im...

-Po para tij?

-Babai i babait tim...

-Çfarë mund të jetë tjetër përveçse han një vend ku vjen dhe ikën dikush?

Ibrahim ibn Et'hemi ngeli i ngrirë.

Njeriu duhet ta konsiderojë këtë botë si një vend nëpër të cilin kalon. Shtëpinë dhe përgatitjet duhet t'i bëjë për vendin ku do të qëndrojë përgjithmonë. Njeriu më i çmendur i kësaj bote është ai i cili i lë në rrugë gjërat që i janë dhënë dhe nuk i shpie në vendin ku do të shkojë...

NJË THËNIE

*"Jeta më kaloj, sa keq që u zgjova vonë,
Pandeja se kjo botë do të ishte e imja përgjithmonë."*

(Junus Emre)

NJË LUTJE

"O Allah që ke krijuar qiejt dhe tokën, që e di të dukshmen dhe të padukshmen, që je Zoti dhe Poseduesi i çdo gjëje! Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Teje. Të kërkoj mbrojtje nga e keqja e nefsit, nga e keqja e shejtanit dhe nga shirkul!"

(Darimi, Isti'zan, 54.)

FAKTE INTERESANTE

- Njeriu me trupin më të gjatë ka qenë amerikan R. P. Wadlow 2.72 metra që ka vdekur në vitin 1940.
- Një copë floriri në madhësinë e një kutie shkrepëseje mund të zgjatet pa u këputur sa një fushë tenisi duke u hapur si një juftë.
- Mushkonjat kanë 47 dhëmbë.



Të ngrënë dhe të pirë sipas rregullave të Islamit

— Xhafer Durmush —


I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë: “Allahu Teala është i pastër dhe i do vetëm ata që janë të pastër. Urdhrat e Allahut nuk i drejtohen vetëm profetëve por çdo besimtarit. Allahu i Madhëruar u ka thënë pejgamberëve: **“O pejgamberë! Hani prej gjërave që janë të pastra e hallall dhe bëni vepra të mira e të dobishme!”** (Mu'minin, 51) Edhe besimtarët i ka urdhëruar: **“O ju që keni besuar! Hani nga ushqimet e lejuara që ju kemi dhënë!..”** (Bekare, 172) Pastaj, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha: **“Dikush udhëton gjatë në rrugë të Allahut. Flokët i ka të parregullta dhe vetë është i bërë gjithë pluhur. Në atë gjendje i ngre duart dhe lutet: “O Zot! O Zot!” Ndërkohë, ajo që ha është haram, ajo që pi është haram dhe i gjithë ushqimi i tij është haram. Si të pranohet lutja e një njeriu të tillë?”** (Muslim, Zekat, 65) Në këtë mënyrë, është shprehur qartë se u jepet vlerë njerëzve që janë të pastër si nga jashtë ashtu edhe nga brenda. Gjithashtu shpjegohet se nuk kanë ndonjë vlerë mirësitë të cilat i bëjnë njerëzit që nuk janë të pastër së brendshmi dhe së jashtmi.

Këto ajete shpjegohen siç vijon në tefsir: “O ju që keni besuar! Mos u bëni si kafshët! Hani prej gjërave të pastra fizikisht dhe shpirtërisht! Sepse ato që ju kemi dhënë, përmbajnë edhe hallall, edhe haram, janë edhe të pastra edhe të ndyta. Kështu që ju hani prej atyre që janë të pastra, që janë fituar në mënyrë të ligjshme pa i hyrë në hak ndokujt dhe që janë hallall. Pastaj falënderojeni Allahun Teala! Organet e jashtme dhe të

brendshme të trupit tuaj që ushqehen me risk hallall dhe të pastër, përdorini në punë të ligjshme për të cilat janë krijuar, sepse e vërteta e falënderimit është përdorimi i mirësive për qëllime prej të cilave është i kënaqur dhënësi i tyre (Zoti). Ndërsa të vepruarit në formë të kundërt është mosmirënjohje ndaj mirësive.”

Këtu ka dy çështje që bien në sy. E para: Urdhri për “kërkimin e riskut të pastër dhe hallall” nuk ka ardhur i lidhur me ndonjë kusht. Për këtë arsye, ai duhet të kërkohet në të gjitha kohët, kushtet dhe rrethanat. Pra, kur fitojmë, kur harxhojmë dhe kur hamë e pimë... E dyta: Ky urdhër në ajetin e parë është dhënë si kusht për të bërë punë të dobishme. Ndërsa në ajetin e dytë si domosdoshmëri për falënderimin ndaj Allahut (xh.sh.). Në një ajet tjetër fisnik, “kërkimi i riskut hallall” u është urdhëruar të gjithë njerëzve dhe menjëherë pas tij ka ardhur paralajmërimi: **“Mos shkoni pas shejtanit, sepse ai është armiku juaj i qartë.”** (Bekare, 168-169)

Nga këto kuptojmë se njeriu duhet të bëjë kujdes veçanërisht për hallallin dhe pastërtinë e atyre që ha dhe pi, sepse kjo do të thotë mbyllje e shtigjeve të rrugëve të shejtanit. E kundërta e kësaj do të ishte lehtësim i shtigjeve të rrugëve të shejtanit. Për këtë arsye, të afron me batakun e mëkatit dhe gjynahut. Gjithashtu, me kalimin e kohës, mundëson ngjasimin me ata që nuk bëjnë kujdes ndaj hallallit e haramit dhe me ata që e mohojnë Zotin (xh.xh.). Për këtë gjendje të atyre, në ajetin fisnik thuhet: **“...Ndërsa ata që nuk besojnë dhe**



kënaqen e hanë ashtu siç gëlltisnin bagëtia, do të kenë Zjarrin si vendbanim!” (Muhammed, 12)

Fjala “tajjibat”, që përmendet në ajete do të thotë “gjëra që i pëlqen natyrshmëria njerëzore, që janë konsideruar të lejuara nga feja dhe që në të vërtetë janë të pastra”. Nisur nga kjo, nuk ka asnjë problem për të përfituar nga mirësitë e ndryshme, por është thënë se edhe nga tajjibatët duhet të përfitojmë me maturi, në mënyrë që të mos na bien gradat shpirtërore dhe të mos meritojmë kërcënimin e Allahut Teala i cili thotë: **“...Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore dhe jeni kënaqur me to, ndërsa sot do të ndëshkoheni me dënim poshtërues...”**¹


Nisur nga këto që thamë më lart, çështjet ndaj të cilave duhet të kemi kujdes mund t’i përmbledhim në këtë mënyrë: Veprimi me përpikëri në çështjen e kërkimit të riskut nga hallalli, shfaqja e kujdesit që ai të jetë i pastër fizikisht dhe shpirtërisht, qëndrimi larg gjërave të dyshimta duke u shqetësuar nga rënia në haram dhe marrja parasysh e këshillave të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në lidhje me praktikën e tij në këtë çështje. Ndër të tjera mund të shtojmë edhe këto: Të mos ulemi në tryezën e ngrënies para se të na marrë mirë uria, të mos e mbushim stomakun më tepër seç duhet, të mos bëjmë israf dhe të mos shfaqim koprraci, t’i respektojmë mirësitë me vetëdijen se Allahu është Ai që i ka dhënë, t’i respektojmë rregullat e tryezës së ngrënies dhe t’i kujtojmë fukarenjtë... Për shembull, muajin e Ramazanit në të cilin marrim edukimin e durimit duke bërë ndryshime radikale në vaktet e ngrënies, mund ta përdorim si një mundësi për t’u mjaftuar me rrobat që kemi dhe për ta bërë zakon largimin nga gjërat e dyshimta.

Sipas bindjes sonë, fakti që në

ajetin fisnik i cili na njofton për mirësinë e agjërimit thuhet: **“...Në mënyrë që të mund të ruheni nga të këqijat...”**, është shumë i rëndësishëm. Domethënë që hapi i parë për t’u larguar nga mëkatet hidhet duke e frenuar veten në fillim në lidhje me çështjen e të ngrënies dhe të pirit. Po, futja në disiplinë e të ngrënies dhe të pirit është fillimi i përfitimeve nga agjërimi. Siç thuhet: “Fundi i punës varet nga fillimi i saj.” Nga këtu fillon edhe udhëtimi drejt atmosferës shpirtërore të agjërimit.

Si përfundim mund të themi se sundimin e vullnetit që e fitojmë në muajin e Ramazanit duhet ta mbartim edhe në muajt e tjerë. Ne duhet ta zgjedhim me kujdes çfarë fusim në gojë. Ruajtja e kësaj kornize në këtë çështje apo neglizhenca e saj ndikon drejtpërsëdrejti te ibadetet, veprat dhe mendimet tona.

2. Surja Bekare, 183.



MORALI I PROFETIT (A.S.)

Në ajetin fisnik që na njofton për moralin e Profetit, (a.s.), thuhet: **“Padyshim se ti ke një moral të lartë.”**³ Edhe Aishja (r.a.), thotë: “Moral i tij ishte Kurani.”⁴ Në këtë mënyrë ka shprehur se te ai (a.s.), gjendeshin të gjitha cilësitë e bukura që lavdërohen në Kuran dhe se ai (a.s.), largohej nga çdo gjë që është e ndaluar në Kuran. Nisur nga kjo, detyra e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ka qenë shpjegimi i praktikimit të Kuranit Fisnik në jetë.

Tashmë mund të themi: Civilizimi është i fshehur në detaje. Morali i lartë i të Dërguarit të Allahut (a.s.), është i thurur me shembujt e hijeshisë që dilnin në pah te fjalët, veprat dhe aprovimet duke filluar që nga çështjet më të vogla ndërmjet pjesëtarëve të familjes e deri të marrëdhëniet ndërshtetërore. Atëherë, një mysliman i cili përpiket dhe që e ka për qëllim t’i përjetojë rregullat e moralit profetik, duhet t’i dorëzohet Allahut Teala në marrëdhëniet që ka me Të dhe duhet ta pranojë çdo gjë që vjen nga Ai. Faljen ndaj të tjerëve në marrëdhëniet me krijesat duhet ta ketë simbol të tij dhe në çdo çështje duhet të veprojë me bujari.”⁵ Kurdo që të fillojë ndonjë punë, duhet të pyesë: “Cila është dispozita e Islamit në lidhje me këtë çështje?” Gjithashtu duhet të kërkojë përgjigje për pyetjen: “Si do të dëshironte Profeti (a.s.), që të veproja në këtë situatë?” Zgjedhjet e tij kur të ecë dhe të rrijë ulur, kur të flasë dhe të heshtë, kur të qajë dhe qeshë, kur të marrë e të japë në kallaballëk apo në vend pa njerëz, gjithmonë duhet të jenë në përputhje me veprat e atij (a.s.). Po ashtu, duhet të përpiket të qëndrojë larg gjërave prej të cilave Allahu i Lartësuar nuk është i kënaqur.

Ata që ndjekin gjurmët e moralit të të Dërguarit të Allahut (a.s.), zgjedhjet e tyre duhet t’i bëjnë sipas hapave të bekuar të tij (a.s.).

3. Surja Kalem, 4.

4. Muslim, Misafirin, 139.

5. Ruhul-Bejan, Botimet Erkam, vll. 22, fq. 99.

1. Surja Ahkaf, 20.

KLONIMI I FSHEHTË DHE...

— Xhihan Tashtan —

Në momentin që njerëzit mësojnë se profesioni ynë ka lidhje me studimet gjenetike, vjen pyetja: “Po mirë, a mendon se deri më sot është klonuar ndonjë njeri?” Një temë e tillë është bërë subjekt i filmave të ndryshëm. Mbase skenaristët e kanë shkruar që tani skenarin e një fitneje të madhe të së ardhmes... (Shiko: Varri i humbur i Jezusit, James Cameron, Discovery Channel, 2009)

Njeriu që kryqëzoi Hazreti Isain, ai që i nguli gozhda në duar, i ruan gozhdën e gjakosura në një kuti për një kohë shumë të gjatë. Tashmë shkenca ka përparuar aq shumë dhe ka filluar klonimi i njerëzve aq sa në datën 5 korrik të vitit 1996 lind delja e parë e klonuar, Dolly. Studimet e fshehta përparojnë më shumë se kaq dhe nuk mjaftohen vetëm me klonimin e njeriut, por dëshirojnë që të luajnë me modifikimin e gjeneve. Ndërkohë, ADN-ja e marrë nga gozhdët e gjakosura, injektohet në bërthamën e një veze të fekunduar në laborator.

Kanë kaluar vite të tëra pasi veza e fekunduar u vendos në mitrën e një gruaje... Ai njeri është rritur dhe ngjason shumë me personin që shikohet në shumë imazhe dhe që dikur u gozhdue e u kryqëzua. Faktikisht filmi fillon në këtë moment, sepse njerëzit e shikojnë “Mesiun e rremë” dhe janë të bindur se ai është identik me njeriun e kryqëzuar shekuj më përpara. Tregohet edhe se “Mesi i rremë” ka lindur nga një nënë e vetme dhe nuk ka baba, në këtë mënyrë bëhet akoma më i besueshëm. Tashmë ndjekësit e tij të udhëhequr nga drejtimi i tij i gabuar, e fusin botën në një situatë të rrezikshme...

Nuk ka shumë rëndësi përfundimi i filmit, por ajo që është më e rëndësishme është siguria që duhet të kenë njerëzit në idenë se Allahu i di më së mirë të gjithë gjërat.

SHENJA NË LIDHJE ME KLONIMIN DHE BEBET NË EPRUVETË

Skenaristi i filmit dëshiron të cekë një prej mrekullive më të mëdha të përmendura në Kuran, krijimin e Hz. Isait vetëm nga nëna, pa pasur baba. Ky është njëri prej kufijve që shkenca e sotme nuk e ka arritur akoma. Nga ana shkencore, kjo mrekulli tregon se mjafton marrja e ADN-së së një njeriu për të krijuar një njeri tjetër. Kjo gjë na flet edhe për dukurinë

që është përmendur disa herë në Kuran: “beben në epruvetë”... Pavarësisht se Hz. Zekerija ishte i vjetër dhe gruaja e tij ishte shterpë, Allahu u dhuroi atyre Hz. Jahja-në... (Al-i Imran)... Pavarësisht moshës së thyer të Hz. Ibrahimit dhe bashkëshortes së tij, ata u bekuar me fëmijë. Lista vazhdon me Hz. Isakun e me Hz. Jakupin. (Hud)... Në dritën e këtyre mrekullive, në vitin 2010, Robert G. Edwards fitoi çmimin Nobel në Mjekësi për “beben në epruvetë/ fekundim in vitro”. Deri në ditët tona, në sajë të kësaj metode kanë ardhur në jetë afërsisht 4 milion fëmijë. (Phys Org.com) Një prej dijetarëve më të suksesshëm të shekujve të kaluar, kimisti Xhebir Ibni Hajjan, ka treguar se të gjitha gjallesat (këtu përfshihet edhe njeriu) mund të riprodhohen në mënyra artificiale. Këtë metodë e quajti “tekein”. (Kapitulli i Biologjisë së përgjithshme, Prof. Dr. Mehmet Bajraktar, Shkenca në Islam dhe Historia e Teknikës)

LIDHJA E KLONIMIT ME OMGJ-TË DHE MREKULLIA E PEJGAMBERIT TONË...

Bota nuk është mësuar akoma me OMGJ-të. Njerëzit janë mosbesues ndaj ndryshimit të natyrës dhe kanë frikë prej sëmundjeve që mund të lindin nga një ndërhyrje e tillë. Por vetë Pejgamberi ynë i nderuar na ka treguar se ne nuk do ta ndalojmë dot hyrjen e fshehtë të OMGJ-ve në jetën tonë: “... atë ditë bashkësia do të hajë nga një shegë dhe do të strehohet nën hijen e saj. Do t'i jepen vlera të mëdha edhe qumështit, aq sa një deve që sapo ka lindur të voglin e saj do t'u mjaftojë shumë njerëzve, një lopë që sapo ka lindur të voglin e saj do t'i mjaftojë një fisi, ndërsa një dele që sapo ka lindur të voglin e saj do t'i mjaftojë një familjeje të madhe.” (Salihi Muslim, vëllimi 11)

Ndërveprimi i klonimit me ndërhyrjet gjenetike ka pasur sukses duke bërë që bimët të rriten në sipërfaqe më të vogla, por të kenë më shumë prodhim. Suksese të tilla mund të shohim edhe në botën e kafshëve.

Çështja në të cilën duhet të përqendrohemi është krijimi i laboratorëve në vendin tonë, në mënyrë që të zhvillojmë eksperimente të cilat u përshtaten vlerave tona etike... (A janë OMGJ-të fatkeqësi? Gazeta Rinia, Prill 2011)



Si të bëhesh astronom amator në 3 hapa

Muaz Erdem

Kur fillojmë që të studiojmë qiellin, duke vëzhguar me kujdes gjithësinë e krijuar nga Allahu i plotfuqishëm, futemi në një botë krejt tjetër dhe e ndjejmë Prezencën e Allahut Teala deri në thellësinë e damarëve.

Njerëzit të cilët kanë një interes të përgjithshëm për astronominë dhe studiojnë në lidhje me këtë temë, quhen astronaut amator. Por nëse i ndiqni me kujdes pikat e mëposhtme, do të pajiseni me aftësitë e nevojshme për të qenë më i zoti se amatorët e tjerë.

HAPI I PARË: MËSIMI I KOSTELACIONEVE

Kur e shikojmë qiellin nga një vend larg dritave të forta të qytetit, do të shikojmë se disa yje shkëlqejnë më shumë se të tjerët ndërsa disa kanë shkëlqime me fuqi të njëjtë. Njerëzit e epokave të kaluara i kanë përngjasuar këto yje me forma konkrete dhe u kanë vendosur emra. Në këtë mënyrë lindën kostelacionet.

Unioni Internacional i Astronomisë vendosi rregull në emërtimin e kostelacioneve dhe shpalli 88 kostelacione zyrtare. Listën e këtyre kostelacioneve mund ta gjeni në adresën: <http://www.iau.org/public/cos-tellations>

Po si mund t'i gjejmë kostelacionet në atë qiell të pafund? Për ta bërë këtë gjë, ekzistojnë dy metoda praktike. E para është gjetja e një atlasit qiellor. Kurse e dyta që është edhe më e lehta, është marrja e një programi kompjuterik të quajtur "Stellarium". Në sajë të këtij programi ju do të gjeni pozicionin tuaj në varësi të vendit ku ndodheni për momentin, më pas do të mund të kërkonin një prej trupave qiellorë.

Tani që i kemi informacionet e nevojshme për vendodhjen e trupave qiellorë, nuk na mbetën gjë tjetër veçse t'i gjejmë ato në qiell. Në këtë pikë, një aftësi e mirë orientimi do të ishte shumë e vlefshme. Nëse perfeksionohemi edhe në këtë fushë, do ta kemi përfunduar me sukses hapin e parë.

HAPI I DYTË: VËZHGIM ME DYLBË

Një pjesë e madhe e njerëzve që kanë interes ndaj shkencës së qiellit, mendojnë se menjëherë duhet të marrin një teleskop. Një ide e tillë është mjaft e gabuar sepse teleskopi ka fuqi të madhe zmadhimi dhe përdorimi i tyre është pak i komplikuar. Për këtë arsye, mos blini teleskop menjëherë sepse do ta shuani dëshirën

e zjarrtë për astronominë.

Dylbitë janë mjeti ideal për të filluar me vëzhgimin e qiellit sepse ato ngjasojnë me teleskopin dhe kanë përdorim më të lehtë se ai. Falë dylbive ju mund t'i shikoni trupat qiellorë më të shndritshëm dhe më afër.

Në një natë të errët (larg dritave të qytetit) njeriu normal mund të shikoj rreth 6000 yje. Me ndihmën e dylbive, ky numër mund të shkojë në numra me pesë shifra. Në momentin kur filloni ta shikoni qiellin me dylbi, do të mrekulloheni nga një botë tjetër, që nuk e keni shikuar më përpara. Kur fillojmë që të studiojmë qiellin, duke vëzhguar me kujdes gjithësinë e krijuar nga Allahu i plotfuqishëm, futemi në një botë krejt tjetër dhe e ndjejmë Prezencën e Allahut Teala deri në thellësinë e damarëve.

Dylbitë kanë vlera të tipit: 20x80, 10x60. Çfarë kuptimi kanë këto vlera? Le ta shpjegojmë më mirë me anë të një shembulli. Një dylbi 20x80 ka aftësinë për të afruar 20 herë dhe e ka rrezën 80 mm. Sa më e madhe që të jetë rrezja e lentes, aq më e qartë është; pra me rritjen e rrezes rritet edhe aftësia për të dalluar gjërat. Ju këshillojmë dylbitë e markave Konus, Celestron dhe Meade. Me përjashtim të këtyre markave, cilësia është e dobët dhe ato nuk kanë shumë ndryshim prej dylbive lodër.

HAPI I TRETË: SHQYRTIMI I HËNËS DHE PLANETËVE

Pas marrjes së dylbive, njerëzit kanë si objektiv të parë Hënën që është edhe trupi qiellor më i afërt. Para jush do të shfaqen krateret e hënës! Kur i shikoni për të parën herë, do t'ju krijohen ndjenja më të veçantat!

Pas hënës i vjen radha trupave qiellorë. Stellarium ju vjen në ndihmë edhe në gjetjen e planetëve. Të njëjtën gjë mund ta bëni edhe duke shikuar nga atlasit qiellor. Përveç kësaj, disa prej planetëve më të shndritshëm si Merkuri, Venusi, Marsi, Jupiteri dhe Saturni, mund t'i shikoni me sy të lirë. Duhet të keni parasysh se yjet fiken e ndezën ndërsa planetët ndriçojnë vazhdimisht.

Pas këtyre tre hapave ju do të jeni një astronaut amator shumë i zoti. Me kalimin e këtyre fazave, ju jeni gati për t'iu drejtuar teleskopit në mënyrë që të bëni vëzhgime më të kujdesshme dhe t'i shikoni yjet më afër.



“(Besimtarët që e përmendin gjithmonë Allahun, janë) njerëz, të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahun dhe të cilët falin namazin dhe japin zekatin dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara.” (Nur, 37)

Kurani Fisnik në këtë ajet që u drejtohet besimtarëve e shtron para syve tanë me një shembull të gjallë rezultatin që jep mbi një rob që posedon besimin Islam urdhri hyjnor në formën: **“O besimtarë, mos lejonit që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin.”** (Munafikun, 9)

Besimi Islam e bën të nevojshëm praktikimin e programit të jetës që ka treguar Allahu Teala dhe gdhendjen e vetëdijes se ekzistencën tonë ia kemi për borxh fuqisë e vullnetit absolut të poseduesit të këtij programi në botën tonë mendore, shpirtërore dhe atë të sjelljeve tona. Edhe realiteti i orientimit njerëzor në formën e përmendjes së Allahut, përkujtimin të Tij dhe të jetuarit sipas rrugës së Zotit (xh. sh.), të cilën Kurani Fisnik e thekson si “dhikër”, është një reflektim i kësaj vetëdijeje. Në ajetin që është përkthyer më sipër, tërhiqet vëmendja drejt formës së sjelljes themelore të atyre që e mbarin këtë vetëdijesim kundrejt gjërave të kësaj bote. Këta, para së gjithash, janë njerëz që kanë dalë përpara me aspektin e personalitetit të tyre. Këta burra e kanë kuptuar përkohshmërinë që gjendet pas magjepsjes së gjërave të kësaj bote. Për këtë arsye, tregtia dhe allishverishi që formojnë themelin e preokupimeve në këtë botë të përkohshme, nuk mund t’i pengojnë ata për ta përkujtuar Allahun dhe për të bërë një jetë sipas Islamit. Krahاسimi i gjethes së gjelbër në pemë me gjethen e zverdhur që ka rënë në tokë, për ata është një përvojë që e hap shumë horizontin.

Faktorët që të pengojnë nga përkujtimi i Allahut Teala në ajet simbolizohen me tregtinë dhe allishverishin. Ky fakt është mjaft interesant. Në të gjitha marrëdhëniet njerëzore, çfarëdo llojit qofshin ato, përfundimisht kanë një shkëmbim interesi. Shkëmbimi i interesit bëhet ose në formën e tregtisë (pra, me qëllim për të fituar), ose në formën e allishverishit (pra, me qëllimin për të plotësuar nevojat e përditshme). Nisur nga ky kuptim gjithëpërfshirës i këtyre dy fjalëve, shprehjen në ajet: **“...Tregtia dhe shitblerja nuk i pengojnë për të përmendur Allahun...”**, mund ta kuptojmë edhe në formën: “Preokupimi me këtë botë nuk i pengon ata për ta përmendur Allahun.”

“Dhikrull-llah” që ajeti e ka sjellë në rend të ditës si një koncept themelor dhe që përkthehet si “përmendja e Allahut”, nuk përbëhet nga një veprim verbal në formën e “të shprehurit me gjuhë emrin dhe atributet e Allahut” siç pandehet në shumicën e rasteve. Dhikri është përmendje e përhershme e Allahut Teala dhe reflektim i këtij veprimi në gjendjet e sjelljet tona. Gjendjen e dhikrit që reflekton në sjellje le ta quajmë “dhikër faktual”. Nisur nga kjo, të shprehurit me gjuhë nuk është vetë dhikri, por një reflektim i tij. Të konceptuarit si dhikër vetëm të shprehurit me gjuhë të emrit të Allahut, të cilësive të Tij dhe të shprehjeve që e lartësojnë Atë ndërkohë që mekanizma e mendjes dhe meditimit është pasive, do të thotë që t’ia zbrazësh brendësinë shenjës së vetëdijes për këtë adhurim dhe ta largosh atë (dhikrin) nga kuptimi i tij.

Shprehjes “të përmendësh Allahun” që kalon në ajet është e mundur t’i japim edhe një kuptim të veçantë në formën “të falësh namaz”. Por në të njëjtën kohë, atë mund ta shpjegojmë edhe me kuptimin më të gjerë që mbart fjala dhikër.

Sipas përkufizimit të parë, namazi, krahas çdo lloji dhikri me fjalë dhe veprime që përfshin, është dhikër ngaqë e pastron shpirtin dhe ia mundëson robit ta ndjejë se gjendet nën vëzhgimin e Allahut. Një njeri që i drejtohet kiblës me ndjenjën e frikës dhe respektit ndaj Zotit për të falur namaz, e ndjen me të gjithë qenien e tij dhe me një vetëdije të lartë se po qëndron në audiencën e Allahut Teala. Nisur nga kjo, edhe pesë vaktet e namazit janë urdhëruar, në mënyrë që njeriu gjithmonë ta përmendë Allahun (xh.sh.). (Shik. Ebu Mansur el-Maturidi, Te’vilatu Ehli’s-Sunneh, “I-X Daru’l-Kutubi’l-Ilmijje, Bejrut, 1426/2005”, VII, 574.) Domethënë, namazi ka një qëllim që t’i japë njeriut edukimin e “dhikrit të vazhdueshëm”. Siç ka thënë edhe Mevlana: “Namazi nuk është vënë, në mënyrë që të qëndrosh në kijam, në ruku dhe në sexhde përgjatë gjithë ditës. Qëllimi është që gjendja e cila shfaqet te ti përgjatë faljes së namazit të gjendet vazhdimisht te ti. Kur të jesh në gjumë, kur të jesh zgjuar, kur të shkruash ndonjë gjë, kur të lexosh diçka, përfundimisht, në të gjitha gjendjet nuk duhet të ndahesh nga përmendja e Allahut Teala, në mënyrë që të arrish fshehtësinë:



“Ata e falin namazin me frikërespekt.” – dhe t’u bashkohesh atyre që e arrijnë këtë.” (Mevlana, Fihi ma fihi, përkth. Abdalbaki Gëlpënarlli, fq. 67.)

Edhe në ajetin e nëntë të sures Xhuma: **“O besimtarë, kur të thirreni për (të falur) namazin (e xhumasë) në ditën e premte, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë! Kjo, që ta dini, është më mirë për ju!”**, i cili mbart të njëjtin kuptim me ajetin e tridhjetë e shtatë të sures Nur, të cilin ky shkrim e ka marrë në qendër, tregohet qartë se përmendja e Allahut është namaz, sepse edhe në këtë ajet synohet namazi i xhumasë me shprehjen “përmendja e Allahut”. Në të njëjtën mënyrë, edhe ajeti: **“...Fale namazin për të më kujtuar Mua!”** (Taha, 14), nxjerr në pah lidhjen e fortë që dhikri ka me namazin. Sipas këtij kuptimit të parë, preokupimet e kësaj bote nuk i çojnë në neglizhimin e namazit robërit që lavdërohen në ajet. Shprehja për neglizhimin e namazit këtu përfshin edhe mosfaljen e namazit, edhe të qenët larg frikërespektit ndaj Zotit përgjatë faljes së namazit, edhe sjelljen dhe gjendjen shpirtërore të parregullt përgjatë namazit.

Sipas këtij kuptimi, portreti i myslimanit që përkthehet nga ajeti të sjell në mendje hadithin fisnik: **“Kur të ngrihesh për ta falur namazin, fale atë si një njeri që po i jep lamtumirën kësaj bote!”** (Ahmed, Musned, “I-VI, Muessesetu Kurtuba, Kahire,” V, 412.) Një mysliman që e merr për udhërrëfyes këtë paralajmërim profetik, dëshirat dhe pasionet e tij në lidhje me këtë botë gjithmonë i mban brenda kufijve të tij, pra, në vendin e duhur. Namazi që fal në kohët e caktuara përgjatë ditës, i jep harmoni jetës së tij. Në namazin që hyn duke thënë: “Allahu ekber!”, e mban të gjallë dhe të vazhdueshme lidhjen me “qiellin”. Atmosferën e lirisë që e ndjen një njeri që del në gjithësi, ai e ndjen deri në palcë përgjatë kohës që është në namaz. Hadithi fisnik: **“Namazi është miraxhi i besimtarit.”** – duket sikur tregon këtë gjendje shpirtërore.

Nëse shprehjen “përmendja e Allahut” do ta shpjegojmë me kuptimin më të gjerë që mbart fjala dhikër, atëherë ajeti: **“...Tregtia dhe shitblerja nuk i pengojnë për të përmendur Allahun...”**, na thotë këto: “Ata nuk e harrojnë Allahun edhe kur preokupohen me tregti dhe allshverish / punët e kësaj bote. Punët e tyre i kryejnë me vetëdijen se

do t’i japin llogari Allahut. Vetë jeta dhe ngjarjet që i përjetojnë përgjatë saj, nuk e pengon botën e tyre mendore dhe shpirtërore që të jetë bashkë me Allahun Teala. Për këtë arsye, ata janë në dhikër të përhershëm në çdo punë të dobishme që bëjnë.” (Shik. Maturidi, Tevilat, VII, 574.) Nisur nga kjo, ata gjithmonë kanë një gjendje të dëlirë. Si rezultat, nuk bëjnë hile, nuk peshojnë mangët dhe rrinë larg shtrijes e sjelljeve të pamoralshme.

Veprat e tjera që shprehen në vazhdimësinë e ajetit fisnik dhe që preokupimi me këtë botë nuk mund ta pengojë besimtarin shembullor prej tyre janë “falja e namazit” dhe “dhënia e zekatit”. Nëse shprehjen “përmendja e Allahut” e shpjegojmë si “falja e namazit”, fjala “falja e namazit” që përmendet menjëherë pas saj mbart kuptimin e “faljes së këtij ibadet duke i dhënë hakun me faktorët e tij materialë dhe shpirtërorë.” Nisur nga kjo, këtë pjesë të ajetit mund ta kuptojmë në formën: “...Ata janë njerëz të atillë që tregtia dhe shitblerja nuk i pengojnë për ta falur namazin, i cili është përmendje e Allahut, në formën më të mirë dhe duke ia dhënë hakun...”

Nëse merret në kuptimin e gjerë dukuria e përmendjes së Allahut që theksohet në ajetin fisnik, do të shprehet qartë se robërit e veçantë të Allahut që përmenden në ajet nuk mashtrohen nga pasionet dhe preokupimet e kësaj bote për sa i përket çështjes së kryerjes së këtyre ibadeteve të njohura, pra, “faljes së namazit” dhe “dhënies së zekatit”.

Ndërkohë që ajeti tregon se të gjitha këto adhuri me ushqehen me besimin ndaj ahiretit dhe kiametit, e shtron para syve gjendjen tmerruese të kiametit me përshkrime ndikuese si “shqetësim të zemrave dhe frikësim të syve”. Në këtë mënyrë, njerëzve u jep mesazhin: “Mos e harroni Allahun, në mënyrë që të mos e përjetoni këtë tmerr!”

Allahu Teala thotë: “Kudo që të jeni, Ai gjithmonë është bashkë me ju.” Në këtë mënyrë, na bën përgjegjës për mbartjen e vullnetit për t’ju përgjigjur këtij orientimi hyjnor. Përmendja e vazhdueshme e Allahut Teala dhe të vepruarit sipas direktivave të Islamit është rruga e vetme që do të na bëjë të suksesshëm në këtë çështje. Allahu na e lehtësoftë rrugën!



Xhabir ibn Abdullahu (r.a.), transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (a.s.), duke thënë:

“Ndërmjet njeriut dhe shirkut e kufrit gjendet namazi (si pengesë).”

(Muslim, Iman, 134.)


Përgjegjësia e parë dhe më e rëndësishmja kundrejt Zotit (xh.xh.), e të gjithë pejgamberëve duke filluar që nga Ademi është namazi. Lutja e Ibrahimit (a.s.), që ia drejtoi Zotit (xh.sh.), ishte që ta bënte atë dhe pasardhësit e tij prej atyre që e falin namazin. (Ibrahim, 40) Namazi ishte urdhër për familjen e Ismailit (a.s.), i cili fitoi kënaqësinë e Allahut Teala. (Merjem, 55) Falja e namazit është këshilla e Lukmanit (a.s.), që ia dha birit të tij. (Lukman, 17) Namazi është drita e syve të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe i vlefshëm saqë nuk mund ta neglizhonte as kur ishte ballë për ballë me vdekjen në luftë. (Nesai, Isharatu'n-Nisa, 1.)

Namazi, si një adhurim i obliguar për çdo individ besimtar dhe që përgjegjësia e tij nuk mund t'i ngarkohet dikujt tjetër në asnjë mënyrë, është vepra e parë për të cilën do të merret në llogari robi. (Tirmidhi, Salat, 188.) Pas besimit ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që është kushti i parë prej pesë kushteve mbi të cilat është ndërtuar Islami, vjen namazi, i cili është “shtylla e fesë”. (Tirmidhi, Iman, 8.) (Buhari, Iman, 2; Muslim, Iman, 1.) Sepse Allahu Teala thotë: **“Thuaju robërve të Mi besimtarë që ta falin namazin!”** (Ibrahim, 31) Namazi, i cili tregon sinjeritetin e robit kundrejt Zotit dhe që e shndërron në vepër besimin e tevhidit, është një ibadet që e shpreh në formën më të bukur adhurimin dhe nënshtrimin ndaj Allahut Teala.

Falja e namazit kurrë nuk është e vështirë për një besimtar që me të vërtetë e ka gdhendur besimin në zemrën e tij. (Bakara, 45) Sepse besimtari gjen prehje shpirtërore me namaz dhe e ndjen pranë në çdo moment ndihmën e Zotit (xh.sh.), të Cilit i është afruar më shumë. Kur besimtari e dëgjon thirrjen: “Ejani në namaz! Ejani në shpëtim!”, i lë mënjanë të gjitha preokupimet e kësaj bote dhe përjeton emocionin e të takuarit

me Zotin, i Cili është një dhe i vetëm, me trupin, mendjen dhe zemrën e tij. Siç shprehet edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), në shembullin për atë që lahet dhe pastrohet nga papastërtitë pesë herë përgjatë ditës në një lum që kalon para shtëpisë së tij, edhe besimtari dëliret nga mëkatet dhe të këqijat në sajë të pesë kohëve të namazit. (Buhari, Mevakit, 6; Muslim, Mesaxhit, 283.) Besimtari e fal namazin me frikërespekt ndaj Zotit (xh.sh.), duke ia dhënë hakun çdo shtylle të tij siç urdhërohet në ajetin fisnik: **“...Fale namazin** (në formën më të mirë)!..” (Ankebut, 45) Ai e di se “hajduti më i keq është ai që vjedh prej namazit të tij”. (Ahmed b. Hanbel, Musned, III, 56.)

Nëse nisemi nga qëndrimi i hipokritëve, do të kuptohet më lehtë se besimi dhe namazi janë dy bazat e pandashme nga njëra-tjetra. Për këtë arsye, namazi i cili është miraxhi i besimtarit, është një barrë e rëndë dhe e papërballueshme për hipokritin që vepron me dyfytirësi në besimin e tij. Hipokriti shtiret vetëm e vetëm për të fituar disa interesa të kësaj bote ndërkohë që nuk beson. Ai shfaq përtaci kur ngrihet për të falur namazin (Nisa, 142; Teube, 54) dhe e vonon atë deri në fund të kohës nëse është duke e falur vetëm. (Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 293.) Hipokriti më së shumti e ka të vështirë për të falur namazin e mëngjesit dhe të jacisë. (Buhari, Ezan, 34; Muslim, Mesaxhid, 252.) Sepse ai nuk dëshiron ta ndërpresë gjumin në momentin më të ëmbël dhe ta prishë rehatinë në fund të ditës. Më pas, fara e hipokrizisë që e rrit në zemrën e tij si një çiban që rritet me gjak e me qelb, e shtyn atë ta lërë namazin dhe ta shfaqë mohimin e fesë. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut, (a.s.), në periudhën kur ka jetuar bashkë me hipokritët në Medinë është shprehur se namazi ishte garancia ndërmjet tyre dhe hipokritëve, domethënë, se do të trajtoheshin si myslimanë përderisa e falnin



namazin. Ndërsa kur të mos e falnin namazin, do t'u dilte në pah mohimi i tyre dhe si rezultat do të trajtoheshin sipas kësaj. (Tirmidhi, Iman, 9.)

Ademi (a.s.), Nuhu (a.s.), Ibrahim (a.s.) dhe Jakupi (a.s.), të gjithë ishin pejgamberë të urdhëruar për faljen e namazit. Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik flet për një brez që erdhi pas atyre, që e la namazin dhe si rezultat u dhanë pas epsheve dhe pasioneve të kësaj bote. Zoti (xh.sh.), na njofton se këtij brezi do t'i jepet një ndëshkim i madh për shkak të veprave të tij. (Merjem, 59) Kështu, edhe njëra prej përgjigjeve që do të marrin banorët e Xhenetit nga banorët e Xhehenemit kur t'i pyesin se përse gjenden aty, do të jetë kjo fjali: ***"Ne nuk ishim prej atyre që falnin namaz."*** (Muddeththir, 40-43) Ndërkohë namazi është njëri prej adhurimeve që mundëson fitimin dhe lumturinë e Ahiretit. Për këtë arsye, Pejgamberi (a.s.), ka thënë: ***"Namazi do të jetë dritë, argument dhe shkak për shpëtim në Ditën e Kiametit për atë që e fal vazhdimisht. Ndërsa ai që nuk e fal vazhdimisht namazin, Ditën e Kiametit nuk do të ketë dritë, argument dhe shpëtim."*** (Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 169.)

Siç ka ndodhur në të kaluarën, edhe në ditët e

sotme ka prej atyre njerëzve që e lënë namazin për shkak se nuk besojnë, se e nënvlerësojnë, se harrojnë dhe se e neglizhojnë. Më i dhimbshëmja prej këtyre është mosfalja e namazit për shkak të mosbesimit, domethënë, mohim i Allahut Teala dhe urdhrat të Tij. Fundi i kësaj gjendjeje është ndëshkim i përhershëm. Krahës kësaj, lënia e namazit nga disa myslimanë duke nxjerrë në pah pretekste të ndryshme është një qëndrim dëshpërues dhe që duhet të ekzaminohet. Ndoshta shumë myslimanë nuk janë të vetëdijshëm se me çfarë rreziku do të përballen nëse e lënë namazin, i cili është pengesa më e madhe ndërmjet besimit dhe kufrit/shirkut. Ndërkohë, lënia e namazit do të thotë privim nga shumë dobi të tij, sepse namazi të mbron nga rënia në imoralitet e ligësi, të mundëson ta përkujtos Allahun, i jep orientim jetës së njeriut dhe i mundëson atij prehje shpirtërore. Ne asnjëherë nuk duhet ta harrojmë për ta thënë lutjen e Ibrahim (a.s.), në mënyrë që të mos e humbasim çelësin e lumturisë së kësaj bote e të botës tjetër dhe që ta fitojmë kënaqësinë e Zotit (xh.xh.): ***"O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet!"*** (Ibrahim, 40)



SHKOLLA E UNIVERSIT

Gjithësia, Kurani dhe Njeriu – 6

“Në këtë Kuran, Ne u shpjegojmë njerëzve gjithfarë shembujsh, por shumica e njerëzve, kurrësi nuk duan të besojnë.” (Isra, 89)

Në zemrën e njeriut që lexon Kuran dhe që e sheh shkollën e universit me syrin e medimit, lind një meditim sipas pjekurisë dhe thellësisë së saj. Në këtë mënyrë, atij i hapen dritaret e njohjes së Allahut.



Kurani Fisnik e fton gjithmonë njeriun të meditojë, të logjikojë dhe të mendojë mbi madhësinë hyjnore dhe fundin e vet:

A NUK LOGJIKONI?

“Ai, që në këtë botë ka qenë i verbër, do të jetë i verbër edhe në botën tjetër dhe më i humbur nga rruga e drejtë.” (Isra, 72)

Faktin që meditimi është një çelës i rëndësishëm i besimit, e shprehin më së miri këto ajete fisnike, ku tregohet se në Ditën e Kiametit, ata që do të ankohen, do t’ju kujtohen këto dy pika:

“...Vallë,

- a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)?!

- Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi?..” (Fatir, 37)

Ndërsa banorët e Xhehenemit do të pohojnë:

“...«Sikur të kishim dëgjuar ose menduar, nuk do të ishim midis banorëve të Zjarrit Flakërues!»” (Mulk, 10)

Manifestimet hyjnore që soditen në shkollën e universit, Kurani Fisnik i tregon me shembuj, me përshkrime dhe duke cekur misteret dhe urtësitë e tyre:

“Në këtë Kuran, Ne u shpjegojmë njerëzve gjithfarë shembujsh, por shumica e njerëzve, kurrësi nuk duan të besojnë.” (Isra, 89)

Në zemrën e njeriut që lexon Kuran dhe që e sheh shkollën e universit me syrin e medimit, lind një meditim sipas pjekurisë dhe thellësisë së saj. Në këtë mënyrë, atij i hapen dritaret e njohjes së Allahut.

Kur e lexojmë Kuranin duke medituar, përballemi edhe me një mirësi tjetër hyjnore që na forcon besimin dhe na shton dijen: Të vërtetat e krijimit që janë shprehur brenda poetikës së Kuranit para katërmbëdhjetë shekujsh:

MREKULLITË E KURANIT

Në shekullin e 7, kur njerëzimi i kthente sytë nga qielli, shihte me mijëra yje, por shumica e tyre nuk e dinte se çfarë ishin. Një pjesë e njerëzve, duke



parë forma të ndryshme me bashkimin e disa yjeve në qiell, i përdornin ato për të lexuar fatin, për të gjetur rrugën dhe drejtimin. Ndërsa në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar betohet:

“Jo! Betohem në vendin e yjeve! E, ky është betim i madh, veç sikur ta dinit.” (Uakia, 75-76)

Fjala “meuki”, e cila përkthehet “vend”, ka edhe kuptimin “rënie”. Profesorët e fizikës dhe astrofizikës në ditët tona, shprehen se qëllimi i fjalës “meuki”, të bën të mendosh “vrmat e bardha” ku lindin yjet dhe “vrmat e zeza”, ku vdesin yjet. Vetëm një kohë të gjatë pas shpikjes së teleskopit, në shekujt 19-20, njerëzimi arriti të mbledhë më shumë informacione në lidhje me kozmosin.

Sot, astronomët kanë llogaritur në mënyrë matematikore, se në univers ekzistojnë vrma të bardha dhe vrma të zeza.

Ndërsa Allahu i Madhëruar, betohet në Kuranin Fisnik për këto “vrma” që shkencat pozitive sapo i kanë zbuluar. Kjo e vërtet, të cilën shkenca e sotme sapo e ka zbuluar, tregon se kemi të bëjmë me një mrekulli të jashtëzakonshme. Sipas mendimit të astronomëve, vendi ku lindin yjet quhen vrma të bardha, ndërsa vendi ku vdesin, quhen vrma të zeza.

Prej vrimeve të bardha del një objekt i vogël, i cili (me kalimin e kohës) fillon e zgjerohet, duke marrë një masë prej trilionave fish më të madhe se sa ishte në fillim dhe, më në fund formohet një yll. Nga ana tjetër, shumë yje me masë jashtëzakonisht të madhe, kapen dhe përthithen nga vrmat e zeza, të cilat janë si varreza yjesh, duke sjellë kështu vdekjen e atyre yjeve. Duke u bazuar në këto fakte, do të vijë një ditë:

“Kur Dielli të mblidhet e të humbë shkëlqimin.” (Tekuir, 1)

Në të shkuarën, shumica e filozofëve mohues, me arsyetimet e tyre që nuk mbështeteshin në vëzhgime dhe argumente, pretendonin se gjithësia është pa

fillim. Mirëpo, në sajë të kërkimeve në shkencat pozitive, janë detyruar të pohojnë se gjithësia ka një pikë fillimi. Sipas një teorie, kur lënda ishte ende e bashkuar me gazin, në një pikë ndodhi një shpërthim, i cili rezultoi me krijimin e universit.

Këto të vërteta, Kurani Fisnik i ka cekur që në shekullin e 7:

“Pastaj, Ai (Allahu) iu drejtua qiellit, që ishte në gjendje të gaztë!..” (Fussilet, 11)

“A nuk e dinë mohuesit se qiejt dhe Toka kanë qenë një e tërë? Pastaj Ne e ndamë dhe bëmë nga uji çdo gjë të gjallë! Akoma nuk besojnë?!” (Enbija, 30)

Prova që universi është krijuar duke u zgjeruar prej energjisë që ka filluar prej një pike (sipas teorisë një shpërthim), është siguruar në sajë të vëzhgimeve me teleskop në shekullin e 20, ku u zbulua se gjithësia ende vazhdon të zgjerohet. Në bazë të këtij ligji, galaktikat janë duke u larguar prej njëra tjetrës në përpjesëtim të drejtë me largësinë që ekziston midis tyre. Për shembull, një galaktikë që është 10 milion vite dritë larg nesh, largohet prej nesh me një shpejtësi prej 250 km në sekondë. Ndërsa një galaktikë që ndodhet 10 miliardë vite dritë

larg nesh, largohet me një shpejtësi prej 250.000 km në sekondë.

ZGJERIMI I UNIVERSIT

Ky fakt ceket në këtë formë në Kuranin Fisnik:

“Ne e kemi ndërtuar qiellin me fuqinë Tonë dhe Ne e zgjerojmë atë.” (Dharijat, 47)

Një të vërtetë të tillë, të cilin e kanë zbuluar vetëm një grusht njerëzish në shekullin e njëzetë, Kurani e ka deklaruar që para katërmëdhjetë shekujsh. Kjo tablo, na tregon se:

Kurani ecën në krye, ndërsa shkenca i vjen pas duke ecur këmbadoras. Le të vazhdojmë të meditojmë mbi kozmosin me Kuranin Fisnik:



Ne jetojmë të sigurt në botën tonë, e cila është përgatitur për ne si një djep apo si një dyshek. Mirëpo, përreth tokës sonë, ekziston një ambient i mbushur plot me rreziqe. Por, si ruhem ne prej shumicës së tyre?

TAVANI I MBROJTUR

Meteoritët, të cilët janë copat e diejve që kanë shpërthyer, janë të shpërndarë gjithandej nëpër kozmos. Jupiteri dhe Saturni me forcën e tij të jashtëzakonshme të tërheqjes, mbajnë shumë objekte kozmike të rrezikshme për Tokën. Mirëpo, disa prej meteoritëve që herë pas here e kalojnë mburojën e këtyre dy planetëve dhe i afrohen tokës, kapen nga Hëna. Për shkak të mungesës së atmosferës në Hënë, çdo meteor që bie në të, përplaslet direkt me sipërfaqen e saj. Krateret që formojnë rëniet e këtyre meteorëve në Hënë, mund të shihen edhe me një dylbi të vogël.

Ndërsa meteorët që arrijnë të kalojnë edhe pengesën e Hënës, nëse nuk janë shumë të mëdhenj, ata fillojnë të digjen për shkak të fërkimit të jashtëzakonshëm me atmosferën sapo hyjnë në të. Nëse sajë të këtij fenomeni që ne e shohim dhe e quajmë “rënie yjesh”, meteorët bëhen pluhur dhe shpërbëhen brenda shtresës së mezosferës, pa e arritur sipërfaqen e Tokës.

Përveç kësaj, fusha magnetike e krijuar përreth Tokës si rezultat i rrotullimit të saj dhe shtresa të ndryshme të atmosferës, e mbrojnë Tokën prej rrezeve të dëmshme që vijnë prej kozmosit dhe shpërthimeve të Diellit.

Atmosfera na mbron prej të ftohtit të jashtëzakonshëm të kozmosit që arrin në -270°C . Për shembull, në Hënë, ku nuk ka atmosferë, temperaturat ndryshojnë nga -150°C deri në 100°C . Kjo, sepse Hëna nuk ka “mbulesë/tavan mbrojtës” dhe e gjithë nxehtësia dhe drita që vjen prej Diellit, bie ashtu siç është direkt mbi sipërfaqen e Hënës.

Këto fakte, shprehen kështu në Kuranin Fisnik:

“Ne e bëmë qiellin mbulesë/tavan të mbrojtur, por përsëri ata shmangen nga shenjat që gjenden aty.” (Enbija, 32)

Lidhur me rëndësinë e “tavanit mbrojtës”, vitet e fundit na ka tërhequr vëmendjen edhe një çështje tjetër:

Si rezultat i shpërdorimit dhe manipulimit njerëzor në lidhje me gazet serë, është zbuluar se shtresa e Ozonit ka filluar të dobësohet tejmasë. Dhe për rrjedhojë, kjo ka ndikuar në shkrirjen e akullnajave, në ndryshimin e klimës, në kancerin e lëkurës dhe në dëme të tjera të ngjashme. Faktin që keqpërdorimi i tokës nga ana e njeriut ka prodhuar shumë probleme dhe të këqija, e ka shprehur edhe Kurani Fisnik:

“Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t'i bëjë “të shijojnë” pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim).”
(Rum, 41)

ERËRAT MBARSËSË

Më sipër thamë se objektet e huaja që hyjnë prej atmosferës, “tavanit mbrojtës” i kthen në pluhur. Më pas, këto grimca pluhuri bëhen bërthamë për çdo pikë shiu. Me qëllim që uji i avulluar nga Dielli të kthehet përsëri si shi mbi tokë, ka nevojë për grimcat e pluhurit të quajtura “bërthamat kondensuese”.

Grimcat e kripës që ngrihen prej oqeanëve, pluhuri që ngrihet nga erërat në shkretëtira dhe hiri që del prej vullkaneve, barten deri në shtresat e sipërme të atmosferës me anë të erërave. Ky pluhur mbars avujt e ujit në atmosferë, të cilat më pas marrin formën e pikave të ujit.

Mirëpo, fakti që erës i është dhënë detyra e bartjes së këtyre grimcave të pluhurit, është bërë i ditur në Kuranin Fisnik para 14 shekujsh:

“Ne i dërgojmë erërat për pllenim dhe zbresim nga qielli ujë, prej të cilit ju japim të pini e të cilin nuk mund ta depozitoni dot.” (Hixhr, 22)

Funksioni mbarsës i erës në ciklin e shiut, është zbuluar vetëm shekullin e kaluar. Kurani flet edhe për funksionin e erës në pllenimin e bimëve.

Në shumë lloje bimësh, frutat duhet të pllenohen me pluhurin e luleve, polenin dhe farat e tyre, sepse Allahu i Madhëruar, i Cili është Tek dhe i pashoq, gjithçka e ka krijuar në çift.



EDHE ATO QË NUK DINI JANË ÇIFT

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Dhe nga çdo gjë, Ne kemi krijuar dy palë, në mënyrë që ju të merrni mësim!” (Dharijat, 49)

“Qoftë lavdëruar Ai që i ka krijuar çift të gjitha llojet: çka mbin prej tokës, ata vetë dhe ato që nuk i dinë!” (Jasin, 36)¹

Shprehja **“kemi krijuar çift edhe nga ato që një-rëzit ende nuk i dinë”**, ka një urtësi, e cila është kuptuar vetëm shekullin e kaluar. Krijimi në çift vlen për të gjithë universin. Edhe vetë atomet janë çift. Një pjesë e tyre janë të ngarkuar në mënyrë pozitive, një pjesë në mënyrë negative. Për shembull, energjia elektrike pozitive, rrjedh drejt asaj negative dhe ndezin llambën. Retë me ngarkesë pozitive bashkohet me ato me ngarkesë negative dhe shkaktajnë shiun. Po ashtu, në fizikën teorike, është evidentuar edhe ekzistenca e të kundërtave të elementëve nën atomikë.

Idea e ekzistencës së “atomit/ grimcës” si elementi më i vogël, haset që në Greqinë e lashtë. Mirëpo, sipas tyre, atomi ishte qenia më e vogël, e cila nuk mund të ndahej në asnjë mënyrë.

Mirëpo, në shekullin e 20, u zbulua bota nën atomike, ku elektronet rrotulloheshin përreth bërthamës. Më pas, u zbulua se edhe bërthama përbëhej nga protonet, neutronet dhe grimca të tjera. Pak më vonë u zbulua se edhe këto përbëheshin nga kuarkët. Sot për sot, po bëhen kërkime nëse ka diçka tjetër edhe përtej kuarkëve. Mirëpo, në ajetet fisnike të zbritura para katërmëdhjetë shekujsh, aludohet në elemente edhe më të vogla se sa grimca/atomit:

“...Zotit tënd nuk i fshihet asnjë grimë peshe, në Tokë e në qiell; as më pak nga ajo e as më shumë nuk mbetet pa u shënuar në Librin e qartë!” (Junus, 61)

“Jobesimtarët thonë: «Nuk do të na vijë Ora (e Kiametit)!»

Thua ju: «Po, për Zotin tim! Me siguri që ajo do t'ju vijë!» Ai i di të gjitha të fshehtat. Atij nuk mund t'i fshihet asnjë grimë as në qiej, as në Tokë e nuk ka asgjë më të vogël apo më të madhe që të mos jetë shënuar në Librin e qartë.” (Sebe', 3)

Le t'i kthehemi edhe njëherë marrëdhënies së erës me shiun. Në Kuranin Fisnik, thuhet se retë janë të rënda:

PESHA E REVE

“Ai i dërgon erërat si lajmëtare të mëshirës së Tij. Kur erërat lëvizin retë e rënda me shi, Ai i çon ato tek ndonjë vend i vdekur, ku lëshon shi dhe me anë të tij nxjerr lloj-lloj frutash; po kështu do t'i ringjallë edhe të vdekurit. Këta janë shembuj që t'ua vini veshin.” (A'raf, 57)

Është llogaritur se 1cm shi e rënë në një hapësirë prej 50 km², peshon gjysmë milion tonë. Ndërsa një re e vetme shiu, mund të peshojë deri në 300 mijë tonë. Fakti që retë me një peshë kaq të madhe arrijnë të qëndrojnë pezull në ajër dhe shiu apo bora që bien prej tyre nuk e dëmtojnë tokën, është një tregues i qartë i mëshirës hyjnore. Mirëpo, herë pas here, bie edhe breshër i cili pjesërisht mund të jetë i dëmshëm. Ndërsa në këtë ajet fisnik, flitet për dendësinë e reve që shkaktajnë shiun, breshrin, rrufenë dhe marrëdhënien midis tyre:

“A nuk e vëren ti se Allahu i shtyn retë ngadalë e pastaj i bashkon e i grumbullon njëren mbi tjetrën, derisa të shohësh shiun se si del prej tyre dhe bie nga qielli?! Ai, prej reve të mëdha si mali, lëshon breshrin e me të godet kë të dojë, kurse e shman prej kujt të dojë. Shkëlqimi i vetëtimës së tij gati t'i merr sytë.” (Nur, 43)

Nëse vazhdojmë të shohim nga qielli, do të vërejmë dy llamba të mëdha që do na bëjnë të meditojmë gjithmonë:

DIELLI DHE HËNA...

Në ajetet e Kuranit Fisnik, janë përdorur fjalë të ndryshme për të përshkruar dritën e këtyre dy trupave qiellorë:

“Qoftë i lartësuar Ai, i Cili e ka stolisur qiellin me njësi dhe ka vënë në të një Kandil të ndritshëm dhe një Hënë që ndriçon!” (Furkan, 61)

Ndërkohë që për Diellin përdoret fjala “siraxh” që ka kuptimin e “kandilit”, i cili e ka brenda vetes burimin e dritës, për Hënë përdoret fjala “nur” që do të thotë “dritë e reflektuar”. Kjo e vërtetë shprehet edhe në ajete të tjerë:

1. - Shih. Rad, 3. Ndërsa për gjininë e bimëve shih. TaHa, 53.

*Kurani Fisnik është një litar i fortë,
njëra anë e të cilit gjendet në dorën e plotfuqishme të Allahut,
ndërsa ana tjetër na është zgjatur neve. Rruga për t'u afruar
me Allahun është të kapesht fort pas tij.*



“A nuk e shihni se si Allahu i ka krijuar shtatë qiejt njëri mbi tjetrin, dhe në ta e ka bërë Hënën dritë, kurse Diellin e ka bërë kandil?” (Nuh, 15-16)

Teoria e Ptolemeut në lidhje me Diellin, ofronte idenë e një sistemi me qendër Tokën dhe diellin që rrotullohej rreth saj, sepse kjo ishte pamja që shihej prej Tokës.

Me kalimin e kohës, njerëzimi mësoi se nuk është Dielli që rrotullohet rreth Tokës, por Toka që rrotullohet rreth Diellit. Por, kësaj here ata mendonin se Dielli qëndron pa lëvizur. Mirëpo Dielli udhëton në orbitën e vet brenda galaktikës sonë Rruga e Qumështit. Lidhur me këtë fakt, Kurani Fisnik urdhëron:

“Edhe Dielli ecën në rrugën e caktuar për të!..” (JaSin, 38)

“Allahu është Ai, i Cili krijoi natën dhe ditën, Diellin dhe Hënën; e të gjitha këto lundrojnë në gjithësi.” (Enbija, 33)

E REJA QË NUK VJETËRSOHEK KURRË

Kurani Fisnik, është fjala e pafillim e Krijuesit të tokës dhe qiellit. Ai u zbrit në tokë shekuj më parë. Mirëpo, në të nuk gjendet asnjë kundërshti me ato të vërteta shkencore që janë zbuluar më vonë.

Por, për shkak se njerëzimi është i prirë t'i shtojë driturisë së tij gjithmonë pandehmat e veta, mendimet dhe teoritë e pavërtetuara, veprat që dalin nga dora e njeriut nuk i rezistojnë dot kohës. Për rrjedhojë, nëse analizohen veprat e shkruara në fushën e mjekësisë vetëm para pesëdhjetë vitesh, do të shihet se shumë mendime sot e kanë humbur vlefshmërinë e tyre. Enciklopeditë e shkruara nga specialistët e të gjitha fushave nën kontrollin e komisioneve shumëanëtarëshe, pa kaluar shumë kohë

detyrohen të shtypen përsëri në vëllime të tjera të rishikuara.

Kurani Fisnik na ka bërë të ditura shumë çështje të cilat nuk njiheshin aspak nga njerëzit në kohën kur ai u zbrit dhe që u zbuluan shekuj më vonë, siç janë ato në lidhje me kozmosin, krijimin e njeriut, formimin e qumështit në trup, prodhimin e mjaltit nga bleta, etj. Të vërtetat për të cilat ka folur Kurani Fisnik nuk janë zbuluar ende të gjitha. Por megjithatë, Kurani ecën gjithmonë në krye, korrigjon gabimet në shkencat pozitive dhe të gjitha shkencat vijnë pas tij.

Fakti që këto të vërteta të Kuranit nuk janë shprehur në mënyrë të qartë dhe të hapur, por në mënyrë të koduar, është për shkak që ai të mos përgënjestrohej në të shkuarën nga ana e njerëzve të paditur. Për rrjedhojë, kjo përbën një tjetër mrekulli të Kuranit, që me anë të të njëjta shprehjeve, i drejtohet edhe njerëzve të shekullit të 7, edhe njerëzve pas shumë shekujsh nga zbritja e tij (e deri në Ditën e Kiametit).

Për shembull, çështja e relativitetit të kohës, është një ide e hedhur për diskutim në shekullin e 20 dhe është e vështirë të kuptohet. Mirëpo, Allahu i Madhëruar e ka shprehur qartë dallimin e perceptimit të kohës në botën tonë:

“Ai drejton çdo çështje, prej qiellit deri në Tokë, pastaj ato kthehen tek Ai në ditën, gjatësia e së cilës është një mijë vjet sipas llogaritjes suaj.” (Sexhde, 5)

“Tek Ai ngjiten engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), në një ditë që zgjat sa pesëdhjetë mijë vjet.” (Me'arixh, 4)

Në këto ajete tregohet në mënyrë të qartë e vërteta e relativitetit të kohës. Le të vazhdojmë më tej me mrekullitë e Kuranit:

TOKA ËSHTË SFERIKE

Deri në shekujt 15-16, njerëzimi diskutonte ende, nëse Toka është e rrumbullakët apo e sheshtë. Ndërsa Kurani Fisnik ka aluduar në shumë ajete në lidhje me formën sferike të tokës:

“...Ai e bën natën të kalojë në ditë dhe ditën në natë!..” (Zumer, 5)

Fjala “jukeiru” që përdoret në këtë ajet, nënkupton mbështjelljen (p.sh me fasho) të një objekti sferik si koka e njeriut. Në suren Naziat, në ajetin 30 urdhërohet:

“E më pas e shtroi tokën”

Mirëpo, fjala “deha”, që në përgjithësi është përkthyer me foljet “të shtrosh/të sheshosh/të rrafshosh”, përmban edhe kuptimin e “bërjes së diçkaje në formën e vezës së strurit”. Nisur nga kjo, mund të themi se në këtë ajet është aluduar edhe për formën ovale (të shtypur në dy pole) të tokës.

Ndërsa në një moment tjetër, kur flitet për kohëzgjatjen e fjetjes së As’habi Kehfit në shpellë, Kurani Fisnik shpeshet:

“Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind vjet (diellorë), duke shtuar nëntë (për vitet hënore).” (Kehf, 25)

Në këtë ajet, është treguar dallimi ndërmjet vitit diellor prej 365 ditë e 6 orësh dhe vitit hënor prej 355 ditësh. Dhe për shkak të ndryshimit prej afro 10-11 ditësh, llogaritet që 33 vite diellore, të jenë sa 34 vite hënore. Për rrjedhojë, në 300 vite duhen shtuar fiks 9 vite. Në kohën e Profetit (a.s.), kalendari diellor nuk njihej dhe nuk përdorej. Por kjo shprehje e Kuranit që përfshin edhe kalendarin diellor, tregon një mrekulli të veçantë.

MALET QË LËVIZIN

Në një tjetër ajet fisnik urdhërohet:

“Ti i shikon malet e mendon se janë të palëvizshme, por ato lëvizin si retë...” (Neml, 88)

Në këtë ajet, lëvizja e tokës është ngjasuar me lëvizjen e reve, duke nxjerr në pah një tjetër urtësi hyjnore. Masat kryesore të reve që ndodhen afërsisht 3.5-4 km mbi sipërfaqen e tokës, nëse nuk ndikohen nga kushtet atmosferike, ato lëvizin gjithmonë nga perëndimi në lindje. Po ashtu, edhe Toka bën të njëjtën lëvizje.

Ndërkohë që Toka rrotullohet rreth vetes me një shpejtësi prej 1.667 km në orë, ajo rrotullohet edhe përreth Diellit me një shpejtësi prej 30 km në orë. Po ashtu, në të njëjtën kohë, bashkë me sistemin diellor dhe galaktikën Rruga e Qumështit, Toka lëviz me shpejtësi brenda universit. Mirëpo, për shkak të

ligjeve hyjnore, ne jetojmë të qetë pa e ndjerë këtë shpejtësi marramendëse, sepse edhe atmosfera e tokës rrotullohet po me të njëjtën shpejtësi.

Në Kuranin Fisnik, aludohet edhe në të vërtetën e ndarjes së kontinenteve nga njëri-tjetri. Dihet se kontinentet largohen nga njëri-tjetri në drejtime të kundërta përreth 1 deri në 5cm për çdo vit. Ky zbulim i cili u bë në pjesën e parë të shekullit të 20, nga Alfred Wegener, në fillim nuk u mor seriozisht. Mirëpo, pas viteve 1980, ky zbulim u pranua si një realitet gjeologjik.

Gjithashtu, po në aspektin gjeologjik, në Kuran është folur edhe për rolin e rëndësishëm që kanë malet në lehtësimin dhe pakësimin e efekteve të tërmeteve:

“A nuk jua kemi bërë Tokën si shtrat e malet si shtylla?!” (Nebe’, 6-7)

Shtyllat e një çadre ngulen në tokë deri në gjysmën e tyre. Në Kuran është bërë e ditur se edhe malet janë të ngulitur në tokë në të njëjtën mënyrë:

“Kurse malet i përforcoi!” (Naziat, 32)

Në bazë të zbulimeve të shkencës së gjeologjisë në ditët e sotme, tregohet se struktura e poshtme e maleve është në formën e kunjave. Poshtë tyre ndodhet një shtresë si rrënjë që i mban ato.

Toka përbëhet nga tre shtresa, njësoj si një vezë me të verdhën, të bardhën dhe lëvoren e saj. Në qendër të Tokës ndodhet bërthama, sipër saj është manteli që mbështjellë dhe në krye ndodhet korja e Tokës. Korja e Tokës është e fortë si lëvorja e vezës, ndërsa magma që ndodhet poshtë saj është e nxehtë dhe e rrjedhshme. Korja e Tokës në fundin e oqeanëve, është e hollë (8-10 km), ndërsa në pjesët ku ndodhen malet e lartë, është e trashë (30-40 km).

Gjithashtu, malet kanë një rol të rëndësishëm në sigurimin e ekuilibrit të blloqeve të kontinenteve që notojnë mbi magmë. Mirëpo, kjo është zbuluar vetëm shekullin e shkuar. Ndërsa Kurani Fisnik, këtë fakt e ka shprehur në shumë ajete para 14 shekujsh. Në një prej këtyre ajeteve fisnike urdhërohet:

“... (Ai) ka vënë male të qëndrueshëm në Tokë, që ju të mos lëkunden...” (Lukman, 10)

Gjeofizika shpjegon se në Tokë janë evidentuar rreth 110 masa të mëdha malesh të cilat quhen “pika të nxehta”. Këto pika që pengojnë lëvizjen e kores së Tokës, janë masa të mëdha magme të cilat janë ngritur prej thellësive të Tokës dhe, pasi kanë shpuar koren saj, janë forcuar/ngurtësuar dhe kanë marrë formën e perçinave, duke siguruar kështu qëndrueshmërinë e kores.



ER-REZZAK

AI QË FURNIZON NË MËNYRË TË VAZHUESHME, TË NDRYSHME DHE TË BOLLSHME

— Ilir Hoxha —

Njeriu ka nevojë për shumë mirësi të dukshme dhe të padukshme, me qëllim që të vazhdojë jetën e tij. Dhe ai që mund t'ia sigurojë të gjitha këto, është Allahu i Madhëruar me cilësinë e Tij er-Rezzak. Madje, furnizimi i Zotit tonë nuk është vetëm në këtë botë, por vazhdon edhe në botën tjetër... Ai i krijon të gjitha gjërat që bëjnë të mundur vazhdimësinë në mënyrë të shëndetshme të trupit, mendjes dhe shpirtit tonë... Ai na furnizon me to dhe na jep mundësinë të përfitojmë prej tyre. Ashtu siç është ushqimi për trupin tonë, ashtu është edhe dija për mendjen tonë, edhe shpresa dhe dashuria për zemrën tonë. Le të mos na mashtrojë fakti që të gjitha këto mirësi ndodhen nën hundën tonë... Nëse Allahu nuk i ka caktuar si furnizim për ne, nuk mund ta gëlltitim as kafshatën që kemi futur në gojë, nuk mund të kuptojmë asnjë libër që lexojmë dhe nuk mund të jemi rehat edhe nëse e kemi çdo gjë në rregull.

Furnizimi i trupit është ushqimi, furnizimi i mendjes është dija, kultura dhe urtësia, furnizimi i zemrës është dashuria, butësia dhe mëshira, ndërsa furnizimi i shpirtit është besimi, devotshmëria, bindja dhe dorëzimi ndaj Allahut. Furnizimet e trupit kanë nevojë për shiun që bie nga qiell dhe rrezet që vijnë nga dielli. Po në të njëjtën mënyrë, edhe burimi i furnizimit shpirtëror, që është grada më e lartë e furnizimit, është shpallja si një mirësi hyjnore që vjen prej qiejve.

Në Kuranin Fisnik, çdo gjë që ne kemi nevojë në këtë botë, qoftë materiale apo shpirtërore, është cilësuar si rrizk/furnizim. (shih. Hud, 6; Xhathije, 5.) Në të njëjtën mënyrë janë cilësuar edhe mirësitë që do të kemi në botën tjetër. (shih. Al-i Imran, 169; Merjem, 62; Haxh, 58.) Duke filluar prej besimit, edhe feja e Allahut, edhe udhëzimi i Tij janë rrizk. Po ashtu edhe profetësia është një rrizk i madh, të

cilin vetëm Ai e vendos se kujt ia jep. Përkrah këtyre, edhe ndjenjat që i përkasin jetës shpirtërore të njeriut, edhe gjërat për të cilat kanë nevojë ato ndjenja, janë të gjitha rrizk prej Allahut.

Disa njerëz, të gjitha mirësitë që i kanë arritur si rezultat i përpjekjeve të veta, i konsiderojnë thjesht si arritje personale, megjithëse Allahu është Ai që u ka dhënë potencialin dhe mundësitë për t'i fituar ato... Për rrjedhojë nuk mund të mendohet kurrë që mirësitë mund të fitohen vetëm me punën dhe përpjekjet personale.

Lidhur me këtë, Kurani Fisnik na lajmëron se Allahu është Ai, i cili farës që hidhet në tokë, i siguron shkaqet për të çelur e lulëzuar, që zbret ujin nga retë dhe që i jep zjarrit forcën për të djegur. (shih. Uakia, 58-73.)

Të mendosh se çdo gjë që arrijmë është si rezultat i përpjekjeve tona, e jo mirësi e Allahut, e çon njeriun në një devijim të atillë, që e largon atë nga vetëdija se një ditë do të japë llogari për ato mirësi. Allahu i Madhëruar i ka dhënë njeriut kapacitetin për kuptuar cilësitë e gjërave dhe për të zbuluar të gjitha parimet dhe ligjet me të cilat funksionon natyra. Të gjitha këto janë shkaqe të furnizimit dhe mirëqenies së njeriut. Po ashtu, Allahu ka krijuar me bollëk çdo gjë për të cilën kemi nevojë në këtë botë, duke na furnizuar me to dhe duke na dhënë edhe aftësitë për t'i arritur ato.

Allahu i Madhëruar ia shpërndan rrizkun çdo krijese të Tij në mënyrë të mjaftueshme, por në sasi të ndryshme. (shih. Sebe', 39; Zumer, 52.) Në më tepër se dhjetë ajete të Kuranit Fisnik, flitet se Allahu i Madhëruar ia shton rrizkun me bollëk kujt të dëshirojë dhe ia ngushton ose i jep pa hesap kujt të dëshirojë. (shih. Rum, 37; Ankebut, 62; Sebe', 36.)

Nisur nga kjo, mund të themi se varfëria nuk është



prerje e rrizkut, por ngushtim i tij. Këto ndryshime janë me qëllim që të sprovohemi nëse do të jemi të kënaqur prej Zotit tonë apo jo. Por në të njëjtën kohë, këto janë edhe faktorët që i bëjnë njerëzit të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, duke u bërë shkak i rrizkut të njëri-tjetrit, gjë e cila mbart në vetvete edhe mundësinë për të ndërtuar këtë botë. Në fakt, sprova nuk është vetëm për atë të cilit i ngushtohet rrizkut, por edhe për atë njeri të cilit i është dhënë rrizk me bollëk, ndërkohë që para tij ndodhen shumë njerëz në vështirësi. Përveç kësaj, dhënia e rrizkut me bollëk, nuk përfundon gjithmonë në mënyrë pozitive. Në Kuran urdhërohet: **“Sikur Allahu t’i shtonte mjetet e jetesës për robërit e Vet, ata do ta mbushnin Tokën me mbrapshti. Por Ai u jep me masë, sa dëshiron, sepse Ai i njeh dhe i sheh mirë robërit e Vet.”** (Shura, 27.)

Dikush më pak, e dikush më shumë, të gjithë shqetësohemi në lidhje me rrizkun. Ndonjëherë situata shkakton aq panik, ose kriteret tona lëkundën aq shumë, sa që duke u arsyetuar se punojmë shumë për të fituar rrizkun, mund të neglizhojmë edhe detyrat e devotshmërisë ndaj Zotit tonë. Në Kuranin fisnik, paralajmërohem në dy vende në lidhje me neglizhimin e këtyre detyrave. Një është në lidhje me jetën tonë të adhurimeve, ndërsa tjetra në lidhje me edukimin fetar të fëmijëve tanë:

“Xhindet dhe njerëzit nuk i kam krijuar për tjetër, përveçse të Më adhurojnë Mua. Unë nuk kërkoj prej tyre rrizk, as nuk dëshiroj që të Më ushqejnë. Vërtet, Allahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotpushtetshmi.” (Dharijat, 56-57.)

“Urdhëroje familjen tënde, që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë! Ne nuk të kërkojmë ty ndonjë ushqim: jemi Ne që të ushqejmë! Përfundimi i lumtur qëndron në frikën ndaj Allahut.” (TaHa, 132.)

Robi që beson se Allahu është Furnizues, i Cili jep pandërprerë dhe me bollëk, nuk pret furnizim prej askujt tjetër përveç Allahut dhe nuk i mbështetet askujt tjetër në lidhje me këtë çështje. Edhe nëse në dukje është dikush tjetër që ia sjell rrizkun, në të vërtetë, edhe ai jep atë që i është dhënë.

Drejtuesit që bëhen shkak për furnizimin e robërve të Allahut, janë krijesa të zgjedhura, tek të cilat manifestohet emri Rezzak i Allahut të Madhëruar. Për këtë arsye, ata duhet të jenë të vetëdijshëm ndaj këtij misioni që kanë dhe duhet ta përfaqësojnë në mënyrën më të mirë emrin Rezzak. Ashtu si Allahu,

i Cili kur furnizon robërit e Vet nuk shikon nëse janë besimtarë apo mohues, por u jep shpërblimin e punës së tyre, ashtu edhe drejtuesit duhet të shohin punën që bëhet dhe jo ta paguajnë punën sipas besimit të punëtorit, por sipas drejtësisë.

Mendja dhe vullneti janë dy veçoritë tona më të rëndësishme që na bëjnë njeri dhe dy mirësitë më të mëdha me të cilat na ka furnizuar Allahu i Madhëruar. Në sajë të këtyre dy veçorive ne kemi mundësinë të arrijmë furnizimet e tjera që na duhen për të vazhduar ekzistencën tonë materiale dhe shpirtërore. Përdorimi i këtyre veçorive në mënyrën dhe kapacitetin e duhur, siguron kërkimin e furnizimit tonë ashtu siç duhet. Përndryshe, nëse ne nuk i përdorim mundësitë që Allahu na ka dhënë për të arritur furnizimin, kjo do të thotë të qëndrojmë duke kërkuar vazhdimisht rrizkun prej Tij dhe t’ia dorëzojmë përsëri Atij përgjegjësitë që Ai na ka dhënë.

Në Kuranin Fisnik urdhërohet që, në vend që njeriu të strehohet në një botëkuptim të gabuar të mbështetjes tek Allahu, ai duhet të kërkojë rrizkun në tokë dhe në dete. (shih. Fatir, 12; Mulk, 15.) Ndërsa në ajetin 114 të sures Nahl, Zoti ynë urdhëron: **“Ushqehuni me gjërat e lejuara dhe të mira që jua ka dhënë Allahu dhe falënderoni për mirësitë e Allahut, nëse vërtet e adhuronit Atë.”** Në këtë ajet kuptohet qartë se ne duhet të bëjmë kujdes që rrizku ynë të jetë hallall dhe i pastër. Dhe hallalli apo harami mësohet nga feja, ndërsa e pastra dhe jo e pastra mësohet nga shkenca. Për këtë arsye, ne kemi shumë nevojë për udhëzimin e këtyre dy fushave gjatë kërkimit të rrizkut tonë. Ushqimi i papastër prish trupin, ndërsa ushqimi haram prish shpirtin. Ushqimi me harame të çon lehtë në gjynahe, ndërsa ushqimi me hallalle të çon në sjellje të mira. Për këtë arsye, ata që nuk heqin dot dorë nga të këqijat edhe pse nuk i aprovojnë ato, duhet të shohin përsëri se në cilën rrugë e sigurojnë rrizkun e tyre.

Ajo që i ka hije njeriut, është që ashtu siç punon e përpiqet për të fituar rrizkun material, duke përfutur plotësisht prej tij, ashtu të përpiqet edhe për të fituar rrizkun shpirtëror e të përfitojë maksimalisht prej tij.

Refleksione

— Nuredin Nazarko —

38. Shpirtligu gjithmonë do të avitet duke u sjellë si viktimë e fatit. Nëse bie në kurthin e tij e vetmja dhuratë që do të marrësh do të jetë qelbi ligësisë. Lahu me ujë trëndafili në do të shërohesh.
39. Mos u tut nga të bërit mirë. Gjurmët e mirësisë do të ndriçojnë si kandilë në ditë të errëta.
40. Fuqia varet nga lloji ushqimit. Dërgoje veten në hapësira të blerta e të lulëzuara që të rinohesh e dritërohesh.
41. Smira që endet përbrenda të çon në lëngata të padëgjua. Dhimbjet e lëngatës i shuan vetëm me keqbërje, ndryshe pëlçet.
42. Tri janë ngjyrat që i japin ngjyrë jetës. E bardha, e kuqja, e zeza. Prite dhe përcille secilën në kohën e vet. Mos e lër mangut respektin për asnjë prej tyre.
43. Mos u brengos nëse një kohë lodhesh shumë e fiton pak. Një ditë do t'i vjelësh frutat e mjeshtërisë. Nuk humb puna e punëmit kurrsesi.
44. Nëse pushtohesh nga lakmia për pasuri nuk do të ngurrosh të komplotosh edhe kundër gjakut tënd, vetëm e vetëm që pjesa e dikujt të bëhet e jotja.
45. Pas fytyrave që e kanë lëkurën të lëmuar dhe të japin ndjesinë e së bukurës kur i kundron, mund të fshihen shpirta të errët. Koha do ta shpërbëjë lëkurën e lëmuar dhe shpirti lakuriq do të flasë me gjuhën e ligësisë.
46. Nëse ke diçka që është burim i fuqisë tënde mos ia rrëfe kurrkujt, madje as të afërmve, sepse nuk do të vonojë e do të goditesh në pikën më të dobët. Smira nuk njeh lidhje gjaku e miqësie.
47. Nuk është për t'u besuar djallëzorëve. Në do të shpëtosh prej ligësisë së tyre bëj sikur i beson dhe lejoji të vetkënaqen me sukseset e mashttimeve të tyre. Në iu besofsh seriozisht kimive të tyre mashtroese e humbe eliksirin e jetës.
48. Grabitësi përpiket ta fshehë mirë gjënë e grabitur. Fshehja tregon frikë, e frika tregon se ka përballë njerëz që mund t'ia zhbëjnë padrejtësinë. Në ndodhtë që të mos e fshehë gjënë e grabitur, do të thotë që njerëzit e atjeshëm janë pajtuar me të keqen.
49. Nëse mes miqësisë fillon e zë vend pushteti parasë, gjërat do të marrin tatëpjetën. Vetëm të mençurit mund ta kaptojnë tatëpjetën dhe të ringrihen mbi pushtetin e parasë, për të mbledhur e bashkuar forcat.
50. Fjalën e të urtëve mos e nënçmo. Ajo është kandil dhe udhërrëfyes që nuk të lejon të humbësh udhë edhe në ditët më të errëta.
51. Prano ndihmën që të jepet kur duhet luftuar padrejtësia e të ligut. Bërja bashkë e të mirëve është kusht i patjetërsueshëm për thyerjen e së keqes.
52. E drejta pa fuqi nëpërkëmbet dhe mbyllet në qeli të gurta rrethuar me gardhe ferrash. Duhet një shpirt i drejtë dhe një krah i fuqishëm ta çlirojë.
53. Karakteret negative janë më të akullt se acari e më zhuritës se era e nxehtë e Saharasë. Në do të shpëtosh shpirtin tënd, qëndro larg.
54. Butësia dhe fjalët e ëmbla çajnë dhe zemrat më të ashpra. Nëse nuk i ke, lutu që t'i kesh, përndryshe ke humbur shumë.
55. Mos bëj keq! Bëj mirë dhe lëre mirësinë të fluturojë si zog shtegtar. Mos e ndry në ka-

fazin e egoizmit.

56. Njeriu është jetimi që fati fati asnjëherë nuk e braktis.
57. Kudo ku shkel këmba e të ligut dhe smirëziut as bari nuk mbin. Të tillë syresh në syrgjyn duhet të braktisen.
58. Në qofsh i dobët, jetim a i varfër me siguri do të të shpërfillin e nënçmojnë. Mos u ligështo e mos u jep. Ka ende gjëra për të të dhënë jeta. Prit çastin e duhur.
59. Moti është thënë se tahmaja e madhe të lë pa gjë. Mos e çel atë derë! Mbylle me drynin më të rëndë, e çelësin hidhe në thellësitë e errësirave të deteve.
60. Mos u trego i paduruar me atë që fati të ka dhënë. Ti nuk e di se çfarë të mire ke përjetuar e as nga çfarë e keqe ke shpëtuar.
61. Secili e përjeton jetën sipas karakterit dhe shpirtit që ka. I njëjti diell i ngroh të gjithë, por jo të gjithë ngrohen njëllë.
62. Në mbretëroftë dashuria e vërtetë ndërmjet dy njerëzve nuk ka shtrigë e shtrigan që t'i ndajë. Edhe në ndodhtë, një ditë shtriganët do të bëhen hi nga e keqja e tyre, dhe sërish dashuria e vërtetë do të mbretërojë.
63. Kush lakmon tepër nuk e ka për gjë edhe vrasës të bëhet. Duhet bërë kujdes. Një çast i vetëm mund të përmbysë gjithçka.
64. Në çaste të vështira një fjalë e mirë, një këshillë e drejtë, e urtë, vlen më shumë se gurët e çmuar.
65. Duhet të mposhtësh veten për të rrojtur gjatë miqësia me të tjerët.
66. Jo gjithmonë do t'i admirojnë sukseset e tua. Patjetër që do të mbijnë nga dheu të egrit smirëzinj. Përgatit një mbrojtje të mirë për veten.
67. Nëse pranë të gjendet një mik i singertë dhe besnik, pranoi këshillat e tij dhe duroji vepimet e tij. Në rast se të shkon ndërmend të veprosh kundër tij, ndalu dhe kujto mirësitë që të ka bërë.
68. Nëse humb një mik të singertë e të drejtë qaj e derdh lotë të nxehtë vaji. Humbje më të rëndë se në betejë ke pësuar.
69. Ç'ka mbi tokë e gjen nën tokë.
70. Mos të të lëshojë zemra edhe kur je i rrethuar nga lukunitë e së keqes. Mos harro! E ardhmja po të pret.
71. Koha rrjedh e jetën do ta gjesh ashtu si zemra jote është.
72. Fati i shpërblen të gjithë sipas asaj që iu fle ndër zemër. Më shumë shpërblen atë që di se çfarë të kërkojë për të kaluar jetë fisnike.
73. Çdo problem ka zgjidhjen e vet. Duhet të gjesh fjalët e duhura që dyert e zgjidhjes të çelen.
74. Mirësitë janë mbështjellë me lëvozhgën e së keqes. Duhet guxim për të thyer lëvozhgën.
75. Mirësitë e jetës janë si thesaret. Duhet gërmuar thellë ndër gërmadha për t'i gjetur.
76. Mos u lodh të kesh atë që nuk do të të ketë. Nëse lodhesh vetes nuk je duke i rezistuar. Duhet të flesh e të kthjellohesh.
77. Jo të gjitha gjërat zbrazen menjëherë në shesh. Duhet të kesh durim të presësh kohën e duhur, edhe pse nga brenda të djeg zjarri i dëshirës për të përhapur atë që di.
78. Merr ç'vendime të duash. Në fund do të ndodhë ajo që është parathënë.
79. Kurrë mos u përpqi të fitosh në kurriz të diturive të tjetrit. Prano kufizimet e tua, kënaqu me çfarë ke dhe lutu për më mirë.
80. Njeriu ka nevojë për atë që i kthjellon mendjen e jo për atë që i merr mendjen dhe e çon drejt trazimeve e dalldive.
81. Padrejtësia luftohet me të njëjtën forcë që ajo lufton drejtësinë.
82. Informohu vazhdimisht mbi ngjarjet e njerëzve që të rrethojnë. Do t'u paraprish të ligave e do të çelësh dyer mirësie.
83. Ruaji dhe mbuloji të fshehtat e tua. Të ligjtë me të gjetur rastin e volitshëm do të godasin me gjithë fuqinë e tyre.
84. Potencialet dhe aftësitë që të janë dhënë përdori për të bërë mirë. Në mos i pëlqeftë ndokujt ajo çfarë bën në shërbim të së mirës, mos u vleros. Shpejt vjen dita në të cilën gjen aromën e mirë të të mirave që ke kryer.
85. Bamirësit e tu nderoji dhe pas vdekjes së tyre. Kurrë mos i harro ata që t'u gjenden pranë në momente të vështira. Nderoji shenjat e tyre. Nderoje kujtimin e tyre.
86. Më shumë sesa krahët duhet përdorur mendja. Peshoji gjërat dhe kupto se nga anon, nga ata që duhet të përdorin krahët apo nga ata që duhet të përdorin mendjen.



Poezia

si dëshmi për atë që kemi humbur

— Edison Çeraj —

Le ta nisim me një tautologji: të lexosh poezi është një përvojë krejt tjetër krahasuar me çdo gjini tjetër të shkrimisë. Nëse çdo gjë është një pamundësi e përkryer, në poezi kemi një tejkalim të këtij “fakti” për hir të një kujtese e cila nuk ka lidhje me kujtimet si qenie-në-botë, por me udhëtar-në-botë. Pra, poezia na kujton se vijmë nga diku e shkojmë drejt një destinacioni, pa e ndjerë peshën e një rrethi vicioz apo ankthin e një udhëtimi të mbyllur.

Po të bëjmë një krahasim me prozën, mund të themi se proza na sfidon për të bërë një ndryshim apo për të ndërmarrë një hap të caktuar, kurse poezia na pranon siç jemi, duke na u ofruar si një ilaç për harresën, ose si një ilaç kundër shtresa të njëpasnjëshme me të cilat jemi pleksur e që na kanë larguar nga vetja, që na kanë ndryshuar ose na kanë bërë të huaj me veten. Poezia është një ilaç i hidhur që pak vetë e marrin mundimin ta provojnë, sidomos në këtë kohë kaq të mbërthyer nga labirinti i dendur i prozës.

Të lexosh poezi është të kalosh në një dimension sa të munguar e po aq të njohur për ne. Na ndërmend vazhdimisht diçka, pa qenë në gjendje ta shprehim se çfarë. Nga ana tjetër, kur ia themi vetes, jemi të bindur se çfarë. Kjo na kujton një reflektim domethënës të Shën Agustinit, ku thotë se “nëse më pyesin për kohën, nuk e di përgjigjen; e nëse nuk më pyesin, e di”.

Veç një shenjë. Një rikthim. Dhuntia e hijeve dhe dallgëve

nuk do të thotë asgjë, ndërsa kapton masë dhe kufij.

Qepeni mërmërit dhe pulsi i ligjërimin dhe flakës është vetë përjetësia, që ndehet pa sy mbi tokë.

(Venclova)

Proza është kërkim, poezia gjetje. Nëse proza kërkon tjetrin te ne, poezia sikur na kumton që duhet të jemi pikërisht siç jemi (si thelb), sepse unikja është vlera më e rrezikur në një realitet të mbushur cit nga prodhimi dhe konsumi. Edhe dhuntia e prodhimit dhe konsumit nuk do të thotë asgjë, pasi përtej tyre nis të jetuarit, duke lënë pas të gjalluarit. Pasi të çlirohem nga nevoja e prodhimit dhe konsumit, – gjë që e bëjmë herë pas herë, qoftë edhe pa vetëdije – nis përjetësia.

*Çdo asgjë mbahet në vend të vet,
qoftë edhe pa ne. Bota ende mëshon,
dhe vetëm muzat dhe heshtja
mund të thuhet me hak që rrojnë.*

(Venclova)

Poeti na kujton se ne e “njohim” asgjënë në saje të gjë-së. Bota ende mëshon, pra graviteti i saj vazhdon (deri në entropi?), qoftë ai i pari, si ligj fizik; qoftë i dyti, si joshje ndaj “këtu dhe tani”. Heshtja dhe asgjëja mund të lidhen në disa mënyra me njëra-tjetrën. Jo çdo hetshje është asgjë, ama çdo asgjë është njëkohësisht edhe heshtje, nga ajo më e kulluara, me një çmim të lartë.

Një prej ligjeve të poezia është gjetja, gjë që vlen si për autorin ashtu dhe për lexuesin – ndoshta jo për atë lexues që e lidh leximin me të ashtuquajturën kohë e lirë, pasi më së pari, që të gjesh në poezi, duhet të çlirohesh nga koha fizike.

*Po lexoj një poezi kineze
shkruar njëmijë vjet më përpara.
Autori tregon për shiun
që binte gjithë natën
në çatinë prej bambuje të barkës
dhe për paqen që më në fund
u strehua në zemrën e tij.*

(Zagajevski)

Kjo strofë na përball me magjinë e poezisë brenda poezisë, për të na kujtuar kështu ato çaste jo dhe aq të pakta të përjetësisë brenda të përkohshmes; për të bukurën strukur diku tek e shëmtuara; për të shenjtën fshehur në sasinë e pamatë të profanes; për yjet e marrë peng nga llambat elektrike; për artin e përdorur nga spektakli; për diellin e mbluar nga retë e ngjyera me terr; për trëndafilin e mbërthyer nga gjembat; për një shkëndijë të vogël që sfidon errësirën e pakufishme të universit.

“Hamenda vesën mbi kërna e prazmore.”

(Heaney)

*Sa shumë kam hjekë
per me gjetë një dhuratë për Ty
e asgja nuk m'u duk me vlerë
e si munen me u çue mineralet n'minierë?
po uji n'det?
çdo gja qi m'ra nermend
si me çue erza n'Orient m'u dukt, po per besë!
sikur zemren e shpirtin tem me t'i dhurue
Ti i ke te dyja
pranej t'pruna një pasqyrë
kqyre Vedin aty e m'kujto edhe mue.*

(Rumi)

Mbase në vargje të tilla qëndron thelbi i asaj që na kujton poezia: fillimisht një mohim në trajtë dorëzimi, e më pas një pohim çlirues, që shënjon atë çfarë kemi humbur, që mund ta gjejmë në një ritual të herëpashershëm rikthimi.



Vëllai i madh i Aliut ﷺ

Akil ibn Ebi Talib ﷺ

— Mustafa Erish —

Akil ibn Ebi Talibi (r.a.), ishte një sahab i nderuar, që mori lavdërimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.): “Unë të dua ty për dy arsye.”

Ai ishte djali i dytë i madh i xhaxhait të të Dërguarit të Allahut (a.s.), Ebu Talibit.

Ai ishte vëllai i Aliut (r.a.), njëzet vjet më i madh. Kur kishte mosmarrëveshje ndërmjet kurejshëve, thirrjet për të gjykuar. Ishte njëri prej katër vetave që respektoheshin më së shumti.

Ai ka lindur në Mekë në vitin 580 e.s. Në ditët kur drita e Islamit ndriçoi botën, si një i ri ndjeu afërsi ndaj Islamit, por nuk e pranoi dot menjëherë. Çdo gjë ngeli vetëm në shkallën e dashurisë. Gjithashtu, nuk shfaqti ndonjë veprim që e mohonte Islamin. Ai hezitoi nga gjendja sociale e shoqërisë dhe torturat që politeistët mekas u bënin myslimanëve. Për këtë arsye, nuk e shprehu dot mendimin e tij. Nderimit të tij me Islam iu desh një kohë e gjatë.

Për sa i përket vitit se kur është bërë mysliman, ka transmetime të ndryshme. Sipas disave prej tyre, Islamit e ka pranuar para Marrëveshjes së Hudejbijes. Por sipas disa të tjerëve ai ka pranuar Islamit menjëherë pas kësaj marrëveshjeje. Por të dhëna të tjera na tregojnë se ai mund ta ketë pranuar Islamit para çlirimit të Mekës në vitin 630 e.s.

Pasi Akil ibn Ebi Talibi (r.a.), u bë mysliman, nuk qëndroi më në Mekë, menjëherë emigroi në Medinë. Këtej e tutje, jetën e tij e kaloi pranë të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Ai asnjëherë nuk u largua nga Pejgamberi ynë i nderuar në Mesxhidu'n-Nebevi. Fali namaz bashkë me të dhe dëgjoi ligjëratat e tij.

Ai kishte një dije të gjerë për prejardhjet dhe për historinë. Me këtë cilësi kreu detyra të rëndësishme ndërmjet njerëzve të fisit Kurejsh në kohën e Xhahilijetit. Ai u respektua si njëri prej katër vetave që i merrnin për të gjykuar kur kurejshit kishin mosmarrëveshje ndërmjet tyre. (Isabe, IV, 438-439.)

Ngaqë ngeli nën presionin e mushrikëve të Mekës, ai luftoi përkrah tyre në Luftën e Bedrit. Këtë gjë ai e

bëri pa dëshirë, duke qenë i detyruar. Më së fundi, në këtë luftë ai ra rob në duar të myslimanëve. Nuk ishte në gjendje të paguante shpagim për t'u liruar. Kështu, shpagimin për lirimin e tij e bëri xhaxhai i vet, Abbas ibn Abdulmuttalibi. Pasi u paguan 4000 dërhëm, ai shpëtoi nga robëria, pra u la i lirë.

Akil ibn Ebi Talibi, (r.a.), para se të bëhej mysliman, ishte i varfër. Pasi bëri hixhret, u varfërua edhe më shumë. Kjo ishte arsyeja për të cilën, i Dërguari i Allahut, (a.s.), pas luftës së Hajberit, i lidhi atij një pagë vjetore. Ai nuk kishte të ardhura të tjera, kalonte vetëm me këtë pagë.

Akil ibn Ebi Talibi (r.a.), e donte shumë Pejgamberin (a.s.). Sa herë i jepej mundësia, mendohej t'ia shprehte të Dërguarit të Allahut (a.s.), lidhjen dhe dashurinë që kishte për të. Edhe Pejgamberi, Dielli i dy botëve e donte shumë. Një ditë e lavdëroi kështu:

“O Akil! Unë të dua për dy arsye. E para ngaqë të kam të afërt, e dyta ngaqë e di se xhaxhai im të donte shumë.” (Dhehebi, Sijeru alami'n-nubela, I, 218-219; Ibn Sa'd, IV, 42-44.)

Akil ibn Ebi Talibi (r.a.), tregonte shumë kujdes dhe ishte shumë i rregullt në çështjen e praktikimit të Sunetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ai i këshillonte njerëzit përreth që të qëndronin larg zakoneve të injorancës dhe atyre që bënin bidate duke u kujtuar hadithin fisnik: “Mos rrini me ata që bëjnë bidate! Mos hani e mos pini me ta!”

Ndërsa në një tjetër hadith fisnik të transmetuar po nga ai, ka bërë të ditur se i Dërguari i Allahut (a.s.), është lutur kështu për çiftet e martuara. Kështu, sipas transmetimit të Hasan Ibn Hasenit, kur Beni Xhushem u martua me një grua, e uruan duke i thënë “Me jetë dhe me fëmijë të mbarë!” Kurse Akil ibn Ebi Talibi i kishte këshilluar që të bënin lutjen që bënte i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe kishte thënë: “Allahu ju bekoftë ju dhe martesën tuaj dhe ju dhëntë bereqet!” (Nesai, Nikah, 73.)

Akil ibn Ebi Talibi, (r.a.), dhe familja e tij ishin nga Ehli Bejti. Këtë e mësojmë nga ky transmetim i Zejd

ibn Erkamit (r.a.).

Jezid ibn Hajjani (r.a.), tha kështu:

“Një ditë bashkë me Husejn ibn Sebre dhe Amr ibn Muslimin shkuam në shtëpinë e Zejd ibn Erkamit. Pasi u ulëm pranë tij, fjalën e mori Husejn ibn Sebre, i cili tha:

“O Zejd! Ti ke pasur fatin të kesh shumë mirësi. Ke parë të Dërguarin e Allahut (a.s.), i ke dëgjuar fjalën, ke marrë pjesë në luftëra përkrah tij dhe ke falë namaz pas Tij. Të them të drejtën ke arritur një lumturi të madhe. Na trego edhe ne nga ato që ke dëgjuar prej Pejgamberit, (a.s.)!” Nisur nga kjo kërkesë që i bëri, Zejdi tha:

“Nipi im! Për Zotin jam plakur shumë. Ka kaluar shumë kohë. Një pjesë nga ato që kam dëgjuar e kam mësuar prej të Dërguarit të Allahut (a.s.), i kam harruar. Prandaj ngulitini mirë në mendje këto që do t’ju them. Ndërsa për ato që nuk do t’ju tregoj, mos këmbëngulni!” Pastaj vazhdoi:

“Një ditë i Dërguari i Allahut, (a.s.), u ngrit në këmbë në krye të burimit Hum që ndodhej ndërmjet Mekës e Medinës dhe na mbajti një fjalim. Pasi falënderoi Allahun Teala, na këshilloi e na tha:

“O njerëz! Edhe unë jam një njeri. Së afërmi lajmëtar i Zotit do të më vijë edhe mua dhe unë do ta pranoj ftesën e tij e do të iki nga kjo botë. Juve po ju lë dy gjëra. Njëri është Kurani, libri i Allahut që është udhëzuesi dhe drita që e drejton njeriun në rrugë të drejtë. Kapuni fort pas tij! Po ju lë gjithashtu edhe Ehli Bejtin tim (familjen time). Kijeni frikë Allahun dhe silluni me respekt ndaj Ehli Bejtit! Kijeni frikë Allahun dhe silluni me respekt ndaj Ehli Bejtit!”

Husejn ibn Sebre (r.a.), pyeti: “O Zejd! Kush është Ehli Bejti i të Dërguarit të Allahut? A nuk konsiderohen bashkëshortet e tij prej Ehli Bejtit?”

Zejdi (r.a.), tha: “Edhe gratë e tij janë prej Ehli Bejtit. Por Ehli Bejti i vërtetë i tij janë ata që e kanë haram të marrin sadaka pas tij.”

Husejni (r.a.), tha: “O Zejd! Kush janë ata që e kanë të ndaluar të marrin lëmoshë?”

Zejdi u përgjigj: “Janë: familja e Aliut, familja e Akilit, familja e Xhaferit dhe familja e Abbasit.”

Husejni pyeti përsëri: “Të gjithë këta e kanë haram të marrin lëmoshë?”

Zejd ibn Erkami (r.a.), iu përgjigj: “Po!” (Muslim, Fedhailu’s-sahabe, 36.)

Akil ibn Ebi Talibi, (r.a.), e transmeton kështu një kujtim në të cilin tregon se i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk hoqi dorë nga predikimi i fesë edhe në kushtet më të vështira:

“Një ditë, një grup nga kurejshët erdhën te babai im, Ebu Talibi dhe iu ankuan duke i thënë: “Ky djali i vëllait tënd na shqetëson në kuvendet tona! Ndaloje atë prej këtij veprimi!”

Babai më thirri mua dhe më tha: “O Akil, shko dhe më sill Muhamedin!”

Unë shkova menjëherë. E gjeta atë në një shtëpi të vogël prej shtëpive të familjes së Ebu Talibit. I thashë

se e thërriste babai. Të dy së bashku dolëm në kohën më të nxehtë të drekës. Për shkak të nxehtësisë përveçuese të rërës, ai kërkonte hije dhe mendohej të ecte nga hija. Ndonëse me vështirësi, arriti të shtëpia e Ebu Talibit. Babai e pa atë me mëshirë e dashuri dhe i tha:

“Këta kushërinjtë thonë se i ke shqetësuar në kuvendet e tyre. Të lutem mos i shqetëso më ata!”

Pas këtyre fjalëve i Dërguari i Allahut (a.s.), drejtoi fytyrën nga qielli, nguliti sytë drejt tij dhe i pyeti kurejshët që ndodheshin pranë xhaxhait të tij:

“A e shikoni këtë diell?”

“Po”, thanë ata.

I Dërguari i Allahut (a.s.), tha gjithë seriozitet:

“Ashtu siç ju nuk keni fuqinë të merrni nga ky diell qoftë edhe një gacë zjarri, as unë nuk kam fuqinë të heq dorë nga ky predikim.”

Kështu ai u tregoi atyre mjaft qartë dhe me shprehje të spikatura se nuk do të hiqte kurrë dorë nga kauza e predikimit të Islamit. Kur pa këtë vendosmëri të nipit të tij, Ebu Talibi u tha kurejshëve:

“Për Zotin! Djali i vëllait tim nuk na ka gënjer asnjëherë deri më sot. Prandaj, ngrihuni dhe largohuni!” Ai i përcolli ata duke u thënë që të mos i përziheshin më në punët e nipit të tij. (Ibn Is’hak, 136; Hakim, III, 668/6467; Hejsemi, VI, 15.)

Me informacionin e thellë që kishte për traditat e zakonet, historitë dhe legjendat e kohës së xhahilijetit (injurancës), Akil ibn Ebi Talibi (r.a.), respektohej shumë ndërmjet fiseve fqinje. Pasi u bë mysliman, ngaqë i njihte mirë zakonet që i përkisnin kohës së xhahilijetit, e dinte mjaft mirë se ngase duhej të hiqte dorë.

Ai u nderua me jetë të gjatë dhe përgjigje të çastit. Jetoj më shumë se njëqind vjet. Duke mbajtur anën e Hazreti Husejnit (r.a.), në mosmarrëveshjen që ai pati me Jezidin, bëri një veprim mjaft të rëndësishëm.

Ishte vet i treti vëlla prej një nëne, dhjetë vjet më i madh se Xhafer et-Tajjari (r.a.) dhe njëzet vjet më i madh se Hazreti Aliu (r.a.). Atij i thoshin edhe Ebu Jezid. (Istiab, III, 1078-1079; Isabe, IV, 438-439.)

Akil ibn Ebi Talibi (r.a.), bashkë me vëllain e tij, Xhaferin morën pjesë në luftën Mu’tes. Gjatë kthimit e kapi një sëmundje që i zgjati shumë. Për shkak të kësaj sëmundjeje nuk mundi të merrte pjesë në luftërat e mëvonshme. Dihet se ka marrë pjesë vetëm në Luftën e Hunejnit. Madje transmetohet se në këtë luftë shfaqti heroizma të mëdha dhe se, në një çast kur të gjithë u shpërndanë, ai nuk u nda për asnjë moment nga i Dërguari i Allahut, (a.s.).

Akil ibn Ebi Talibi (r.a.), ishte i famshëm në fushën e letërsisë dhe në çështjen e përgjigjeve të rrufeshme. Ai ndërroi jetë në vitin 680 e.s. në periudhën e Muavijes (r.a.), apo në ditët e para të udhëheqjes së Jezidit. (Isabe, IV, 438-439.)

Allahu qoftë i kënaqur prej tij dhe na bashkoftë me të në Xhenetin e përhershëm! Amin!

Një këshillë prej zemre

Ferit Piku

Zoti ynë thotë në Kuranin famëlartë: “Nëse juve o besimtarë ju godet një fatkeqësi, atëherë mos harroni se edhe njerëzve të tjerë u kanë ndodhur fatkeqësi e këto ditë të kësaj dynjaje Zoti ia jep njerëzve dorë mbas dore e Zoti do t’i dijë ata që kanë besuar dhe prej tyre do të marrë dëshmitarë. Zoti nuk i do të padrejtët”. (Ali Imran: 140).

Është e vërtetë se ndonjëherë besimtarin e përplasnin dallgët e jetës dhe e lodhin shumë. Sprovat i vijnë njëra pas tjetrës dhe nuk e lenë të marrë frymë. Ndonjëherë besimtarit i duket se e drejta po vonon, fitorja nuk po vjen dhe ai lodhet dhe ndihet keq.

Por le ta këshillojmë këtë besimtar, që mund të jetë secili prej nesh dhe t’i kujtojmë ligjin e Zotit, që njerëzit sprovohen e sidomos njerëzit e mirë sprovohen më shumë. Ky është një ligj i lashtë, ligj që nisi me Ademin (a.s) e do të mbarojë me besimtarin e fundit, që do të jetojë mbi shpinën e kësaj toke. Ai është ligj i fortë e i pandryshueshëm. Është ligj i atij Zoti, që ka krijuar Ademin (a.s) dhe Iblisin, Ibrahimin (a.s) dhe Nemrudin, Musain (a.s) dhe faraonin, Muhamedin (a.s) dhe armikun e tij Ebu Xhehlin, besimtarin dhe jobesimtarin, të mirin dhe të keqin.

Për habinë tonë ky ligj sprovon më shumë besimtarët dhe ata që kanë besimin më të fortë. Ata që janë sprovuar më shumë kanë qenë profetët e Zotit.

Profeti (a.s) ka thënë: “Njerëzit që sprovohen më shumë janë profetët e Zotit e pas tyre sprovohen njerëzit sipas besimit që kanë. Ai që ka besimin e fortë, e ka sprovën e fortë, ai që ka besimin e dobët e ka sprovën e dobët. Zoti ia fal gënjahet be-

simtarit edhe kur gjembi i hyn në këmbë, derisa të ecë mbi shpinën e kësaj toke pa gjynahe”¹.

Ky është ligji i Allahut (xh.sh). Këtë ligj duhet ta pranojmë dhe me të duhet të jetojmë, sepse ne nuk e dimë se sa të mira ka fshehur Zoti pas sprovës.

Situata e muslimanëve në botë apo edhe në Shqipëri të bën të ndihesh keq dhe pesimist, saqë thua me vete: “A do të ketë një ditë të hajrit në jetën tonë? A do të triumfojë e mira dhe vlera në këtë vend?”

Jemi të gjithë njerëz me gjak dhe me shpirt e nuk jemi njerëz prej hekuri, prandaj duam apo nuk duam, ndikohemi nga kjo gjendje, por le t’i themi vetes tonë, që nuk duhet të bëhemi pesimistë, se pesimizmi nuk është nga cilësitë e besimtarëve, sepse ai vjen prej shejtanit të mallkuar dhe besimtari nuk e ndjek shejtanin.

Dëgjoni profetin e Zotit, Jakubin (a.s), i cili humbi dy djemtë e tij, Jusufin (a.s) dhe Benjaminin, madje humbi edhe shikimin në moshën e tij të pleqërisë. Atëherë kur mendohej se ai ishte më i dobët se asnjëherë tjetër, ai u tha djemve të tij: “..dhe shkoni o bijtë e mi dhe kërkoni vëllezërit tuaj e mos i këputni shpresat nga mëshira e Zotit, se shpresën tek mëshira e Zotit e këput vetëm jobesimtari”. (Jusuf: 87).

Nuk mund të jemi pesimistë dhe nuk na lejohet diçka e tillë. Prandaj thoni lamtumirë pesimizmit, sepse ai nuk ka vend në zemrat tona.

Ndoshta unë dhe ti, por dhe shumë besimtarë të tjerë ndihemi të huaj në këto ditë. Jemi pak e të vetmuar. S’kemi mbështetje e as përkrahje dhe

1. Buhariu.

në krahun tjetër armiqtë e Islamit janë shumë, por kjo nuk ka pse të jetë e habitshme. Jemi të huaj, sepse kjo fe nisi e huaj e profeti Muhamed (a.s) tha: **“Islami filloi i huaj dhe përsëri do të kthehet i huaj. Lum ata që janë të huaj, lum për ata që e mbajnë fenë edhe pse janë të vetmuar, edhe pse janë pak”**².

Ndoshta besimtari ndihet keq, sepse shikon se e keqja po triumfon dhe e drejta nuk duket asgjëkudi. Nuk është habi ta ndjesh diçka të tillë, sepse këtë e kanë ndjerë njerëz më të mirë se ne, e kanë ndjerë profetët e Zotit bashkë me besimtarët. Aq ngushtë e kanë parë veten saqë kanë thënë: “O Zot kur do të vijë ndihma Jote”! Allahu (xh.sh) thotë: **“Ndihma e Zotit është shumë afër”** (Bekare: 214) dhe pastaj ka ardhur ndihma e Zotit.

Lexoni në Kuran historitë e profetëve, apo historinë e profetit tonë (a.s). Ka kaluar situata aq të vështira, saqë nuk ta merr mendja se pse duhet të ndodhnin këto gjëra. Por Zoti i sprovon njerëzit dhe pas sprovës vjen fitorja, pas vështirësisë vjen lehtësimi.

Ne duhet t'i themi të gjithë bashkë JO pesimizmit, JO dorëzimit, JO dobësisë, se vallahi ndoshta nuk na e merr mendja, por jemi krijesat më të forta të Zotit.

A e dini se besimtari është krijesa më e fortë e Zotit?! Po, është krijesa më e fortë që ka krijuar Zoti i gjithësisë.

Kur Zoti krijoi tokën, ajo lëkundej. Atëherë Zoti urdhëroi të krijohen malet e ata e stabilizuan tokën. Kur melekët e panë diçka të tillë thanë: “O Zot sa krijesa të forta janë malet. A ka krijesë më të fortë se malet”? Allahu (xh.sh) u përgjigjet: **“Po, hekuri është më i fortë se malet”**. Melekët e pyetën përsëri Krijuesin e Universit: “A ka krijesë më të fortë se hekuri”?

“Po – tha Zoti – është zjarri”. Engjëjt pyetën përsëri: “A ka krijesë më të fortë se zjarri o Zot”? **“Është uji- u përgjigj Allahu (xh.sh)”**. “A ka krijesë më të fortë se uji o Zot – pyetën melekët”. Allahu (xh.sh) tha: **“Po, është era”**. Melekët vazhduan të pyesin: “A ka krijesë më të fortë se era o Zot”? Allahu u përgjigjet përsëri: **“Po, ai është robi im besimtar, i cili jep sadaka me dorën e djathtë dhe nuk e merr vesh e majta e tij”**. **“Kjo është krijesa më e fortë që kam krijuar”**³.

Prandaj t'i themi vetes tonë: “Ne jemi të fortë, sepse kemi me vete të Fortin, Allahun (xh.sh) e po të ishte për ne, nuk do të ishim askushi në këtë botë”. Por shpresojmë ta kemi Zotin me vete dhe Allahu (xh.sh) të na ketë pranë madhëstisë së Tij.

Sot duhet t'i flasim vetes dhe njëri – tjetrit për më shumë besim, më shumë shpresë, më shumë

optimizëm. Le të kemi **pak më shumë besim tek Allahu (xh.sh)**. Të duket vetja se je vetëm, por dije se me vete ke Zotin e gjithësisë. A mendon se e ka lënë fenë e Tij në dorën tënde?! Mos mendon se çështja e fesë ka mbetur tek forca ime dhe tek e jotja?!

Allahu (xh.sh) ka dashur që të na fusë mua dhe ty në projektin e Tij, të na respektojë, të na lartësojë. Le t'i lutemi fort këtij Zoti, që ta njohim mirë Atë, se me të vërtetë është Madhështor.

Profeti (a.s) ka thënë: **“Sikur ta njihnit Zotin siç e meriton Ai, me duanë tuaj do të shkuleshin malet prej vendit”**⁴.

Po kush prej nesh e njeh Zotin, siç e meriton Ai?! Ka njerëz, dua ja (lutja) e të cilëve i shkul malet nga vendi. Të kesh më shumë besim tek Allahu (xh.sh), do të thotë të kuptosh se nuk jemi të vetëm. Jemi me Krijuesin e të gjithë forcave të universit, me Allahun (xh.sh).

Gjithashtu duhet të kemi **pak më shumë besim tek e vërteta**. Zoti e krijoi universin, me qëllim që ta vendosë të vërtetën në vend. Kush prej nesh ka hyrë në këtë fe për qejf apo për interesat e tij?! Çfarë na bashkon neve?! Kemi hyrë në këtë fe, se duam ta ndjekim të vërtetën dhe e paguajmë faturën e saj. Atëherë dije se e vërteta mund të vonojë, por nuk harron, sepse Zoti i gjithësisë do ta sjellë atë, ashtu siç ua solli banorëve të shpellës pas 309 vitesh.

Një grup të rinjsh nga familje shumë të pasura dolën kundë tiranisë dhe dhunës. Ata u futën në një shpellë. Pas 309 vitesh, gjatë të cilave Zoti i kishte lënë në gjumë, Zoti ua dha shpirtin edhe njëherë, i zgjoi që ta kuptojnë se e vërteta nuk humbet e të binden edhe njerëzit e tjerë se çfarë bën Zoti i botëve për të kthyer të vërtetën. E vërteta do të vijë më lejen e Allahut (xh.sh) se Zoti thotë në Kuranin famëlarhtë: **“..dhe thuaj: “Erdhi e vërteta dhe iku e kota. E kota është e ikur, ajo nuk ekziston”**. (Isra: 81).

Shpresojmë dhe i lutemi Zotit të gjithë bashkë, që të jemi me të vërtetën dhe nëse jemi me të vërtetën nuk do të na humbë Zoti inshallah as në këtë jetë as në jetën tjetër.

Pak më shumë besim tek e ardhmja. E ardhmja është e ndryshme nga e sotmja. Nuk e them unë këtë por e thotë Zoti në Kuranin e Tij: **“Ka vendosur Zoti që Unë dhe profetët e Mi do të fitojmë”**. (Muxhadeleh: 21).

Zoti është i Fortë dhe Krenar. Do të fitojë Zoti i gjithësisë, do të fitojnë profetët dhe besimtarët e Zotit. Profeti (a.s) thoshte: **“Vallahi do të arrijë kjo fe, atje ku arrin lindja dhe perëndimi i diellit”**⁵. E lus Zotin e gjithësisë të na bëjë pjesë të vërtetë të

2. Ahmedi dhe Muslimi.

3. Tirmidhiu dhe Ahmedi.

4. Bejhakui në Zuhd.

5. Ahmedi dhe Taberaniu me përcjellës të vërtetë. Hadithi në formë të ngjashme përcillet edhe nga Muslimi.

kësaj feje, të na lidhë fort pas madhështisë së Tij, të mos lerë vend për shejtanin në zemrat tona. E lusim Zotin që të mos na lerë asnjëherë në duart e veteve tona, por gjithmonë të na mbajë me mëshirën e Tij.

I dashuri i zemrave tona, profeti (a.s), ai që nuk fliste kot, ai që fjalët i peshonte mirë thoshte: **“Feja është këshillë”**. E pyetën: “Për kë është këshillë o profet i Zotit?”

Ai (a.s) tha: **“Për librin e Tij, për profetët e Tij, për të parët e muslimanëve dhe për të gjithë besimtarët në përgjithësi”**⁶.

Të këshillosh është pjesë e kësaj feje dhe të këshillon vetëm ai, që ta do të mirën, kurse tjetri të bën kurthe e lajka dhe pret rastin kur të të hedhë përmbys. Besimtari që ia do të mirën tjetrit, e këshillon atë. Të themi të vërtetën, nuk ka njeri të madh përpara këshillës. As profeti (a.s) nuk ishte më i madh se këshilla. Ai i nxiti shokët e tij ta thonë këshillën. Kur ta shikojnë gabimin, ta thonë atë edhe sikur atë gabim ta bënte profeti (a.s). Ata e bënë një gjë të tillë në mënyrë të natyrshme. Kur shikonin diçka, e pyesin profetin (a.s): “Pse e bërë këtë o profet i Zotit? A nuk do të ishte më mirë ta bëje në formën tjetër?” Profeti (a.s) e pranonte këshillën e tyre pa u mërzhitur fare, sepse vetë i kishte nxitur ta thonë këshillën.

Ai u kishte thënë shokëve të tij: **“Mos u bëni diktatorë. Mos ua mbyllni gojën njerëze, por i lini ata, që t’ju këshillojnë e t’ju qortojnë, se e kanë për të mirën tuaj, pasi kjo fe është e Allahut (xh.sh)”**.

Omer Ibn Hattabi (r.a), ai që kujdesej që të mos bënte as edhe një grimcë padrejtësie, qoftë edhe ndaj kafshëve, deshi t’i provonte njerëzit, për të parë nëse ata e ndiqnin nga frika apo ndiqnin ligjet e Zotit. Njëherë ai ngjitet në minberin e profetit të Zotit dhe u thotë besimtarëve: “Nëse më shikoni se do të devijoj pak nga e drejta, çfarë do të bëni me mua”. Ndërsa të tjerët heshtën se e kuptuan qëllimin e Omerit (r.a), dikush nga fundi i xhamisë u ngrit, nxorri shpatën dhe tha: “Vallahi po të pamë se devijon nga e drejta, do të të kthejmë tek rruga e drejtë qoftë edhe me shpatë”. Njerëzit i thanë: “Si i flet kështu prijësit të besimtarëve”? Ndërsa Omeri (r.a) tha: “Nuk ka hajr prej jush, nëse nuk e thoni këtë fjalë dhe nuk ka hajr prej nesh, nëse nuk e pranojmë atë”. Kështu i rriti profeti (a.s) këta njerëz. Ta dëgjojnë të vërtetën, nëse besojnë bindshëm tek Zoti i gjithësisë dhe duan ta lartësojnë këtë fe.

Profeti (a.s) tha: **“Shembulli i besimtarëve është si puna e udhëtarëve në një anije. Ata të katit poshtë për të marrë ujë duhej të hipnin sipër tek ata të katit lart. Ata të katit të poshtëm menduan të thyejnë një dërrasë me nijetin e mirë, që ta marrin ujin direkt prej detit e të mos i shqetë-**

sojnë ata të katit lart. Por po i latë ta thyejnë atë dërrasë, do t’ju mbysin ju dhe veten e tyre”. **Mos i lini shokët të bëjnë gabime. Anija është e të gjithëve”**⁷.

Gjithashtu duhet të pyesim për ato gjëra, që i kemi të paqarta. Profetit të Zotit i vinte shpallja, por përsëri i pyeste shokët e tij dhe vetëm kur i vinte urdhër nga Allahu (xh.sh) për një punë, e bënte atë pa pyetur shokët e tij, kurse në të gjitha rastet e tjera ai konsultoej me ta.

Por duhet të dimë edhe sesi të reagojmë, sepse na shikojnë të gjithë njerëzit e tjerë, prandaj duhet ta masim zemërimin tonë. Nëse e bëjmë diçka për hir të Zotit, le ta bëjmë atë siç na mëson feja e Allahut (xh.sh).

A i shihni muslimanët në vendin tonë se ku falen. Në zhurmë, në pluhur, në djersë. Nuk po mundemi t’iu krijojmë rehati as për 5 minuta. Le të bashkoheni e të bëjmë një xhami. Jo gjithmonë do të bëhet me ndihma, se të tjerët i kanë bërë me kontribut vullnetar. Të mendojmë për një shkollë, për një Medrese. Fëmijët po rriten e njerëzit nuk dinë ku t’i çojnë. Të mendojmë për arsimin e kuadrove tanë. Kur kuadrot e feve të tjera kanë nga 2-3 fakultete, kuadrot tona nuk kanë shkollën e duhur, arsimin e duhur. Kush do të punojë për këta njerëz, kush do ta ngrejë nivelin e kësaj feje?

Të punojmë për moralin, që po kërcënohen në familjet tona. Kush do t’u flasë njerëzve që kjo punë është e mirë dhe kjo tjetra nuk është e mirë, nëse nuk u flasim ne? Le të bashkohemi për hatër të atyre muslimanëve, që janë në fshatin më të skajshëm të Shqipërisë, që veten e njohin për muslimanë, por s’dinë asgjë nga kjo fe. Askush nuk u ka trokitur në derë e t’ju thotë: “Besoni në Zot. Bëjeni këtë punë të mirë. Mos e bëni këtë punë të keqe”. Fatkeqësisht kemi mbetur duke u marrë me njëri – tjetrin, duke përgjuar njëri – tjetrin. Djeni se ka nga ata njerëz, që e kanë dëshirën për t’u bërë muslimanë, por kur shohin se si janë muslimanët dhe se çfarë opinioni kanë të tjerët për ta, atëherë zmbropsen nga feja e Allahut (xh.sh). Për hir të Allahut (xh.sh) le t’i shikojmë punët pak më ndryshe. Përgjegjësia është e madhe, por inshallah mëshira e Zotit është edhe më e madhe.

E lus Allahun (xh.sh) të na fusë në mëshirën e Tij, ta largojë shejtanin prej zemrave tona dhe të mos na përçajë.

E lus Allahun (xh.sh) t’i falë gabimet tona, ata që duken dhe ata që nuk duken, ata që i kemi bërë dhe ato që do t’i bëjmë. Zoti na faltë sa jemi gjallë, kur të vdesim dhe kur të dalim para Madhështisë së Tij.

Amin!..

6. Muslimi.

7. Buhariu.

Muhamedi

shëmbëlltyrë e njerzimit

— Merva Capo —

Kur Ibrahim i dhe Ismaili ngritën themelet e Qabes, u lutën: “...O Zoti ynë! Dërgo tek ata një të dërguar nga gjiri i tyre, që t’u lexojë Shpalljet e Tua, t’ua mësojë Librin dhe Urtësinë.” (Bekare, 129)

Për një rrugë të mbarë në vatrën e tokës, njeriu, do të duhej ta njihte të Vërtetën, sepse jo, për së dyti herë nuk do të vinte në këtë botë, prandaj për një rrugë të mbarë drejt përjetësisë, do të duhej të njihte të Vërtetën.

Lajmin e shpëtimit na e solli Muhamedi (a.s.) me një kujdes madhështor që e harmonizon mendjen e zemrën dhe po t’i jepej në krahun e djathë dielli e në të majtën hëna, i Lavdëruari kurrë nuk do të hiqte dorë nga thirrja hyjnore. Përnjëmend, këtu e ka zanafillën ekzistenca e qenies njerëzore, te fjala e madhe e së Vërtetës e që kjo do të dilte nga goja e atij që populli e quante kaherë Es-Sidik, i vërteti.

Civilizimi i ndërtuar nga ai, flakë tutje çdo sjellje dhe veprim që e kërcënon mirëqenien në mesin e njerëzve. Çdo gjë e vyer në dorën e tij kalitej me zell sepse atë do t’ia ofroj umetit për të cilin lutej gjithnjë:” O Allah! Umeti im”.


Andaj për të mos thënë në Ditën e Gjykimit “Ah sikur të isha dhe...” duhet pasuar të Vërtetën nga i vërteti.

Vetes do t’i kishim bërë nder të madh nëse kthehemi prapa në kohë dhe e lexojmë me syrin e mendjes të Dërguarin e Allahut, Muhamedin (a.s.). Te ai shohim bukuritë e moralit , të butësisë, drejtësisë, dhembshurisë, tolerancës, mëshirës si dhe bukuritë intelektuale. Me këto dy virtyte të çmuara në praninë e tij i padituri mençurohej, i varfëri pasurohej, i shtypuri lartësohej, i dobëti fuqizohej, i sëmuri shërohej, grua vlerësohej, vajza çmohej, nëna respektohej, jetimi përkujdesej...

Përgjatë njohjes së tij natyrshëm do të përmallohem për shëmbëlltyrën tonë dhe do të ushqejmë dashuri... po do të na vijë në ndihmë përgëzimi që i bëri Muhamedi (a.s.) njeriut që lotoi nga frika se s’do të mund ta takonte atë pas vdekjes e ai i tha: “Njeriu është bashkë me atë që do”, e dashuria kërkon dëshmi dhe ne dëshmojmë se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Allahut dhe dëshmojmë se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Zotit.

E dashuria kërkon dëshmi, prandaj: “Kur të flitni thoni të vërtetën, kur premtoni zbatoni, kur t’ju lihet diçka në amanet çojeni në vend... Mos thuaj ‘sikur ta kisha bërë këtë e këtë do të ishte kështu e kështu’... Kush ju bën ndonjë të mirë kompensojeni atë po qe se s’keni me çka të kompensoni atëherë lutuni për të... Frikohu prej Allahut kudo që të jesh, nëse bën ndonjë vepër të keqe pas saj bëje një të mirë që ta shlyesh atë dhe ndaj njerëzve sillu mirë... Mbjalidhje të mira me farefisën... Fol mirë ose hesht. Bëhu i qëndrueshëm në të drejtë...”.

Duke e dëshmuar dashurinë, mbetshim me dëshirë të zjarrtë për ta takuar Muhamedin (a.s.) që na e mësoi rrugën për në Xhenet.





MUNGESA E VETËBESIMIT TEK FËMIJËT

— Betyl Balltaxhë —

Një prej temave që i shqetëson më shumë prindërit është mungesa e vetëbesimit tek fëmijët.

Ne veçanti, ato shqetësohen nga gjërat negative që vijnë bashkë me mungesën e vetëbesimit. Disa prej tyre janë: turpi i ekzagjeruar, largimi nga shoqëria, frikësimi nga ambientet që nuk i njohin dhe dëshira për të mos shkuar në shkollë. Një gjendje e tillë ndikon negativisht si tek jeta personale ashtu edhe tek jeta shkollore e fëmijës dhe adoleshentit.

Nëse fëmija jonë ka mungesë vetëbesimi dhe duam ta kurojmë atë, fillimisht duhet të kuptojmë mirë se çfarë është vetëbesimi.

Vetëbesimi është nevojë instiktive e njeriut. Në të njëjtën kohë, ai është edhe tregues i qartë se sa e vlerësojmë veten. Njeriu që ka vetëbesim është më i qetë me veten, rrjedhimisht edhe me të tjerët, prandaj ai mund të jetë më i qetë dhe më tolerant ndaj njerëzve që i rrethon. Shkurtimisht mund të themi se vetëbesimi është shumë i nevojshëm për një jetë të shëndetshme dhe të suksesshme.

Fëmija që ka probleme me vetëbesimin e shikon veten si dështak dhe të pafat. Kjo gjendje bëhet shkak që fëmija ta ndjejë veten të pamjaftueshëm.

Ndjenja e vetëbesimit fitohet në moshën 0-6 vjeçare dhe na shoqëron deri në fund të jetës. Detyra kryesore e prindërve është që t'i rrisin fëmijët e tyre si individë që kanë besim të plotë tek vetja. Besimi dhe inkurajimi që i japim fëmijëve do t'i ndihmojë ato që të krijojnë karakter të fortë.

CILAT JANË SHENJAT DALLUESE TË FËMIJËS QË KA VETËBESIM?

Krijimi i kontaktit pamor kur flet,
Shfaqja e sjelljeve që e tregojnë të sigurtë në vetvete,

Aftësia për t'i bindur moshatarët e vet,
Mungesa e nevojës së vazhdueshme për ndihmën tuaj,

Pranimi i të vërtetës në çdo rast, edhe kur e di se ju mund të zemëroheni,

Pranimi i gabimeve,
Siguria në atë që e mendon si të drejtë,
Mbajtja e fjalës që ka thënë, edhe nëse ju i dilni kundër,

Të qenit përgjegjës,
Të mos qenit njeri që i mbetet hatri,
Lumturimi në raste suksesi,
Aftësia për ta marrë veten shpejt pas dështimit,

Të qenit durimtar dhe jo i ngutur,
Mosdorëzimi përballë vështirësive.

CILAT JANË SHENJAT DALLUESE TË FËMIJËS QË KA MUNGESË VETËBESIMI?

Paaftësia për të krijuar kontakt pamor me bashkëbiseduesin,

Kërkimi i tepruar i faljes,
Qëndrimi larg rretheve shoqërore,

Shmangia e konkurrencës,

Shmangia e përgjegjësiave,
Frika nga qortimi dhe evitimi i kësaj gjendjeje
(për shembull nuk merr pjesë në konkurset e shkollës, ka frikë të bëjë prezantim para njerëzve)

Të qenit shumë hatërbetur,
Fajësimi i njerëzve të tjerë,
Mungesa e mendimeve personale,
Veprimi sipas direktivave të të tjerëve.

SI MUND TË FITOHET VETËBESIMI?

Zbuloni anët pozitive të fëmijës tuaj!

Nëse e ndryshojmë pak këndvështrimin tonë, do të mund të shikojmë anët pozitive të fëmijës dhe t'i lavdërojmë ato.

Tregoni fëmijës se cilat janë anët e tij më të mira!

Sado që t'i lavdërojmë sjelljet e mira të fëmijës tonë, nganjëherë harrojmë t'i themi ato haptas ose nuk e ndjejmë nevojën për ta bërë një gjë të tillë.

Le ta kuptojmë se sa rëndësi ka kjo për fëmijën tonë dhe të mos e lëmë pas dore përkujtimin e tyre.

Pa marrë parasysh sjelljet e tij, kujtojani fëmijës se sa i çmuar që është ai për ju!

Kjo është shumë e rëndësishme. Nëse fëmija e kupton se ju e doni pavarësisht atyre që bën, ai kthehet në individ të pavarur dhe të sigurt. Ndërsa, fëmija që mendon se nëna dhe babai e duan vetëm kur ai realizon pritshmëritë e tyre, kthehet në një individ të vetmuar.

Kritikoni vetëm sjelljen e fëmijës!

Nëse nuk ju pëlqen një sjellje e fëmijës, kritikojeni atë por duke ia bërë të qartë se për cilën sjellje e keni fjalën. Bëni kujdes që të mos kritikoni në mënyrë të përgjithshme dhe tregojni fëmijës se ju vazhdoni ta doni fort.

gjithshme dhe tregojni fëmijës se ju vazhdoni ta doni fort.

Tregoni fëmijës se si mund ta rregullojë sjelljen e gabuar!

Përdorni një ton normal të zërit për t'i treguar fëmijës se si mund ta korrigjojë sjelljen e gabuar. Nëse është e mundur, jepini pak kohë për ta ndryshuar këtë sjellje. Në momentin kur e rregullon sjelljen e gabuar, mos harroni që ta lavdëroni atë.

Mbyllni syrin para disa gabimeve të vogla!

Ndodh shpesh që prindërit nuk dalin dot nga një rreth vicioz i shkaktuar nga fëmijë me karakter të vështirë. Dënimet e shpeshta mund ta bëjnë situatën akoma më të vështirë. Nëse e mbyllni njërën sy përpara disa gabimeve të vogla, të dyja palët mund të qetësohen sadopak.

Mbështetni talentin e tyre!

Fëmija që është i ndërgjegjshëm për talentin e vet, ka më shumë vetëbesim. Zbulimi i talentit të fëmijës dhe mbështetja e tyre është shumë e rëndësishme për fëmijën. Nga ana tjetër, ka rëndësi që të mos bëheni shumë imponues! Pra, këshillojeni fëmijën por mbajini pritshmëritë jo shumë të larta. Sigurisht që për shumë prindër, kjo nuk është aspak e lehtë, sepse tek talentet e fëmijëve ato shikojnë ëndrrat e tyre të përealizuara. Por duke bërë kështu mund të bëhemi shkak që fëmija të ketë dështimin më të madh në jetë. Imponimi i tepërt dhe pritshmëria e lartë mund të bëhet shkak për humbjen e motivacionit.

Fëmija që ka vetëbesim do të bëhet individ që e di se çfarë do, i sigurtë në vetvete, që e njeh dhe e pëlqen veten. Në vitet e ardhshme të jetës ai nuk do të heqë dorë menjëherë, do të jetë më tolerant dhe do të vlerësojë veten dhe të tjerët.

Dashuria

Elif Menxhet

Bota është krijuar për hir të dashurisë; thelbi i njeriut është dashuria... Në një vend ku nuk ka dashuri, nuk ka as mëshirë. Allahu (xh.sh.), asnjë nga pejgamberët nuk i ka thirrur me virtytet: “er- Rauf” dhe “er- Rahim”, ato janë përdorur vetëm për Pejgamberin tonë të nderuar.

Ai njeri me moral të lartë i ka mbajtur me drejtësi këto virtyte. Resulullahu ishte i mëshirshëm me të gjithë. Të gjitha krijesat; njerëzit, kafshët, bimët edhe sendet e pajetë kanë përfituar nga mëshira e tij. Edhe shoqëria jonë ka përjetuar shumë shembuj njerëzor mëshire, si shembull mund të përmendim Junus Emrenë i cili thotë: “Dua je krijesën për hatër të Krijuesit!..”

Dua t’ju tregoj një histori nga jeta jonë që tregon rëndësinë e mëshirës dhe bujarisë... Një nxënës medreseje punonte shumë, por nuk ishte i suksesshëm në mësim. Shokët e tij morën diplomat dhe vazhduan në rrugët e tyre të jetës, kurse ky vazhdonte të mësonte me vullnet. Nuk hiqte dorë nga qëllimi i vet por as nuk arrinte ta realizonte atë. Kaluan muaj, e kaluan vite.

Një ditë ngrihet herët, para namazit të sabahut; merr abdest me mendimin që ta falë namazin në xhami dhe pastaj të shkojë direkt e në shkollë. Del nga shtëpia, pa bërë shumë hapa, ai shikon disa këlyshë të vegjël. Nisi të mendonte:

“Moti është shumë i ftohtë, prandaj qentë e vegjël janë strukur dhe po dridhen nga të ftohtit. Çfarë të bëj me ta? Në qoftë se do të rrinë jashtë deri sa të kthehem unë nga shkolla, do të ngordhin... Në qoftë se do të kthehem për t’i çuar në shtëpi, mund të bëhem vonë për namaz?!” Si përfundim vendos, dhe i merr qentë për t’i çuar tek dhoma e vet.

I vendos mbi një batanije të ngrohtë. U përgatit atyre një ushqim të nxehtë dhe ua jep; pas kësaj del duke vrapuar për të mbërritur në xhami.

Pas namazit fillon mësimi. Nxënësi e dëgjon mësuesin dhe vazhdimisht ia ndërpret fjalën duke i thënë:

“Mësues e keni gabim, nuk është ashtu siç thatë ju por është kështu...”

Vjen një moment që mësuesi nuk duron më dhe i thotë nxënësit të vet:

“Boll biri im, mjaft me kaq! Që prej sa vitesh nuk ke hapur gojë asnjëherë, as nuk e ke kuptuar mësimin... Tani vjen e më gjen gabimet e mia. U bërë më i zgjuar për hir të lehjes së atyre qenve dhe duasë së tyre që mbërriti gjer në arsh; ti duhet t’i jesh mirënjohës atij veprimi që ke bërë!..”

E mira nuk ka masë... Njeriu nuk mund ta dijë vlerën e vërtetë që kanë të mirat apo të këqijat që ne bëjmë... Nuk mund ta dimë ndikimin që një veprim i thjeshtë i joni mund të ketë... Mbase do ta fitojmë Xhenetin për hir të një veprimi të mirë që neve na është dukur shumë i vogël ose mund të shkojmë në Xhehenem nga një veprim i keq që nuk e kemi përfillur aspak... Le t’i vendosim pikën shkrimit tonë me një hadith:

“Mëshiroji krijesat e tokës që të të mëshirojnë krijesat e qiellit.”

Allahu mos na privoftë kurrë nga mëshira e Tij e pafund. Amin!

Cili është prioriteti juaj?

— Seher Ajdën —

Sa shumë jemi gëzuar ditën kur në shtëpinë tonë erdhi kompjuteri... U ulëm të gjithë përreth tij dhe nuk u ngritëm deri në orët e para të mesnatës. Të nesërmen folëm me kamera me të afërmit tanë nëpër botë dhe u gëzuam shumë për kursimet që bënim duke i krahasuar me koston e telefonit. Kompjuteri u bë sendi më i dashur i shtëpisë dhe nuk e linim vetëm asnjë çast. Gjatë paradites isha unë që e përdorja; kur vinin fëmijët nga shkolla e merrnin ata radhën, për t'ia lënë bashkëshortit mbrëmjeve... Babai, që u tregonte fëmijëve foto dhe slajte interesante, filloi të zhytej në një qetësi të çuditshme. Tashmë nuk i mjaftonin pasditet, edhe netët i kalonte para kompjuterit. Netët kalonin dhe miqtë e internetit i ishin bërë më të afërt se pjesëtarët e vet të familjes.

Deri në ditën kur më rrëfeu që kishte marrë një grua të huaj si bashkëshorte të dytë...

Arsimi dhe mësimi kanë bërë hapa gjigante; tashmë nxënësit nuk mësojnë me libra dhe me lapsa, por me kompjuter dhe internet. Duke e ditur këtë gjë ne morëm një kompjuter për të lehtësuar fëmijët tonë në shkollë. Në fillim interneti përdorej për mësimet e shkollës pastaj filluan lojërat, filmat e deri tek blerjet nga interneti. Fëmijët na thoshin që blerjet e bëra në internet janë më të favorshme dhe na flisnin për kursimet që mund të bënim. Unë i kërkoja burrit të gjente një zgjidhje, sepse këto para nuk ishin para hallalli...

Deri në ditën kur na erdhi urdhri nga gjykata, sepse djali ynë i vogël kishte harxhuar shuma të mëdha me kartën tonë të bankës...

Kur i kërkoja burrit që të na blinte një kompjuter ai m'u përgjigj:

“Në qoftë se kompjuteri do të përdoret nga të gjithë njerëzit e shtëpisë, të gjithë duhet të kontribuojnë në blerjen e tij!..”

Kur dëgjova këto fjalë unë plot krenari, e hoqa bylyzykun nga dora dhe ia dhashë burrit.

Në fund të fundit jetojmë në kohën e teknologjisë dhe nuk është mirë që të mbesim larg shoqërisë. Fëmijët e përdornin internetin për të bërë detyrat e shkollës kurse unë e zhvilloja hobin tim të gatimit duke shikuar receta të ndryshme në internet.

Nga ta dija unë që bylyzyku i blerë me para hallalli do të bëhej shkak për ta shkatërruar familjen time. Burri im që mori zakone të këqija përmes internetit një ditë na braktisi...

Ka shumë histori të ngjashme, por nuk është e mundur që t'i përmendim të gjitha... Këto janë dhuratat e teknologjisë dhe shkencës së përparuar...

Ndjememi pa fat, sepse ai që hyri në jetën tonë si një bekim tashmë është kthyer në shkatërrimin tonë... Kjo ngjason me veprimin e shejtanit, i cili përpiqet të na i shfaqë si të mira dhe të bukura gjërat e dëmshme dhe të shëmtuara...

Të gjithë ne kemi përfutur nga zhvillimi teknologjik për të thjeshtësuar jetët tona. Kompjuteri, makinat, telefonat dhe gjërat e ngjashme na u dukën shumë të mira dhe të favorshme për përdorim. Ne nuk e kuptojmë se sa shpejt kalon koha që ne përpiqemi të ruajmë. Ditët tona të numëruara dhe minutat tona të çmuara i harxhojmë pa kujdes... I kemi harruar gjërat e rëndësishme dhe përpiqemi të gjejmë lumturinë tek gjërat e dorës së dytë...

Sigurisht që duhet të përfitojmë nga anët e mira të teknologjisë, por këto nuk duhet të kalojnë asnjëherë në plan të parë, sepse për një besimtar gjëja më e rëndësishme është dashuria për Allahun dhe Resulullahun, bashkë me to edhe përkushtimi ndaj Kuranit dhe Sunetit... Njeriu pjesën më të madhe të kohës e kalon me njerëzit dhe gjërat e dashura. Zgjedhjet që bëjmë, vendet ku shkojmë flasin për njerëzit tonë të dashur.

Besimi ynë nuk shpalolet vetëm me anë të adhurimeve që kryejmë. Myslimani e tregon besimin e vet me sakrificat, zgjedhjet dhe dëshirat. Ashtu siç dallohet harami nga hallalli, ashtu dallohet edhe njeriu që do dhe adhuron Allahun prej atij që do dhe ndjek shejtanin... Duhet të theksojmë faktin se ne qëndrojmë në ato vende ku kemi gjëra apo njerëz të dashur...

Myslimanët e kohëve të sotme janë duke u testuar më shumë në këtë temë. Resulullahu (a.s.), na ka këshilluar me fjalët: “*Kapuni me dhëmbë pas Sunetit.*” (Ebu Davud, Synnet, 5) Ai na ka treguar se mënyra e vetme për t'u ruajtur nga kurthet e shejtanit është që të forcojmë lidhjen tonë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Le të strehohemi nën çadrën e besimit dhe të ushqehemi me Islamin, sepse njeriu është një krijesë e dobët dhe vetëm ai është një liman i sigurt. Në qoftë se duam që të bëhemi pjesëtarë të këtij limani, duhet ta njohim dhe ta duam atë; kjo arrihet vetëm duke shkatërruar pengesat që na mbajnë larg rrugës së drejtë. Mos harroni se njeriu është pranë atyre që do!

Shija e jetës

— Nezha Bash —

Shpesh herë na kanë paralajmëruar që të qëndrojmë larg tre gjërave të bardha: miellit, sheqerit dhe kripës. Nganjëherë janë quajtur edhe si tre helmet e bardha por asgjë nuk arriti që të na ndante me to.

Sigurisht që në qoftë se i përdorim në masë të duhur, mund të shpëtojmë nga dëmet e tyre; por fatkeqësisht produktit themelor të ushqimeve tona, grurit, i janë hequr vitaminat dhe mineralet dhe është kthyer në miell të bardhë. Sheqeri i panxharit që prodhohet nga rafinimi i panxharit është bërë ëmbëltuesi jonë kryesor dhe që e përdoret kudo.

Industria nuk ka lënë pa 'pastruar' edhe kripën duke e thjeshtuar përbërjen e saj deri në dy elemente; pas këtij eksperimenti doli në dritë një helm

i bardhë që ngjan me sheqerin e bardhë.

Kjo kripë industriale është shkaktare për rritjen e lëngut në damarë, rritjen e tensionit të gjakut, shtimin e sëmundjeve të zemrës ose veshkave dhe për rritjen e rrezikut të gjymtimit.

Pavarësisht të gjitha këtyre, le të mendojmë pak; nga kush e marrim të drejtën për ta shpallur kripën si armike tonën? Njerëzit që gatujmë e dinë shumë mirë që gjella nuk ka shije pa kripë. Mos të harrojmë që edhe në gjakun tonë, dhe në djersën tonë ka kripë. Dy elementet kryesore që formojnë trupin e njeriut janë uji dhe kripa. Lëngu që ndodhet në fetus është i përbërë nga përzierja e ujit dhe kripës inorganike. Ka rreth 100 vjet që është provuar se nga djegia e një kufome njerëzore përfitohen mbetje të krijuara nga kripa.

Nga të gjitha këto kuptojmë se është në të mirën tonë që ta njohim sa më mirë kripën me dëmet dhe cilësitë e saj të veçanta.





KRIPA

Në qoftë se bëjmë kërkime në histori do të shikojmë se kripa ka rreth 14.000 fusha përdorimi dhe që kohë më përpara janë bërë lufta mes fiseve për të fituar zotërimin e kripës sepse populli që kishte kripë bëhej i pasur. Romakët e lashtë i paguanin punëtorët me anë të kripës. Kripa ka qenë aq e rëndësishme saqë eksploruesit evropian dhe afrikan jepnin një filxhan me ar për të marrë në këmbim një filxhan me kripë. Kripa ka qenë e rëndësishme aq sa ari; në disa vende ajo quhej: ari i bardhë.

Në kripën natyrale gjenden rreth 84 elemente; edhe kripa që ndodhet në trupin e njeriut është e përbërë nga 84 elemente. Kripa është një nga elementet më të pazëvendësueshme të jetës sepse ne nuk jetojmë dot pa të... Gjaku nuk mund të qëndroj dot në damarët dhe qelizat tona pa kripë. Ajo ndikon për mirë edhe tek sistemi nervor dhe tek muskujt e trupit. Pa kripë ne nuk mund të lëvizim dhe as të mendojmë.

Duhet të kemi parasysh që kripa për të cilën po flasim nuk është kripa e rafinuar që ne vendosim në tavolinat tona. Ajo është kripa natyrale ose siç mund ta quajmë ndryshe: kripa e parafinuar.

LLOJET E KRIPES

Kripa ndahet në dy lloje, në kripën natyrale dhe në kripën e bukës (kripa e rafinuar).

1. Kripa natyrore

84% e kripës natyrore është klorur natriumi kurse 16% është: litium, fosfor, selen, magnez, kalcium, dhe minerale si vanadiumi. Në natyrë ndodhen gjithsej 94 elemente dhe përveç gazeve fisnike, të gjitha elementet e tjera mund t'i gjejmë tek kripa natyrore. Ajo është burimi më i mirë ku mund t'i gjejmë këto elemente. Këto minerale mund të merren edhe nga uji i valuar ose nga ujërat e burimeve. Kripa natyrore është tre llojesh:

a) Kripa e detit: Kjo lloj kripe zakonisht përfitohet nga pellgjet e formuara pranë detit me anë të tharjes së ujit. Në ujin e detit gjendet shumë klorid natriumi dhe kripë e përbërë nga 84 elemente që mund të ndahen. Kripa e detit dhe kripa e shkëmbinjve ngjasojnë shumë me njëra-tjetrën; sidomos kripa në formën e kristaleve. Kripa e detit është shumë e pasur me minerale. Nga ana tjetër, kripa e detit përmban metale të rënda si pasojë e ndotjes së mjedisit. Për shkak të këtij problemi, pjesa më e madhe e kripës së detit rafinohet.

b) Kripa e shkëmbinjve: Kjo kripë është formuar nga tharja e deteve të vjetër. Kripa që gjendet në formë të ngurtë në thellësi të deteve quhet: kripë shkëmbore. Kjo kripë përmban të 84 minerallet që gjenden në natyrë dhe përveçse ka shije të mirë ajo është e shëndetshme për njeriun.

Kripa e shkëmbinjve nuk përmban asnjë element të huaj dhe ka një përbërje tërësisht organike. Shumë studiues në të gjithë botën e këshillojnë shumë përdorimin e kësaj kripe. Ajo përmban shumë prej elementeve që përbëjnë bazat e trupit të njeriut si: hekurin, magnezin, kalciumin dhe kaliumin. Kripa e shkëmbinjve është një mike e vërtetë e shëndetit të njeriut. Duke marrë parasysh moshën e saj të vjetër mund të themi se kjo kripë është e pastër dhe e paprekur nga ndotjet e mjedisit.

c) Kripa e kristaltë: Kripa e shkëmbinjve që ka qëndruar nën një tryzni të madhe kthehet në kristal. Veçoria më e madhe që e ndan kripën e kristaltë prej kripës së shkëmbinjve është struktura e dendur dhe e zvogëluar si pasojë e trysnisë së madhe. Kripa e kristaltë e Himalajave është një prej kripërave më të mirë në botë.

Dëmi

që shkakton alkooli tek ADN-ja



Organizata Botërore e Shëndetësisë i klasifikon pijet alkoolike si kancerogjene të “grupit 1”, çka do të thotë se ka prova bindëse që mund të shkaktojnë kancer. Por studime të reja tregojnë se si alkooli mund të dëmtojë trupin edhe nga ana gjenetike.

Studimet e fundit kanë zbuluar se konsumi i pijeve alkoolike mund të shkaktojë dëm të përherëshëm gjenetik.

Një informacion që mungonte ishte se si saktësisht shkakton dëm alkooli dhe studimet treguan se kur alkooli përpunohet nga trupi dhe shndërrohet në energji, akumulohet si toksinë që sulmon ashpër ADN-në dhe dëmton informacionin gjenetik që përbën kodin e jetës.

Toksina quhet acetaldehyde dhe prodhohet kur trupi konsumon alkool. Studimet tregojnë se mund të dëmtojë qelizat në mënyrë të riparueshme.

Kjo mund të ndodhë në nivelin e qelizës embrionale që është shumë e rëndësishme, sepse kjo lloj

qelize prodhon shumë qeliza të reja dhe është qeliza rigjeneruese e trupit të njeriut.

Ky dëm gjenetik mund të shkaktojë deri pasoja vdekjeprurëse në trupin e njeriut.

Ndryshimi i kromosomeve ose ADN-së janë arsyeja themelore që qelizat plaken, ose transformohen në kanceroze.

Trupi ka një enzimë që e shpërbën acetal-dehydren. U bë një prove për të treguar se çfarë u bën alkooli qelizave që nuk e kanë atë.

Tek minjtë, kur hiqet enzima që pastron toksinën, si edhe këtë mekanizmi i riparimit të ADN-së, vihet re që edhe sasi fare të vogla alkooli shkaktojnë dëm të jashtëzakonshëm tek qelizat që prodhojnë gjak.

Po ashtu shumë njerëz kanë disa sisteme riparuese për ADN-në, por Dr. Patel në një qendër studimore thotë se konsumi i alkoolit mund t'i dëmtojë linjat mbrojtëse dhe të shkaktojë dëm serioz gjenetik.

Ndryshimet në stilin e jetesës, ulin rrezikun për kancerin

Studimet e fundit po tregojnë gjithnjë më shumë se si ndryshimet në stilin e jetesës mund ta ulin ndjeshëm rrezikun e disa prej llojeve më të zakonshme të kancerit. Rezultatet e një studimi masiv kanë konfirmuar pa mëdyshje lidhjen mes diabetit dhe obezitetit me disa lloje kanceri.

Shkencëtarët thonë se një stil i shëndetshëm jetese përfshin pesë faktorë thelbësorë: Të mos pish duhan, ta mbash nën kontroll peshën, aktivitet i rregullt fizik, një dietë e shëndetshme dhe moskonsumimin e alkoolit.

Duke analizuar të dhëna të grumbulluara nga 340 mijë vetë në gjithë botën, studiuesit në Britani arritën në përfundimin se ata që i plotësonin të pesta këto kritere, kishin 32 për qind më pak gjasa të prekeshin nga kanceri i mushkërive, gjirit ose prostatit, llojet më të përhapura të kancerit.

Kur analizon faktorë si obeziteti, mund të shohësh rezultate të ndryshme, që nga studimi në studim ndryshojnë fare pak, por kur i krahason të dhënat e tyre në një analizë të gjerë, vërtet të ndihmon të krijosh një ide të qartë të asaj që po ndodh.

Doktoreshë Anne McTiernan, një studiuese në Qendrën “Fred Hutchinson” për Studimin e Kancerit në Siatell, thotë se ritmi i përhapjes së diabetit dhe obezitetit po rritet pasi ushqimet me nivel të lartë yndyre, sheqeri dhe kripe janë kudo.

Shumë vetë e dinë që duhet t'i shmangin ushqimet e shpejta. Por meqenëse janë të pranishme kudo, shumë vetë e kanë të vështirë të ndryshojnë dietën. Por doktoreshë McTiernan thotë se njerëzit nuk duhet të presin që qeveria ose industria e ushqimeve të shpejta të vendosin për ta.

“Unë do të thosha që duhet të mirinformohen, të

ndjekin me kujdes nëse me kalimin e kohës shtojnë peshë, nëse kanë rrezikshmëri më të lartë nga kanceri dhe të zgjedhin se çfarë të bëjnë për vete dhe për familjen”, thotë ajo.

Shkencëtarët në Shtetet e Bashkuara po punojnë për një analizë të thjeshtë gjaku që mund të diktojë disa lloje kanceri në një fazë shumë më të hershme, duke shtuar shanset për të ndalur zhvillimin e tij.

“Për disa njerëz, një tregues i hershëm për kan-

cerin mund të bëhet një udhërrëfyes për t’u ndërgjegësuar që mund të jenë të rrezikuar dhe për të bërë ndryshime dhe ndoshta marrin iniciativën për këto ndryshime.

Studimet tregojnë se kur dikush që është obez ose mbi peshë, humb peshë apo dikush tjetër fillon të bëjë aktivitete fizike, rreziku i kancerit zvogëlohet mjaft.

Alergjitë

e pranverës

Alergjia është një sëmundje e trashëguar imunitare, e cila ndodh që nga moshat e vogla deri në ato të rritura. Diagnostikimi i hershëm është shumë i rëndësishëm për pacientin, pasi një alergji e pa diagnostikuar në kohë pasojë mund të ketë një astmë bronkiale.

Alergjitë janë të shumëllojshme, duke nisur që nga alergjia ajrore, alergjia ushqimore, kemi dhe dermatitet alergjike, ku futen dermatitet alergjike të kontaktit, që e hasim kryesisht tek fëmijët që lindin me rjebull.

1-Alergjia ajrore është alergjia që vjen nga pluhuri, poleni i pemëve, lagështia, myku, si dhe nga kafshët shtëpiake.

2-Alergjia ushqimore vjen nga ushqimet e ndryshme dhe diagnostikohet mbi 1 vjeç si moshë, me ushqimet e para që merr fëmija.

3-Kemi dhe dermatitin alergjik të kontaktit, që mund të jetë më i shprehur tek ata që punojnë në parfumeri, parukeri, persona që janë në kontakte të vazhdueshme me detergjentë si llakra, bojëra etj. Ky lloj dermatiti vjen si pasojë e përdorimit të nikelit, i cili është i prekshëm, p.sh. nëpërmjet bizhuterive dhe i lëngshëm nëpërmjet frutave të thata, përdorimit të birrës, apo disa ushqimeve që kanë përmbajtje të lartë nikeli si: domatja, spinaqi, lulëllakra dhe sallata.

4-Kemi dhe alergjinë medikamentoze, që ndodh si pasojë e përdorimit të medikamenteve të ndryshme.

Në të gjitha llojet e alergjive simptomat janë të ndryshme. Alergjitë ajrore janë alergji të cilat shprehen me rinit alergjik, me konjuktivit alergjik, domethënë me laringit alergjik, me sinozit alergjik

(teshtima, rrjedhje hundësh, lotim të syve, kruajtje të syve, të fytit, të veshëve nga brenda, ikje të zërit, dhimbje të shumta të kokës, të cilat zgjasin për një periudhë të gjatë kohore).

Alergjitë ushqimore shprehen me shfaqje të pullave të kuqe në të gjithë trupin, fryrje të buzëve, syve, fryrje të pjesës së qafës, irritim dhe kruajtje në mënyrë të vazhdueshme të lëkurës.

Dermatitet alergjike të kontaktit shprehen më tepër në pjesën e duarve që kanë irritime, kruajtje dhe çarje të gishtave dhe kjo ndodh kur t’i ke përdorur apo punuar për një kohë të gjatë me një preparat, që në kontakt të vazhdueshëm ty të ka dhënë këto lloj simptomash.

Alergjia mediakamentoze shprehet me atijoden, me fryrje të buzëve, me fryrje të syve dhe ka një pruri të vazhdueshëm me pika të vogla në të gjithë trupin, jo pulla siç është alergjia ushqimore, por pika të cilat janë në formën e puçrrave të vogla.

Por, ajo që duhet të theksojmë është se, si alergjitë ajrore, ushqimore, medikamentoze ashtu dhe dermatiti alergjik i kontaktit, nëse nuk diagnostikohen në kohë dhe nuk mjekohen, kalojnë në astma bronkiale. Pra, pasoja është astma bronkiale që bëhet kronike për një person.



— Elsad Cukali —

MISTERE TË ÇUDITSHME TË KOZMOSIT

Universi në të cilin jetojmë është një strukturë komplekse gjigande në të cilën vetëm dekadat e fundit kemi filluar ta kuptojmë sa i mistershëm dhe i madh është. Astronomia është një shkencë shumë e lashtë që vitet e fundit është shndërruar tërësisht nga zbulimi i teleskopëve të avancuar. Deri para vitit 1975 mendohej se universi ynë përbëhej nga Heliumi, hidrogjeni dhe shumë elementë të tjerë të cilët formohen në brendësitë e yjeve nga reaksionet nukleare që ndodhin brenda tyre. Po në këtë vit, vjen një nga zbulimet që akoma edhe sot nuk ka ndonjë shpjegim të qartë. Astrofizikanët duke studiuar përbërjen kimike të konstelacionit “Aquila”, papritmas zbulojnë një re që e quajten reja G:34.3 e cila është një mijë herë më e madhe sesa diametri i sistemit tonë diellor. Ajo që e bën kaq të veçantë këtë re është përbërja e saj kimike. Në të gjendet përbërje e konsiderueshme alkooli i njëjtë me alkoolin që konsumojmë këtu në Tokë. Askujt nuk i shkante në mendje se edhe universi ynë qenka pak a shumë “pijanec”. Sot konstatohet se në këtë re gjendet aq alkool etilik sa që do të mjaftonte të furnizonte çdo person në planetin Tokë me 141953 litra alkool në ditë për një miliard vite me radhë. Përveç alkoolit etilik në këtë re gjenden sasi të konsiderueshme edhe të molekulave të tjera si acidi cianhidrik, monoksidi i karbonit, amoniaku etj. Gjithashtu gjenden edhe shumë zona të tjera të kozmosit me përbërje të konsiderueshme të alkoolit etilik ose metilik. Një prej tyre është galaktika jonë “Ruga e qumështit”. Në afërsi të qendrës së saj ndodhen re gjigande më përmbajtje metanol. Gjithashtu në konstelacionin “Shigjetari B2” janë gjetur sasi të konsiderueshme të esterit të formatit

të etilit, substancë që i jep aromë mjedres. Kjo do të thotë se qendra e galaktikës sonë kundërmon aromë mjedre! Madje janë zbuluar edhe shumë trupa të tjera qiellor me përmbajtje alkooli. Në nëntor të vitit 2011, astronauti amator australian Terry Lovejoy zbuloi një kometë që u emërua C/2011 Ē3 ose ndryshe kometa “lovejoy”. Analiza kimike e saj rezultoi të përmbante përqindje alkoli. Pas shumë studimeve disavjeçare, shkencëtarët konkluduan në shpjegimin e formimit të alkoolit etilik në kozmos. Sipas tyre, kur një yll gjigand e mbaron ciklin e tij me supernova, i gjithë materiali shpërhapet në hapësirë duke formuar retë me pamje madhështore me ngjyra që quhen “nebuluza planetare”. Mund të ndodhi që një sasi e gazit të shpërndarë në hapësirë të rigrumbullohet si pasojë e tërheqjes gravitacionale, por tashmë gazi nuk është plotësisht hidrogjen, por edhe një sasi elementësh të tjerë si oksigjeni e karboni që me shumë lehtësi mund të formojnë dioksidin dhe monoksidin e karbonit. Ndërkohë që formohet një yll i ri, gazi nxehet si dhe hidrogjeni, dioksidi i karbonit dhe monoksidi i karbonit fitojnë energji të mjaftueshme për të iniciuar reaksionin e formimit të etanolit. Etanoli njihet kimikisht si një substancë që avollon shumë lehtë dhe ky i fundit e braktis yllin e paformuar para se ai të formohet plotësisht. Në këtë mënyrë në “Nebulozat planetare” mund të gjendet një sasi e konsiderueshme e etanolit. Mendohet se gjithë planetet e sistemit diellor, madje edhe atomet që përbëjnë trupin tonë janë mbetje të një supernove të një ylli që shpërtheu shumë kohë përpara se Dielli ynë të formohej nga këto mbetje!



PULSARET DHE MAGNETARET

Deri më sot janë zbuluar afërsisht 300 planete jashtë sistemit Diellor. Në vitin 1967 Jocelyn Bell, ndërsa po studionte radiovalët që vinin nga hapësira, vuri re ca sinjale të rregullta që vinin nga hapësira. Menjëherë u mendua se këto sinjale periodike vinin nga një qytetërim alien i zhvilluar.

Pastaj atrofizikani Thomas Gold argumentoi se vetëm një yll neutronik mund të jetë përgjegjës për këto lloj sinjalesh, dhe më pas yjet neutronike u quajten pulsar. Yjet neutronik sillen rreth vetes me një shpejtësi marramendëse. Përveç kësaj, ato janë shumë të dendura. Mjafton vetëm një kovë me material nga ylli neutronik, dhe ajo do të peshonte sa mali Everest!

Ndërkohë që studimet e yjeve neutronikë vazhdojnë, dikund nga vitet 90, në konstelacionin “Virgo” u zbuluar një yll neutronik rreth të cilit rrotulloheshin tre planete. Dy prej tyre kishin masë katër herë më të madhe se masa e Tokës ndërsa i treti kishte masë dy herë më të madhe sesa Hëna. Askush nuk di të shpjegojë sesi këto sisteme diellore mund të

formohen, pasi yjet neutronikë janë mbetje të një supernove të një ylli gjigand. A mos vallë këto planete i mbijetuan supernovës, apo mos ndoshta janë kapur nga tërheqja masive gravitacionale e pulsarit ndërsa ata qarkullonin të lira nëpër univers?

Ajo që e bën edhe më të pashpjegueshëm faktin e këtyre lloj sistemesh diellore është distanca që kanë këto planete nga pulsari. Planeti më i largët ndodhet sa distance Mërkur-Diell!

Mes muajit maj dhe korrik të vitit 2005, sateliti artificial “Rossi X-Ray timing Explorer” vëzhgoi një lloj pulsari që emëtoi pesë shpërthime energjetike e cila zgjati më pak se një sekondë çdo shpërthim. Secili shpërthim çliroi energji ekuivalente me dhjetëra mijëra Diej. Këto lloj pulsarësh përmbajnë fushën magnetike më të fuqishme që njihet deri më sot. Për shkak të kësaj karakteristike, ato u quajtën “Magnetarë”. Ata janë një lloj pulsarësh që çlirojnë sasi anormale energjie. Shkencatarët kanë rënë dakord se çdo pulsar e fillon jeten e tij si magnetar përpara se të shndërrohet në pulsar.

TRE KURIOZITETE PËR SISTEMIN TONË DIELLOR

✓ A e dini se në reaksionet bërthamore që ndodhin në Diellin tonë, çlirohen grimca fantazmë që quhen “neutrino” nga të cilat 5000000000000000 prej tyre përshkojnë trupin tonë çdo sekondë edhe në këtë moment që po e lexoni këtë revistë. Këto grimca dalin nga trupi jonë pa vepruar fare me të!

✓ Në sistemin tonë diellor ndodhet një asteroid i rrezikshëm për planetin tonë me emrin 4179 Toutatis. Ai ka një gjatësi 2.5 km dhe ju afrua Tokës shumë afër në vitin 2004. Studimet kanë treguar se ekziston shumë mundësi që në shekullin e 26-të të

godasë planetin Tokë.

✓ A e dini se një ditë në planetin Mërkur zgjat dy vite Mërkuriane. Kjo vjen si pasojë e rrotullimit shumë të ngadaltë të planetit rreth vetes. Kjo gjë shkakton që Dielli shpesh herë të lindë nga perëndimi. Zbulimet e fundit kanë treguar se shpejtësia e rrotullimit të Tokës rreth vetes po ngadalësohet si pasojë e tërheqjes gravitacionale të Hënës. Në një të ardhme të largët, vërtetohet shkencërisht që i njëjti efekt do vërehet edhe në Tokë, ku Dielli shpesh herë do perëndojë dhe papritur do lindë nga ka perënduar!



Thuaj:
“Çdokush sillet
sipas mënyrës së vet,
por Zoti juaj
e di më së miri,
se kush është
në rrugën
më të drejtë”.

(Isra, 84)